



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 241 Akti

Nr. 286 Vendimi
Tiranë, më 4.8.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Brunilda Bektashi	Relatore
Firdes Shuli	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh, në datën 28.7.2020, ora 10:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Genti Shala**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998”;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Brunilda Bektashi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Genti Shala, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë, referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).

2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGj).

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka zhvilluar shortin në datën 15.1.2019, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit, z. Genti Shala, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Firdes Shuli, Brunilda Bekteshi dhe Olsi Komici. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Brunilda Bekteshi.

4. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 18.1.2019, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Genti Shala, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisioner Olsi Komici. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

5. Në datën 22.01.2019, subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, në të njëjtën datë, deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit.

6. Në datën 10.7.2020, Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Genti Shala, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes, për të tria kriteret e rivlerësimit; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me rezultatet e hetimit kryesisht; (iii) të paraqesë pretendime/sqarime shtesë me afat 7 ditë nga data njoftimit; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datën 10.7.2020 subjektit të rivlerësimit iu njoftuan rezultatet e hetimit, për të cilat konfirmoi në të njëjtën datë marrjen e dëgjimit dhe në datën 17.7.2020 dërgoi brenda afatit të përcaktuar nga Komisioni shpjegimet për konkluzionet e hetimit së bashku me dokumentacionin provues.

8. Në datën 23.7.2020, trupi gjykues, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Genti Shala, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016, dhe me anë të postës elektronike u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 28.7.2020, ora 10:30, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

9. Në datën 28.7.2020 u zhvillua seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Genti Shala, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit, z. Genti Shala, iu përgjigj pyetjeve të drejtuara nga anëtarët e trupit gjykues dhe shprehu qëndrimin e tij lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni.

Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Genti Shala, kërkoi konfirmimin në detyrë.

Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Genti Shala. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore, për ta rifilluar për shpalljen e vendimit në datën 4.8.2020.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Genti Shala ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur, kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (ç) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, dhe dokumentacionin mbështetës datë 17.07.2020, 21.07.2020, dhe deklaratimet e subjektit gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit; (dh) deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI; (e) analizën financiare të bërë nga Njësia e Shërbimit Ligjor në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për dosjen nr. IND ***, me shkresën nr. *** prot., datë 26.2.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personat e lidhur për vlerësimin e pasurisë së subjektit, sipas neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016, ku konstatohet: deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; nuk ka burime financiare të ligjshme ndër vite për të justifikuar pasuritë; ka mosdeklarime të pasurisë ndër vite; nuk ka kryer deklarim të rremë; subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

Nga verifikimi i datës së dorëzimit të deklaratës së pasurisë *Vetting*, në zbatim të nenit 31/1, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Genti Shala, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 30.1.2017 (duke përfshirë personin e lidhur), në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe ky fakt konfirmohet nga

ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Për sa më sipër, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2, të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit, z. Genti Shala, është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Nga shqyrtimi i provave të administruara dhe hetimi i kryer nga Komisioni, për secilën nga pasuritë dhe të ardhurat e deklaruara në deklaratën *Vetting*, sipas formularit (shtojca nr. 2), të datës 30.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar, si vijon:

1. Apartament me sip. 69 m², me nr. pasurie ***, me adresë: ***, p. ***, h. ***, k. ***, Shkodër, i privatizuar në vitin 1992, në vlerën 12.000 lekë (shumë e përafërt për shkak se akti nuk gjendet) dhe i regjistruar në datën 10.10.1996, me vlerë 4.000.000 lekë (sipas rivlerësimit të vitit 2013). Burimi i krijimit: kursime familjare. Pjesa takuese: 33.3 %. Për këtë pasuri subjekti ka paraqitur disa dokumente¹.

1.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ZVRPP-së Shkodër.

1.a Shtesë apartamenti, e legalizuar, me sip. 35.4 m², me nr. pasurie ***, me adresë: ***, p. ***, h. ***, k. ***, Shkodër. Kostoja e ndërtimit: 500.000 lekë. Vlera: 2.000.000 lekë, sipas rivlerësimit të vitit 2013, ndërtuar në vitin 1998. Burimi i krijimit: të ardhura nga kursimet e prindërve të subjektit dhe paga si ndihmësgjyqtar. Pjesa takuese: 0 %.

1.a.i ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, përgjigjen e ZVRPP-së Shkodër dhe ALUIZNI-n Shkodër.

➤ Është deklaruar se të dyja pasuritë e mësipërme janë pjesë përbërëse të apartamentit me sipërfaqe totale 104.4 m².

Faktet e konstatuara gjatë hetimit administrativ

1.2 Subjekti i deklaroi për herë të parë këto pasuri:

- Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, me përshkrimin “apartament banimi, ndërtuar para viteve '90, me sip. 100 m². Vlera: 10.000 lekë. Pjesa takuese: 33 %. Privatizuar në vitin 1993 në bazë të ligjit ‘Për privatizimin e banesave shtetërore’”.

- Në deklaratën e interesave private përpara fillimit të detyrës² për vitin 2010 (data e emërimit 19.5.2010 dhe data e dorëzimit 25.3.2011) subjekti ka deklaruar “apartament banimi ndërtuar para vitit '90, me sip. 100 m², i privatizuar. Vlera: 6.000.000 lekë. Pjesa takuese: 33 %”.

1.3 Për pasurinë në pikën 1 subjekti ka depozituar:

¹ Certifikatë për vërtetim pronësie nr.***, datë 11.10.2012, për apartament me sip. 35.4 m², nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me pronar të vetëm shtetasin L. Sh.; kartelë pasurie me të dhëna të njëjta me certifikatën dhe me shënimin “Ieje legalizimi” (Aneks nr. 4/3, në dosjen e ILDKPKI-së).

² Si gjyqtar, pas largimit nga pozicioni i anëtarit të KQZ-së.

- certifikatë pronësie³ për pasurinë me sip. 69 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me adresë: Rr. “****”, Shkodër, në pronësi të shtetasve L. Sh., M. Sh. dhe Genti Shala. Pjesa takuese: 1/3 për secilin;
- kartelë pasurie e paluajtshme me datë regjistrimi 20.10.1996, rivlerësuar në datën 31.8.2012. Vlera e pasurisë pas rivlerësimit është 5.500.000 lekë.

1.4 Për pasurinë në pikën 1.a subjekti ka depozituar:

- certifikatë pronësie⁴ për pasurinë me sip. 35.4 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, ndodhur në Shkodër, në pronësi të shtetasit L. Gj. Sh.;
- kartelë pasurie të paluajtshme me datë regjistrimi 31.8.2012. Te përshkrimi i veçantë citohet *kati i dytë me datë 31.8.2012 u krye rivlerësimi me shumën 1.957.620 lekë.*

1.5 Nga korrespondenca e mbajtur me ASHK-në, Drejtoria Vendore Shkodër⁵, është konfirmuar ekzistenca e pasurive dhe titullarëve të tyre, si vijon:

- apartament me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, në pronësi të shtetasve L. Sh., M. Sh. dhe Genti Shala; si dhe
- apartament me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, legalizuar me lejen nr. ***, datë 11.6.2012, në pronësi të shtetasit L. Gj. Sh. .

Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se këto pasuri ishin rivlerësuar në datën 31.8.2012, specifikisht pasuria me sip. 69 m², në vlerën 5.500.000 lekë dhe pasuria me sip. 35.4 m² në vlerën 1.957.620 lekë. Në total vlera e rivlerësuar e këtyre dy pasurive konfirmohet në shumën 7.457.620 lekë.

Njëkohësisht, informacioni i përcjellë konfirmon se këto dy pasuri janë tjetërsuar⁶ në emër të shtetasit A. P. .

1.6 Komisioni e ka pyetur subjektin⁷ mbi mospërputhjet në lidhje me sipërfaqet dhe vlerën e pasurive. Ndër të tjera, subjekti (për pasurinë me sip. 69 m²), ka sqaruar: *“Vlera e privatizimit është deklaruar nga unë me përafërsi pasi nuk kam disponuar aktet lidhur me këtë proces. Në kohën e privatizimit unë kam qenë student në Fakultetin e Drejtësisë Tiranë dhe e gjithë procedura e privatizimit është ndjekur nga babai im L. Sh. . Në vitin 1998 është ndërtuar një shtesë me sipërfaqe 35.4 m², e cila i është bashkuar në mënyrë organike apartamentit prej 69 m² dhe kështu është përfutur një njësi e vetme banimi, në të cilën kemi jetuar deri në vitin 2013 unë deklaruesi Genti Shala, bashkëshortja ime, prindërit e mi, si dhe tre fëmijët e mi. Një pjesë e kësaj banese përdorej nga prindërit e mi të cilët ishin në moshë të thyer dhe kishin nevojë për një ambient të veçantë, kurse në pjesën tjetër kemi jetuar unë me bashkëshorten dhe tre fëmijët tanë. Ky apartament banimi, i cili është i regjistruar në ZVRPP-në Shkodër me dy vërtetime të ndryshme pronësie, për shkak të prejardhjes së tij, është shitur me datë 23.9.2017, me kontratat e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.9.2017 dhe nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.9.2017. Vlera prej 6.000.000 lekësh e deklaruar nga ana ime në deklaratën për vitin 2010 nuk është çmimi i paguar në momentin e privatizimit të apartamentit, por vlera e përafërt të cilën apartamenti kishte në treg në atë periudhë”.*

³ Aneks nr. 4/2, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴ Aneks nr. 4/3, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 15.11.2019, si dhe dokumentacioni shoqërues.

⁶ Janë shitur pas depozitimit të deklaratës *Vetting*, në vlerën 52.000 euro, konfirmuar me transaksion bankar nëpërmjet llogarisë bankare të noterit.

⁷ Pyetësor nr. 2, datë 27.3.2020.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

1.7 Për sa më sipër, në lidhje me pasurinë apartament, me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, trupi gjykues, në analizë të deklaramëve të subjektit në deklaratën *Vetting*, si dhe në deklaratat periodike, konstaton se subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, ekzistencën e kësaj pasurie, mënyrën e fitimit, si dhe burimin e krijimit të saj dhe, në këtë konkluzion, ka arritur duke renditur dhe arsyetuar argumentet:

1.7.i Në lidhje me apartamentin me sip. 69 m², gjatë hetimit administrativ, verifikimit dhe analizimit të dokumentacionit, u konfirmua se pasuria është fituar nga privatizimi⁸ i banesave shtetërore në përputhje me ligjin nr. 7652/1992. Bazuar në kërkesat e këtij ligji⁹ titullarë të pasurisë figuronin¹⁰ prindërit e subjektit, si dhe vetë ky i fundit. Subjekti ka deklaruar me saktësi këtë pasuri, të drejtat reale mbi të, sikurse kërkohej ligjërisht nga ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar, në deklaratën *Vetting*, duke qartësuar mënyrën e fitimit të saj, vlerën e shpenzuar për kryerjen e privatizimit, si dhe rivlerësimin e kryer sipas legjislacionit të kohës.

1.7.ii Në lidhje me deklarimin e sipërfaqes së kësaj pasurie, vlerën e cituar në deklaratën periodike vjetore për vitin 2003 dhe deklaratën para fillimit të detyrës për vitin 2010, trupi gjykues i konsideron shpjegimet e subjektit në pyetësor (sipërcituar në pikën 1.6), të detajuara, të plota dhe bindëse.

1.8 Në lidhje me ndërtimin e pasurisë shtesë me sip. 35.4 m², subjekti gjatë hetimit administrativ konfirmoi¹¹ se nuk kishte dijeni nëse punimet ishin bërë nga ndonjë shoqëri ndërtimore e licencuar dhe kjo për faktin, sikurse është shprehur ai, se, kryesisht me punimet, ndërtimin dhe legalizimin e pasurisë ishte marrë i ndjeri, babai i tij. Edhe në lidhje me provueshmërinë e kostos së deklaruar për ndërtimin e saj, subjekti ka cituar shprehimisht: *“Personi i impenjuar në ndërtimin e kësaj shtese ka qenë babai im i ndjerë, i cili në fakt, në kohën kur është ndërtuar shtesa, është vënë para një fakti të kryer, pasi vendimi për ndërtimin e shtesës së pallatit ishte marrë nga fqinjët tanë, të cilët kishin rënë dakord së bashku për ndërtimin e saj. Babai im, pasi është njohur me propozimin e fqinjëve, ka rënë dakord që pjesa e tij takuese, në kontributin për ndërtim, të ishte 500.000 lekë, e cila i është bashkuar kontributit të fqinjëve të tjerë, për të financuar ndërtimin e shtesës. Në situatën si më sipër, nuk ka qenë babai im personi që ka komunikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë me ndërtuesin. Nga komunikimi me personat që kanë marrë pjesë në ndërtimin e mësipërm, rezulton se asnjëri nga ata nuk ka ruajtur dokumentacion për të provuar shpenzimet e kryera në ndërtimin e kësaj pasurie.”* Në këto rrethana, subjekti ka deklaruar se vlera e ndërtimit të shtesës me sip. 35.4 m² është 500.000 lekë, siç i është referuar nga babai i tij, i cili rezultonte deri në momentit e shitjes pronari i kësaj sipërfaqeje. Subjekti është shprehur se: *“... në këto kushte nuk disponoj dokumentacion për të provuar shpenzimet e kryera për ndërtimin e kësaj shtese.”* Subjekti ka depozituar¹² deklaratën noteriale nr. ***, datë 8.6.2020, të fqinjët të tij, shtetasit G. R., për të cilin sqaron se ka qenë aktiv në ndjekjen e punimeve. Në këtë akt deklaruesi ka shpjeguar se shtesën e bërë pa leje janë munduar ta realizojnë me kosto sa më minimale. Subjekti ka sqaruar, ashtu sikurse ka deklaruar edhe shtetasi G. R., se punimet janë bërë nga një brigadë ustallarësh që

⁸ Referuar aktit të shitblerjes me nr. ***, vërtetimit hipotekor me nr. ***, datë 22.9.1993, por edhe praktikës së plotë të privatizimit, së bashku me formularët përkatës, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁹ Neni 20, ku citohet: *“Për efekt të zbatimit të këtij ligji, të merret për bazë përbërja familjare dhe gjendja e strehimit që rezulton në regjistrat themeltarë të shtetasve në datën 1.12.1992.”*

¹⁰ Nuk janë më të tillë, për shkak se apartamenti është shitur, sikurse pasqyrohet dhe arsyetohet në këtë vendimmarrje.

¹¹ Me përgjigjet e pyetësorit nr. 5, datë 1.6.2020, sjellë në datën 8.6.2020.

¹² Me përgjigjet e pyetësorit nr. 5, datë 1.6.2020, sjellë në datën 8.6.2020.

nuk i përkitnin ndonjë shoqërie ndërtimore, por punonin në mënyrë informale dhe se kontributi për familje i ka rënë në shumën rreth 500.000 lekë.

Subjekti, për të përcaktuar kostot e ndërtimit, në tipologjinë e ndërtimit të shtesës anësore të pallatit, duke u bazuar në çmimet e vitit të ndërtimit 1998, ka depozituar “raportin për përcaktimin e kostos së ndërtimit, shtesave anësore apartament, në pallat ekzistues”, të përgatitur nga ing. B. Sh., me nr. licence *** dhe NIPT ***, si dhe planimetrinë e përgatitur në funksion të legalizimit të ndërtimit informal, shtesë anësore e pallatit, mbi bazën e të cilit është bërë raporti shoqëruar.

Në raportin vlerësues, eksperti është shprehur se për kostot e ndërtimit (gjithnjë duke cilësuar ndërtimin shtesë) është bazuar në vlerat e tregut për vitin 1998, ndërsa për analizat teknike i është referuar manualeve të ndërtimit 2. Sipas këtij akti vlera për kosto ndërtimi për 4 shtesat e llojit “apartament” pasqyrohet në shumën 2.005.010 lekë. Aktekspertimi është shoqëruar edhe me skicat planimetrike të objektit, një preventiv, si dhe me dokumentacionin që legjitimon ekspertin në kryerjen e aktit.

1.8.i Trupi gjykues, për të provuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve të subjektit lidhur me këtë pasuri, si dhe burimin e krijimit të saj, ka analizuar dokumentacionin e administruar lidhur me ekzistencën e saj, shumën e deklaruar nga subjekti për këtë ndërtim, si dhe aftësinë paguese.

1.8.i.a Në lidhje me fitimin e kësaj pasurie u provua se subjekti ka deklaruar me saktësi dhe vërtetësi faktin se ajo buronte nga leja e legalizimit nr. ***, datë 11.6.2012, nxjerrë në emër të të ndjerit babait, z. L. Sh., si dhe nga kontrata nr. ***, datë 5.8.2011, “për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore”.

Sipas lejes së legalizimit u provua se objekti/shtesë ishte ndërtuar në bashkëpronësi edhe me banorë të tjerë të pallatit ekzistues. Po sipas praktikës së lejes së legalizimit¹³ rezultoi se deklarues i këtij ndërtimi ishte babai i subjektit të rivlerësimit, i cili figuronte gjithashtu edhe titullar i çdo dokumenti institucional apo pagese të shlyer në favor të këtij ndërtimi.

Edhe nga dokumentacioni hipotekor i administruar u provua se kjo pasuri figuronte e regjistruar vetëm në emër të babait të subjektit të rivlerësimit.

1.8.i.b Në lidhje me vërtetësinë e shumës së shpenzuar për ndërtimin e kësaj pasurie, deklaruar në vlerën 500.000 lekë, trupi gjykues konstatoi dhe analizoi në harmoni disa faktorë të rëndësishëm të renditur në vijim:

- i. investimi i kryer i përket jo një ndërtimi klasik, pra jo të krijuar rishtazi, si një godinë e veçantë e një investitori, për të cilin do të ishin kryer përlllogaritje në standardet e miratuara sipas kostove të EKB-së;
- ii. investimi i përket një shtese të një pasurie ekzistuese (e cila ka pasur më parë një kosto) e ndërtuar me banorët e tjerë të godinës, në ngritjen e së cilës kanë shërbyer ndërtime të godinës ekzistuese, siç mund të jenë muret lidhëse, ndarëse, të përbashkëta dhe po në të njëjtën linjë përfshihen edhe themelet ekzistuese dhe më tej përfundohet me një tarracë përsëri e mbështetur apo e lidhur po në atë ekzistuese.

Gjithashtu, trupi gjykues në këtë vlerësim ka ndjekur dhe pranuar logjikën e drejtë të subjektit se përse mund të deklarojë një shumë të përafërt në shpenzimin e ndërtimit dhe se nuk mund të imponohet/t në deklarimin e saktë, pasi:

¹³ Referuar Aneksit nr. 31, në dosjen e ILDKPKI-së.

- i. nuk rezultoi i përfshirë në asnjë dokument të administruar me asnjë cilësi, lidhur me ndjekjen e procedurave për ndërtimin e kësaj pasurie, legalizimin e saj dhe as në regjistrimin e saj;
- ii. në mënyrë konsistente gjatë hetimit ka deklaruar se nuk disponon dokumentacion provues mbi investimin e bërë për këtë pasuri dhe për këtë ka sqaruar edhe arsyet, duke nënvizuar kryesisht faktin se me ndërtimin e saj dhe marrëdhënien mes bashkëpronarëve apo edhe ndërtuesve ishte marrë i ndjeri, babai i tij, i cili legjitimohej si pronar i vetëm në të gjithë dokumentacionin pronësor të pjesës takuese në shtesën e ndërtuar;
- iii. në raport me faktet e sipërpërmendura edhe deklarata noteriale e depozituar (*për sa kohë nuk bie në kundërshtim me faktet e dala në kohë reale*) nga njëri prej banorëve të pallatit mbështet këtë vlerësim.

Në konsideratë të këtyre fakteve, trupi gjykues ka çmuar të vlerësojë aktekspertimin e depozituar nga subjekti, i cili është bazuar në metodologjinë e vitit 1998, në referencë edhe të kohës kur është kryer ndërtimi i pasurisë, si një alternativë teknike dhe proporcionale për këto ndërtime.

✓ Në konkluzion, trupi gjykues krijoi bindjen se subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi shumë e shpenzuar për këtë pasuri.

1.9 Komisioni kreu analizën mbi mundësinë financiare të subjektit dhe familjes së tij për të investuar në shtesën me sip. 35.4 m², sipas deklarimit se kostoja e ndërtimit ka qenë në shumën 500.000 lekë.

1.10 Bazuar në analizën financiare Komisioni i kërkoi subjektit të qartësojë burimet që kishin shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, si dhe të shpjegojë¹⁴ lidhur me balancën negative të konstatuar në shumën 147.457 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

1.11 Subjekti, në parashtrimet e tij, ndër të tjera, ka pretenduar mbi mosmarrjen në konsideratë të disa të ardhurave në raport me përlllogaritjet e bëra nga Komisioni. Më konkretisht, ka saktësuar se në përlllogaritje mungojnë të ardhurat në shumën 135.925 lekë të siguruara nga puna e tij si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, që nga emërimi i tij në këtë detyrë me datë 30.7.1998, si dhe ka saktësuar të ardhurat nga paga e tij si ndihmësgjyqtar në shumën prej 625.600 lekësh. Po ashtu, ka sqaruar se ndërtimi i shtesës anësore ka zgjatur deri në fund të vitit 1998 dhe për shpenzimet e kryera duhen konsideruar edhe të ardhurat nga paga e tij si gjyqtar për muajt deri në fund të vitit 1998. Subjekti, për të provuar pretendimet e tij, ka depozituar vërtetimin për pagën *neto* dhe *bruto*, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, vërtetimin nr. *** prot., datë 13.7.2020, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në të cilin tregohet paga mujore e pozicionit të ndihmësgjyqtarit në këtë gjykatë për periudhën 1995 – 1998. Ky akt, është shprehur subjekti, vërteton pagën e ndihmësgjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, por në kushtet kur dokumentet që vërtetojnë pagën e tij si ndihmësgjyqtar në Gjykatën e Rrethit Malësi e Madhe, nuk mund të gjenden, pasi kjo gjykatë nuk ekziston aktualisht, i ka paraqitur ato si dokumente referuese. Gjithashtu, subjekti depozitoi edhe vërtetimin nr. *** prot., datë 20.2.2020, të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Shkodër, i cili sqaron se nuk disponojnë listëpagesa në arkivë. Në këtë linjë subjekti ka qartësuar se nëse shtohen këto të ardhura, atëherë në përlllogaritje financiare rezulton se familja e tij ka pasur mundësitë financiare për sigurimin e shumë sës nevojshme për ndërtimin e shtesës anësore të pallatit me adresë: ***, Shkodër. Gjithashtu, në

¹⁴ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka theksuar se shpenzimet e familjes së tij në periudhën e analizuar kanë qenë më të ulëta se 70 % e të ardhurave, duke konfirmuar se ky konkluzion është pranuar edhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit¹⁵.

Për këtë pretendim subjekti ka argumentuar se shpenzimet e jetesës në atë periudhë kanë qenë ndjeshëm më të ulëta se sa janë përlllogaritur nga Komisioni¹⁶, por nuk është e mundur të gjendet një burim zyrtar për të mbështetur këtë qëndrim, pasi diskutohet për një periudhë shumë të largët, për të cilën mungojnë të dhënat statistikore. Sipas përlllogaritjes me këtë standard (për sa i përket viteve 1991 – 1996), subjekti ka reflektuar¹⁷ ndryshimin e shpenzimeve për jetesë.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

1.12 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me qartësimin e burimeve të krijimit të shumës së shpenzuar për ndërtimin e kësaj pasurie, pavarësisht vlerës së ulët të balancës negative, si dhe dokumentacionit të depozituar për të provuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve, arsyeton si vijon:

Subjekti, në shpjegimet e tij, i ka qëndruar strikt deklaramit të burimit të krijimit të kësaj pasurie, pra, faktit se shpenzimi ka qenë nga të ardhurat e tij dhe të prindërve. Subjekti ka provuar me dokumentacion justifikues pagën e saktë të përfituar nga puna si ndihmësgjyqtar, pasi gjatë hetimit Komisioni kishte përlllogaritur një pagë mesatare, duke iu referuar rasteve të ngjashme me gjykatat e tjera në shkallë vendi, për këtë pozicion për shkak të mungesës së dokumentacionit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Malësi e Madhe. Po ashtu, subjekti ka qartësuar edhe mbi pagën e pozicionit të gjyqtarit dhe ka pretenduar se edhe mbi këtë bazë vlerësueshmërie duhen kryer rillogaritje. Më konkretisht, nga verifikimi i vërtetimeve të depozituara u konstatua se paga për periudhën kur ai kishte ushtruar funksionin e ndihmësgjyqtarit kishte qenë në rang vendi (pasi ky pozicion ushtrohej në ato vite në të gjithë gjykatat e rretheve gjyqësore dhe ishte normuar e njëjta pagë) 12.200 lekë për vitin 1995, 14.000 lekë për vitin 1996, 16.000 lekë për vitin 1997 dhe 24.000 lekë në vitin 1998. Në këtë kontekst qëndron pretendimi i subjektit se në këtë zë zënë vend rillogaritjet të cilat ndryshojnë balancën e kësaj të ardhure, nga 600.000 lekë të përlllogaritur më parë, në 626.000 lekë, vlerësuar pas saktësisimit të pagës. Po ashtu, në referim edhe të vërtetimit të depozituar nga subjekti lidhur me pagën e pozicionit gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, nëpërmjet të cilës subjekti sërish kërkon të kryhen rillogaritje financiare, konfirmohet një diferencë midis përlllogaritjeve të kryera nga Komisioni (pasi vlerësimi ishte kryer referuar vërtetimit të ISSh-së, Drejtoria Rajonale Shkodër, i depozituar nga subjekti në ILDKPKI, ku të ardhurat si gjyqtar për vitin 1998 ishin në shumën 93.564 lekë) dhe dokumentit të administruar nga Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër të depozituar aktualisht nga subjekti, ku të ardhurat ishin në shumën 135.925 lekë. Në këtë këndvështrim, në konsideratë të provave sa më sipër arsyetuar, trupi gjykues, përmes Njesisë së Shërbimit Ligjor ka kryer rillogaritjet për zërin e të ardhurave të pretenduara dhe nga analiza e re financiare, subjekti rezulton në balancë pozitive.

¹⁵ Në pikën 24.9 të vendimit të arsyetuar nr. 12, datë 17.12.2018, theksohet: “Duke mbajtur në konsideratë të gjitha të ardhurat e subjektit të rivlerësimit, përfshirë edhe periudhat e pretenduara si të përlllogaritura, duke përfshirë edhe koston e jetesës, jo më shumë se 30 % të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit deri në muajin janar 1997”. Në shënimin nr. 2, në fund të f. 18 të këtij vendimi, KPA-ja përcakton se: “referenca në nivelin 30 % është mbajtur në konsideratë për këtë vendim, duke qenë se ky ishte standardi i përlllogaritjeve të Komisionit”.

¹⁶ Referuar tabelës nr. 1 në rezultatet e hetimit administrativ.

¹⁷ Referuar tabelës në të djathtë në prapësimet e tij.

Trupi gjykues vlerësoi edhe pretendimin e subjektit lidhur me shpenzimet e jetesës, pavarësisht se pas saktësisht të të ardhurave të subjektit si ndihmësgjyqtar dhe gjyqtar, ato nuk kishin më ndikim në analizë pasi subjekti rezultonte në balancë pozitive.

Në të tilla kushte trupi gjykues konstaton se provohet me dokumentacion ligjor mundësia financiare e subjektit dhe prindërve të tij për ndërtimin e pasurisë shtesë, si dhe kryerjen e shpenzimeve të jetesës.

✓ Në përfundim, trupi gjykues, lidhur me këto dy pasuri, çmon se subjekti:

- ka kryer deklarim të saktë në lidhje me këtë pasuri;
- ka shpjeguar bindshëm burimin e krijimit të tyre; si dhe
- ka pasur mundësi financiare për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera familjare.

1.13 Nga dokumentacioni i administruar është konfirmuar edhe shitja e këtyre pasurive, përkatësisht sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.9.2017 dhe kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.9.2017, procedurë kjo e përmbyllur me kalimin e shumës 52.000 euro (çmimi i shitjes) në llogarinë bankare të subjektit në “Credins Bank”, veprime të kryera nëpërmjet llogarisë bankare të noterit, sipas legjislacionit për noterinë. Nga hetimi u provua se këto të ardhura kanë shërbyer për pagimin e kështit të tretë të pasurisë nr. 2, të trajtuar në vijim në këtë vendimmarrje.

1.b Njësi (depo), me sip. 5.7 m², me nr. pasurie ***, me adresë: ***, p. ***, kati përdhes i pallatit ku ndodhet apartamenti i sipërcituar, Shkodër, i privatizuar në vitin 1992. Vlera e përfshirë brenda çmimit të privatizimit të apartamentit. Vlera: 60.000 lekë, sipas rivlerësimit të vitit 2013. Burimi i krijimit: kursime familjare të prindërve të subjektit. Pjesa takuese: 33.3 %. Për këtë pasuri subjekti ka paraqitur certifikatë¹⁸ për vërtetim pronësie nr. ***, datë 22.1.2013, për njësi me sip. 5.7 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. 37, f. 45, me bashkëpronarë shtetasit L., M. dhe Genti Shala.

1.b.i ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ZVRPP-së Shkodër.

1.14 Për këtë pasuri subjekti ka depozituar: certifikatë pronësie¹⁹ për pasurinë nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sip. 5.7 m², Shkodër, në pronësi të shtetasve L., M. dhe Genti Shala.

1.15 Nga korrespondenca e mbajtur me ASHK-në, Drejtoria Vendore Shkodër²⁰, konfirmon ekzistencën e pasurisë dhe titullarëve të saj: njësi me nr. pasurisë ***, vol. ***, f. ***, me status aktiv në emër të shtetasve L., M. dhe Genti Shala.

1.16 Nga hetimi rezultoi se kjo pasuri është blerë me të njëjtën kontratë blerjeje të apartamentit me sip. 69 m², ku pjesë përbërëse është edhe depoja²¹. Pra, pasuria është fituar nga privatizimi i banesave shtetërore sipas ligjit nr. 7652/1992.

✓ Trupit gjykues, nga hetimi i kryer për këtë pasuri, në raport me deklaratimet e subjektit, dokumentacionin e depozituar, si dhe atë të administruar nga institucionet publike, nuk i kanë rezultuar problematika.

¹⁸ Shihni Aneks nr. 4/4, në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁹ Aneks 4/4, në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 15.11.2019.

²¹ Referuar edhe kontratës për privatizimin e banesës, formulari nr. 3, në dosjen e ILDKPKI-së.

- ✓ Në konkluzion, rezulton se subjekti ka kryer deklaram të saktë në lidhje me ekzistencën e kësaj pasurie, si dhe burimin e krijimit të saj.

2. Apartament banimi me sip. 249 m², Rr. “**”, Shkodër.** Pasuri e përfituar nga kontrata e porosisë nr. *** rep, nr. *** kol., datë 18.10.2012. Vlera totale: 99.600 euro (400 euro/m²).

- kësti i parë në shumën 24.600 euro, paguar në datën 8.10.2012, me burim krijimi *kursime nga të ardhura të mija familjare, pagat e mija, të bashkëshortes, si dhe pensionet e prindërve, përfshirë të ardhurat nga shitja e apartamentit sipas kontratës nr. ***rep., nr. *** kol., datë 29.9.2004, me vlerë 1.000.000 lekë;*
- kësti i dytë në shumën 50.000 euro, paguar në datën 20.12.2012, me burim krijimi *kredi në vlerë 50.000 euro te “Credins Bank”;*
- kësti i tretë në shumën 25.000 euro, papaguar sipas një marrëveshjeje verbale me palën sipërmarrëse. Shuma do të paguhet në momentin e shitjes së apartamentit të privatizuar në vitin 1992 (pasuria e sipërcituar), me pjesë takuese 100 %.

Sipërfaqja 20.2 m² ka rezultuar më tepër në momentin e dorëzimit të apartamentit, në raport me atë të porositur (pjesë e të njëjtit apartament) në vlerën 1.161.500 lekë, e papaguar sipas marrëveshjes verbale me palën sipërmarrëse. Shuma do të paguhet në momentin e shitjes së apartamentit të privatizuar në vitin 1992 (pasuria e sipërcituar). Për këtë aset subjekti ka paraqitur disa dokumente²².

Faktet e konstatuara gjatë hetimit administrativ

2.1 Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri: në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, me përshkrimin “apartament banimi me sip. 249 m², Rr. “****”, Shkodër”. Kontratë porosie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.10.2012. Vlera totale: 99.600 euro (400 euro/m²).

Burimi i deklaruar i krijimit të kësaj pasurie:

- kësti i parë 24.600 euro – paguar në datën 18.10.2012, me kursimet familjare;
- kësti i dytë 50.000 euro – paguar në datën 20.12.2012, me kredi në vlerën 50.000 euro nga “Credins Bank”;
- kësti i tretë 25.000 euro (i papaguar) – do të paguhet sipas kontratës së sipërmarrjes, në momentin e dorëzimit të apartamentit objekt kontrate.

Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013, me përshkrim “marrëveshje për blerjen e sipërfaqes 20.2 m², e cila ka rezultuar brenda apartamentit të blerë përtej sipërfaqes prej 249 m². Afati i shlyerjes: data 31.12.2014. Çmimi: 400 euro/m². Totali: 1.161.500 lekë.

2.2 Për këtë pasuri subjekti ka depozituar²³:

²² Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.12.2013, me palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k., dhe palë blerëse Genti Shala, për apartamentin me sip. 269.2 m², vlera totale 15.105.500 lekë, shuma nga e cila është likuiduar 10.444.100 lekë, ndërsa pjesa e mbetur prej 4.661.400 lekësh do të likuidohet deri në datën 31.12.2014; vërtetim hipotekor nr. *** , datë 25.2.2013, apartament me sip. 269.2 m², me nr. pasurie ***, z. k ***, në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k.; kontratë porosie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.10.2012, me palë sipërmarrëse shoqëria “****” sh.p.k., dhe palë porositëse Genti Shala për porositje apartamenti me sip. 249 m². Çmimi: 99.600 euro. Kësti i parë prej 24.600 euro është paguar me nënshkrimin e kontratës, kësti i dytë prej 50.000 euro do të likuidohet në momentin e miratimit të kredisë, kësti i tretë do të paguhet në momentin e dorëzimit të apartamentit; deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.12.2013, midis shoqërisë “****” sh.p.k., dhe Genti Shala, sipas së cilës sipërfaqja totale e apartamentit të porositur me kontratën e porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.10.2012, ka rezultuar 269.2 m², pra 20.2 m² më shumë dhe shtetasi Genti Shala deklaroi se është dakord të blejë edhe diferencën prej 20.2 m² në vlerë 1.161.500 lekë. (Aneks nr. 4/5, në dosjen e ILDKPKI-së).

²³ Aneks nr. 4/5, në dosjen e ILDKPKI-së.

- kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.12.2013, me palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k., dhe palë blerëse Genti Shala, për apartament me sip. 269.2 m², vlera totale 15.105.500 lekë, nga e cila është likuiduar shuma 10.444.100 lekë, ndërsa pjesa e mbetur prej 4.661.400 lekësh do të likuidohet deri në datën 31.12.2014;
- vërtetim hipotekor nr. ***, datë 25.2.2013, për apartament me sip. 269.2 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k.;
- kontratë porosie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.10.2012, me palë sipërmarrëse shoqëria “****” sh.p.k., dhe palë porositëse Genti Shala për porositje apartamenti me sip. 249 m². Çmimi: 99.600 euro. Kësti i parë prej 24.600 euro është paguar me nënshkrimin e kontratës, kësti i dytë prej 50.000 euro do të likuidohet në momentin e miratimit të kredisë, ndërsa kësti i tretë do të paguhet në momentin e dorëzimit të apartamentit;
- deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.12.2013, midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasit Genti Shala, sipas së cilës sipërfaqja totale e apartamentit të porositur me kontratën e porosisë nr. ***rep., nr***kol., datë 18.10.2012, ka rezultuar 269.2 m², pra 20.2 m² më shumë dhe shtetasi Genti Shala deklaroi se është dakord të blejë edhe diferencën prej 20.2 m² në vlerën 1.161.500 lekë.

2.3 Nga korrespondenca e mbajtur me ASHK-në, Drejtoria Vendore Shkodër²⁴, konfirmohet ekzistenca e pasurisë në emër të shtetasit Genti Shala, apartament me sip. 269.2 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me status aktiv.

Në ndryshim nga konfirmimi në shkresën përcjellëse të ASHK-së, në kartelën e pasurisë nuk konstatohej tjetërsimi i saj në favor të subjektit të rivlerësimit, por vijonte të konfirmohej në emër të shoqërisë “****” sh.p.k., me datë regjistrimi 21.2.2013.

2.4 UKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 1.11.2019, nuk konfirmon kontratë në Shkodër. Subjekti²⁵ ka depozituar librezën përkatëse. Sipas këtij akti subjekti rezulton titullar me kod kontrate nr. *** dhe nr. klienti*** dhe po ashtu edhe me detyrime të paguara. Gjithashtu, UKSh-ja²⁶ në informacionin e dhënë konfirmon se kontrata është hapur prej datës 19.11.2014 në emër të shtetasit L. Sh.dhe, më tej, është rinovuar në shtator të vitit 2018 në emër të subjektit.

2.5 OSHEE-ja, me shkresën nr. ***prot., datë 29.10.2019, informon se me gjeneralitetet Genti Shala, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikohet 1 (një) abonent me kontratën e furnizimit me nr. *** në instancën Shkodër.

Subjekti ka depozituar librezën përkatëse, ku konfirmohet si titullar i së njëjtës kontratë të sipërcituar me detyrime të shlyera. Gjithashtu, FSHU-ja²⁷, në informacionin e dhënë, konfirmon se kontrata është hapur prej datës 19.11.2014.

2.6 Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2017 subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është shlyer tërësisht. Subjekti deklaroi se i ka mbyllur këto detyrime me të ardhurat nga shitja e pasurisë së përfituar nga privatizimi i banesave shtetërore dhe ndërtimi informal i legalizuar.

2.7 Komisionit, gjatë hetimit, i ka rezultuar se subjekti me të ardhurat nga kjo shitje (52.000 euro) ka paguar 33.000 euro detyrimin e mbetur për shoqërinë “****” sh.p.k., nga llogaria e tij në “Credins Bank”, datë 5.12.2017, me përshkrimin “kalim kësti 3 sipas kontratës së shitblerjes”.

²⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 15.11.2019, si dhe dokumentacioni shoqërues.

²⁵ Në përgjigje të pyetësorit nr. 4, datë 28.5.2020, dhe me shkresën nr. ***prot., datë 3.6.2020.

²⁶ Me shkresën nr. ***prot., datë 3.6.2020.

²⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 1.6.2020.

2.8 Ndërsa, në lidhje me mostjetërsimin e pasurisë në favor të subjektit, me gjithë ezaurimin e kushtit kontraktor, subjektit i është kërkuar²⁸ të japë shpjegime, si dhe të depozitojë certifikatën e pasurisë. Në përgjigjen e dhënë subjekti konfirmoi se: *“...certifikata e pronësisë të apartamentit tim në Shkodër, në adresën: Rr. ‘***’, rezulton në emër të shoqërisë ‘***’ sh.p.k., për shkak se nuk janë kryer veprimet.”* Gjithashtu, ai ka depozituar informacionin e ASHK-së, Drejtoria Vendore Shkodër²⁹. Sipas këtij të fundit qartësohet se nëse është shlyer kësti i fundit duhet të hartohet akti noterial ku të konfirmohet ky fakt dhe pas përfundimit të këtij veprimi ky akt aplikohet në portalin *e-albania* brenda afatit 30-ditor nga dita e hartimit të tij, sipas parashikimit të bërë në nenin 25 të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, pranë Zyrës së Kadastrës Shkodër, nga shoqëria e ndërtimit “****” sh.p.k.

2.9 Komisioni i ka kërkuar edhe shoqërisë ndërtimore të qartësojë mbi këtë konstatim, nga ku kjo e fundit³⁰ ka konfirmuar edhe një herë datat dhe shumat e paguara nga subjekti për këtë pasuri (të cilat përputhen edhe me deklarin e subjektit), si dhe ka bërë me dije se për shkak të një mosrakordimi si rezultat i kursit të këmbimit (konvertimi i pagesave nga euro në ALL) për likuidimin e pasurisë, regjistrimi i saj në favor të subjektit do të kryhet në një kohë sa më të afërt.

2.10 Megjithatë, Komisionit, në analizë të fakteve më sipër, i rezultoi se mbetej e paqartë moskryerja e veprimeve ligjore lidhur me tjetërsimin e kësaj pasurie në emër dhe për llogari të subjektit të rivlerësimit dhe në këtë kontekst iu kërkuua të japë shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

2.11 Subjekti, në parashtrimet e tij, ka shpjeguar se: *“Në lidhje me konkluzionet e Komisionit, për sa i përket moskryerjes së veprimeve ligjore lidhur me tjetërsimin e shtëpisë sime të banimit, në emër dhe për llogari time, sqaroj se shkak i mosregjistrimit të këtij apartamenti në emrin tim pranë ASHK-së Shkodër ka qenë pretendimi i shoqërisë ‘***’ sh.p.k., se unë duhet të paguaj (përveç shumave të kontraktuara) edhe shumën prej 271.000 lekësh. Sipas përfaqësuesit ligjor të shoqërisë ‘***’ sh.p.k., kjo shumë ka rezultuar pas kryerjes së praktikave fiskale nga kontabilisti i shoqërisë dhe është rezultat i ndryshimit të kursit të këmbimit të valutës sonë me atë europiane, e cila është caktuar si valutë për kryerjen e shitblerjes së apartamentit. Unë kam paguar çmimin e plotë të përcaktuar në kontratë, sipas marrëveshjes me shoqërinë *** sh.p.k. Shumën e pretenduar nga shoqëria *** sh.p.k., fillimisht nuk kam pranuar ta paguaj, pasi e kam vlerësuar se nuk e kam realisht detyrim, por kam pritur reflektimin e shoqërisë ndërtuese për ta zgjidhur këtë çështje me mirëkuptim, pasi nuk kam dashur ta konsideroj si shkak për krijimin e një mosmarrëveshjeje ligjore, për arsye të marrëdhënieve të mira dhe miqësore me vëllezërit L. .*

Aktualisht, kemi arritur një marrëveshje me mirëkuptim me shoqërinë, në bazë të të cilës kam pranuar të paguaj në favor të saj shumën 100.000 lekë (shumë të cilën e kam derdhur për llogari të shoqërisë me datë 14.7.2020), kurse shoqëria ndërtimore, menjëherë pas kësaj pagese, do të përfundojë procedurat ligjore për kalimin e pronësisë së apartamentit në emrin tim.”

Subjekti ka qartësuar se ishte në pritje të përfundimit të procedurës ligjore në ASHK-në Shkodër dhe ka depozituar deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.7.2020, të shoqërisë ndërtimore “****” sh.p.k.

²⁸ Me pyetësorin nr. 4, datë 28.5.2020.

²⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 3.6.2020.

³⁰ Shkresë nga “****”, datë 25.6.2020, kthim përgjigje shkresës nr. *** prot., datë 16.6.2020, të Komisionit.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

2.12 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit justifikues të administruar, arrin në konkluzion se subjekti ka shpjeguar bindshëm lidhur me kryerjet e veprimeve nga shoqëria ndërtimore për kalimin e pasurisë në emër të tij.

Nën këtë konkluzion arsyetohet se:

Parimisht, sipas legjislacionit në fuqi në rast të përfundimit të shlyerjes së pagesave për një pasuri, detyrimi për veprimet e tjetërsimit të saj në favor të përfituesit të pasurisë bie mbi shitësin e saj. Në kushte të tilla shoqëria ndërtimore mbarte këtë lloj detyrimi ndaj subjektit të rivlerësimit. Detyrimi që kanë pasqyruar palët kontraktore, ndaj njëra tjetrës lidhur me pagesa të tjera të nevojitura për tu kryer, për shkak të kursit të këmbimit në kohën e shlyerjes së pagesave të pasurisë, duket se ka qenë përtej detyrimeve për shlyerjen e kësaj pasurie, për shkak se pagesat kanë qenë në Euro, kanë rezultuar të paguara, ndërsa fakti i konvertimit të monedhës për efekt të pasqyrave financiare dhe kontabilitetit të shoqërisë, nuk mbetet përgjegjesi mbi klientin/subjektin. Megjithatë, zgjidhja përfundimtare e detyrimeve mes palëve është thjesht dhe vetëm vullnet i shprehur mes tyre dhe që në këtë rast, po në këtë formë, ka përfunduar, duke bërë të mundur më tej edhe zbatimin e kushtit ligjor të shoqërisë ndërtimore për të tjetërsuar pasurinë në favor të subjektit të rivlerësimit. Hapat e ndërmarrë nga palët kontraktore janë provuar me deklaratën noteriale nr. ***, datë 14.7.2020, në të cilën deklarohet se palët janë likuiduar mes njëra-tjetrës dhe se pala shitëse është dakordësuar që nga ASHK-ja të kryhet regjistrimi i pasurisë në emër të blerësve. Pas kësaj procedure, pasuria është regjistruar³¹ në emër të subjektit dhe bashkëshortes së tij.

2.13 Së fundmi, trupi gjykues vlerëson të përmend edhe faktin se kjo procedurë, megjithëse nuk ka qenë detyrim i subjektit për t'u ndjekur dhe as do të ndikonte në vlerësimin e tij në këtë vendimmarrje, merr një vlerë të caktuar për kujdesin e shtuar të treguar nga subjekti, në raport me konfirmimin që ASHK-ja bënte fillimisht në shkresën shoqëruese, duke e konfirmuar subjektin si pronar të pasurisë dhe ndërsa në kartelën e pasurisë bashkëngjitur vijonte të prezantonte në këtë cilësi shoqërinë ndërtimore.

2.14 Komisioni hetoi mbi secilin burim krijimi të kësaj pasurie:

a) *Kësti i parë 24.600 euro, paguar në datën 8.10.2012*

Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012 subjekti ka deklaruar se burimi i krijimit të këstit të parë janë kursimet familjare. Në deklaratën *Vetting* subjekti deklaron se burim janë “*kursime nga të ardhurat e mia familjare, pagat e mia, të bashkëshortes, si dhe pensionet e prindërve, përfshirë të ardhurat nga shitja e apartamentit sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.9.2004, me vlerë 1.000.000 lekë.*”

Subjekti rezulton në të njëjtin trung familjar së bashku me prindërit e tij që nga momenti i deklarimit për herë të parë (viti 2003) deri në dorëzimin e deklaratës *Vetting*. Të ardhurat e prindërve, subjekti i ka deklaruar në deklaratën e vitit 2003 dhe në atë para fillimit të detyrës në vitin 2010.

³¹ Subjekti me e-mailin datë 21.07.2020, ka depozituar Certifikatën për Vërtetim Pronësie, së bashku me Hartën treguese dhe kartelën e kësaj pasurie.

Nga dokumentacioni i depozituar³², sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 27.12.2016 nga ISSh-ja, Drejtoria Rajonale Shkodër, babai i subjektit, shtetasi L. Sh., rezulton në pension nga korriku i vitit 1991. Ndërsa, sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 27.12.2016, po nga kjo drejtori nëna e subjektit, shtetasja M. Sh., rezulton në pension nga gushti i vitit 1988.

Të ardhurat nga punësimi i subjektit dhe bashkëshortes janë konfirmuar nga institucionet publike dhe jopublike. Komisioni ka përfshirë në analizë ato të ardhura për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, në zbatim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Ndërsa, në lidhje me të ardhurat nga shitja e apartamentit sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.9.2004, me vlerë 1.000.000 lekë, Komisioni e ka analizuar këtë pasuri në pikën nr. 6. Të ardhurat në vlerën 1.000.000 lekë nuk janë përfshirë në analizë, sepse ashtu siç është sqaruar në rezultatet e hetimit, nga kjo shumë vetëm 500.000 lekë është pjesë e kursimeve të prindërve të subjektit. Në deklaratën e vitit 2003 subjekti nuk i ka deklaruar këto të ardhura dhe as gjendjen e tyre *cash* ose në bankë.

Në analizë janë përfshirë ato kursime *cash*, të cilat subjekti i ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore.

Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ kanë rezultuar edhe veprime të tjera të ndërmarra nga subjekti në lidhje me këtë shumë, të përdorur për këtë kësht. Më konkretisht, ka rezultuar se subjekti ka derdhur në llogarinë e tij në “Credins Bank” shumën 25.000 euro, në datën 31.12.2013, me përshkrimin “derdh Genti Shala të ardhura nga kursimet”. Në po të njëjtën datë kjo shumë është transferuar në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k., me përshkrimin “kalim për blerje apartamenti”. Nga korrespondenca e Komisionit me ILDKPKI-në rezulton se në procesverbalet³³ e mbajtura nga ky institucion në datat 12.9.2014 dhe 2.10.2014 subjekti është pyetur në lidhje me këtë transaksion dhe ka sqaruar se: *“Në datën 31.12.2013 përfaqësuesi i shoqërisë **** sh.p.k. për shkak të procedurave fiskale të sugjeruara nga ekonomisti kontabël i kësaj shoqërie më ka kthyer shumën prej 24.600 euro (e paguar prej meje si kësht i parë në datën 18.10.2012), për t’u paguar nëpërmjet një transaksioni bankar. Po në këtë datë (31.12.2013) pas marrjes së shumës prej 24.600 euro nga shoqëria është bërë derdhje në ‘Credins Bank’ shuma prej 25.000 euro, duke deklaruar në bankë edhe burimin që m’u kërkua ‘të ardhura nga kursimet’. Sqaroj se deri në datën e sotme apartamenti nuk është regjistruar pranë ZVRPP-së Shkodër në pronësinë time dhe unë vazhdoj të kem detyrimin pranë shoqërisë shumën prej 4.661.400 lekësh, e cila përbëhet prej kështit të tretë sipas kontratës së porosisë në shumën 25.000 euro dhe vlerën prej 1.161.500 lekësh për sipërfaqen shtesë”*. Mbi kërkesën e ILDKPKI-së shoqëria ndërtimore në datën 24.10.2014 ka konfirmuar³⁴ deklarin e subjektit se i është kthyer shuma në *cash* për të kaluar me transaksion bankar, duke pasqyruar të njëjtin argument sikurse subjekti ka deklaruar në procesverbalin e ILDKPKI-së.

Komisioni, në analizën e kryer, ka përfshirë shumën 24.600 euro, paguar në vitin 2012, si dhe vlerën 400 euro në vitin 2013, shumë kjo e përfshirë si rezultat i diferencës mes pagesës 25.000 euro dhe kthimit të shumës 24.600 euro nga shoqëria “****” sh.p.k. (25.000 euro - 24.600 euro).

Trupi gjykues, në analizë të veprimeve të kryera nga subjekti me këtë kësht të kësaj pasurie, konstaton se:

³² Aneks nr. 4/11 në dosjen e ILDKPKI-së.

³³ Shkresë nr***prot., datë 30.3.2020 dhe dokumentacioni shoqërues.

³⁴ Referojuni shkresës së administruar në dosjen e ILDKPKI-së që i përket faqes rendore nr. 523 – 524.

- Subjekti fillimisht ka paguar shumën prej 24.600 euro në përputhje me detyrimin kontraktor të parashikuar në kontratën e porosisë së apartamentit.
- Duke qenë se ky veprim nuk është kryer nëpërmjet transaksionit bankar, duket i drejtë kërkimi i shoqërisë ndërtimore që pagesa të kryhej me transaksion bankar dhe po ashtu bëhet e besueshme marrëdhënia reciproke midis subjektit të rivlerësimit, i cili ka marrë nga shoqëria ndërtimore shumën e likuiduar më parë me nënshkrimin e kontratës së porosisë dhe për të sistemuar pagesat në mënyrë të saktë dhe të gjurmueshme të likuidimeve të pasurisë, e ka kaluar atë nëpërmjet sistemit bankar.
- Këto veprime, nuk janë bërë prezent për herë të parë gjatë hetimit administrativ, por ato janë deklaruar nga subjekti në proceserbalin³⁵ e mbajtur në ILDKPKI, nga shoqëria që gjithashtu ka depozituar informacion të plotë në deklaratën për veting³⁶ mbi kryerjen dhe miratimin e këtij veprimi, duke treguar konsistencë në deklaratimet e subjektit.
- Pra, në mënyrë të përmbledhur vërehet se janë një sërë faktorësh që konfirmojnë veprimet e kryera nga subjekti për të cilat trupi gjykues vlerëson se nuk ngrihen dyshime për mënyrën e përdorimit të kësaj pagese në favor të likuidimit të pasurisë.

b) Kësti i dytë 50.000 euro, paguar në datën 20.12.2012, kredi në vlerën 50.000 euro në “Credins Bank”

Subjekti e deklaroi për herë të parë kredinë e marrë në “Credins Bank” në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012 si burim për këstin e dytë për blerjen e apartamentit.

“Credins Bank”, me shkresën nr*** prot., datë 19.5.2020, konfirmon kredinë afatgjatë nr. ***, datë 23.10.2012, me nr. *** rep., nr. *** kol., në shumën 50.000 euro dhe planin e saj të amortizimit.

Gjithashtu, “Credins Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 18.12.2019, konfirmon se kjo kredi është disbursuar në datën 24.10.2012, në shumën 49.500 euro dhe në datën 29.10.2012 është transferuar shuma prej 49.200 euro në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k., me përshkrimin “pagesë për blerje apartamenti sipas kontratës”.

Subjekti deklaroi se kësti i dytë në shumën 50.000 euro është paguar në datën 20.12.2012, ndërkohë nga dokumentacioni bankar rezultoi se ky këst është paguar në shumën 49.200 euro, në datën 24.10.2012.

- ✓ Trupi gjykues, megjithëse konstatoi mospërputhje në deklaratim në lidhje me shumën e paguar dhe datën e pagesës, pasi subjekti deklaronte *paguar 50.000 euro në datën 20.12.2012*, ndërkohë që ishin paguar *49.200 euro në datën 29.10.2012*, vlerësoi se këto mosrakordime nuk sjellin pasoja për subjektin në tërësi të kësaj vendimmarrjeje.

c) Kësti i tretë 25.000 euro, papaguar sipas një marrëveshjeje verbale me palën sipërmarrëse, shumë kjo e deklaruar se do të paguhet në momentin e shitjes së apartamentit të privatizuar në vitin 1992, e sipërcituar

Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012 subjekti ka deklaruar se kësti i tretë prej 25.000 euro është i papaguar dhe se do të paguhet sipas kontratës së sipërmarrjes, në momentin e dorëzimit të

³⁵ Datë 2 Teor 2014, në dosjen e Komisionit.

³⁶ Referojuni Aneks nr.37 në dosjen e ILDKPKI-së.

apartamentit. Ky detyrim është deklaruar deri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016 si detyrim i pashlyer ndaj shoqërisë ndërtimore.

- ✓ Trupi gjykues, në lidhje me pagesën e këtij kësti, konstaton se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit, si dhe me përgjigjen e shoqërisë ndërtimore. Gjithashtu, trupi gjykues, përtej këtij konstatimi, për shkak të ecurisë së procesit të hetimit administrativ ndaj subjektit, si dhe veprimeve të kryera prej tij, në këtë vendimmarrje ka arsyetuar më sipër edhe lidhur me regjistrimin e kësaj pasurie, fakt që provon edhe shlyerjen e kështit të tretë.

2.15 Njësia e Shërbimit Ligjor kreu analizën financiare mbi mundësinë e investimit në këtë pasuri të paluajtshme, duke marrë në konsideratë shpjegimin e subjektit se shuma e paguar *cash* (në datën e nënshkrimit të kontratës) i është kthyer nga shoqëria për t'u paguar nëpërmjet sistemit bankar. Ky veprim nuk ka efekt financiar sepse është një shumë e kthyer dhe e paguar në të njëjtën datë.

2.15.i Nga analiza financiare e kryer trupi gjykues konkludoi se subjekti ka pasur mundësi financiare të investojë në këtë pasuri të paluajtshme, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

2.15.ii Ndërsa, në lidhje me ekzistencën e ndonjë trajtimi preferencial për shumën e shpenzuar për blerjen e kësaj pasurie subjekti ka vënë në dispozicion³⁷ disa kontrata të ngjashme, të cilat sipas verifikimit konfirmojnë të njëjtën shumë të shpenzuar nga blerës të tjerë në të njëjtën godinë.

2.15.iii Po ashtu, për sa i përket ekzistencës së ndonjë konflikti të mundshëm interesi të subjektit për shkak të funksionit të tij, me shitësit e kësaj pasurie, institucionet punëdhënëse³⁸ të subjektit nuk kanë konfirmuar zhvillimin e ndonjë procesi gjyqësor me palë ndërgjyqëse, shtetasit L. dhe G. L., si në cilësi individuale apo edhe të përfaqësuesit të shoqërisë ndërtimore. Njëkohësisht edhe subjekti ka vetëdeklaruar se nuk ka zhvilluar asnjë proces gjyqësor me ta dhe se me shitësin e pasurisë është në marrëdhënie familjare, pasi vajza e xhaxhait të tij shtetasin L.L. e ka bashkëshort.

3. Automjet tip “Mercedes Benz A Class”, blerë me kontratë noteriale nr. ***rep., nr. *** kol., datë 12.2.2007. Vlera: 600.000 lekë. Burimi i krijimit: kursimet e ardhura nga paga e subjektit. Pjesa takuese: 50 %. Për këtë pasuri subjekti ka paraqitur dy kontrata³⁹.

3.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur se ky automjet është shitur në vitin 2016, shitje e cila është deklaruar nga bashkëshortja si burim për blerjen e automjetit tip “Golf Plus”.

Faktet e konstatuara gjatë hetimit administrativ

3.2 Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006, me përshkrimin “autoveturë tip ‘Benz 140’, në bashkëpronësi me bashkëshorten. Vlera: 600.000 lekë. Pjesa takuese: 50 %”. Ndërsa, në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, në vitin 2010, bashkëshortja e subjektit deklaroi: “*Automjet ‘Benz A 140’, në vlerën 600.000 lekë me burim krijimi: kursimet nga të ardhurat e pagave ndër vite, si dhe kursimet nga pagat e mia të deklaruara. Pjesa takuese: 100 %.*”

³⁷ Me pyetësin nr. 2, datë 27.3.2020.

³⁸ Gjykata e Apelit Shkodër, me shkresën nr.***prot.; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me shkresën nr. *** prot., datë 28.4.2020; Gjykata e Apelit Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 11.5.2020.

³⁹ Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.2.2007, me palë shitëse Xh. H. dhe palë blerëse Genti dhe M. Shala, për blerje automjeti tip “Benz”, në vlerën 600.000 lekë; kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. ***kol., datë 29.3.2016, me palë shitëse Genti dhe M. Sh. dhe palë blerëse H.D., për shitje automjeti tip “Mercedes Benz”, në vlerën 380.000 lekë (targa ***). (Aneks nr. 4/6, në dosjen e ILDKPKI-së).

3.3 Ky automjet konfirmohet me kontratë shitblerje⁴⁰ nr. ***rep., nr. *** kol., datë 12.2.2007, me palë shitëse Xh.H. dhe palë blerëse Genti dhe M. Shala, për blerje automjeti tip “Benz”, në vlerën 600.000 lekë.

3.4 DPSHTRr-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 24.10.2019, konfirmon se shtetasit Genti L. Shala dhe M. N. Sh. kanë pasur të regjistruar automjetin me targa*** .

3.4.i Në dosjen e automjetit me targa ***, depozituar nga kjo drejtori, është administruar kontrata e shitblerjes së pasurisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.2.2007, në vlerën 600.000 lekë, me palët e sipërpërmendura, për automjetin me të dhënat: “Mercedes Benz”, tip 168, me targa ***, me nr. shasie ***. Më tej, konfirmohet se ky automjet është shitur me aktshitje pasurie të luajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.3.2016, me palë shitëse Genti L. Shala dhe M. Sh. dhe palë blerëse H. D., në vlerën 380.000 lekë.

3.5 Njësia e Shërbimit Ligjor kreu analizën financiare vjetore dhe jo në momentin e blerjes së pasurisë, sepse subjekti një vit më parë ka pasur gjendje *cash* në shumën 900.000 lekë, shumë kjo më se e mjaftueshme për të përballuar blerjen e automjetit në datën 12.2.2007, në vlerën 600.000 lekë.

✓ Nga analiza financiare trupi gjykues ka konkluduar se subjekti ka pasur mundësi të investojë në këtë pasuri të luajtshme, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare dhe, për pasojë, ka deklaruar me saktësi dhe vërtetësi ekzistencën e kësaj pasurie, si dhe burimin e krijimit të saj.

4. Gjendje *cash*⁴¹ në vlerën 200.000 lekë – pjesa takuese: 50 %

Subjekti, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016, deklaroi “gjendje *cash* në shtëpi në shumën 200.000 lekë”.

Komisioni kreu analizën financiare të vitit 2016 dhe rezultoi se dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi në shumën 362.516 lekë që të mund të kursente shumën prej 200.000 lekësh, si dhe të kryente shpenzimet e tjera familjare dhe për këtë shkak i kaloi subjektit barrën⁴² e provës për të dhënë argumentet e tij.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

4.1 Subjekti, në parashtrimet e tij, ka shpjeguar se: “Për sa i përket përlllogaritjeve dhe analizës financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve të familjes sime, Komisioni i është referuar shumës të përcaktuar nga ILDKPKI-ja, ku vlera e shpenzimeve për jetesë gjatë vitit 2016 është përlllogaritur në masën 1.645.644 lekë. Kriteri i ndjekur nga ILDKPKI-ja buron nga Anketa e Buxhetit të Familjes për vitin 2016, publikuar nga INSTAT-i, me datë 30.10.2017. ILDKPKI-ja ka kryer shumëzimin mekanik të shpenzimeve mesatare për konsum të një individi, me numrin e pjesëtarëve të familjes (19.591 lekë x 7 persona x 12 muaj = 1.645.644 lekë). Mendoj (është shprehur ai) se ky kriter e humbet sensin në rastin kur flitet për një familje relativisht të madhe (7 persona) dhe nuk pasqyron realisht shpenzimet familjare. Sa më sipër, i jam drejtuar personalisht INSTAT-it, duke i kërkuar të informohem se në bazë të standardeve statistikore, që INSTAT-i aplikon, si klasifikohet konsumi i familjes sime, sipas përbërjes së saj ndër vite. Me anë të përgjigjes nr. *** prot., datë 13.5.2020, INSTAT-i ka argumentuar se shpenzimet mesatare në nivel vendi nuk mund të jenë rezultat i një mesatareje të thjeshtë matematikore, por është mesatarja brenda çdo

⁴⁰ Aneks nr. 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴¹ Aneks nr. 4/11 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴² Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

kategorie, sipas madhësisë, apo tipologjisë të familjes. Për rrjedhojë, shpenzimet mesatare mujore të familjeve të përbëra nga dy anëtarë, nuk gjenerohen si prodhim i shpenzimeve mesatare mujore për konsum të familjeve me një anëtar e shumëzuar për dy.”

Sipas përgjigjes së sipërcituar, shpenzimet mujore për konsum, sipas madhësisë së NJEF-së për vitin 2016, për familjen me më shumë se 5 persona, janë në shumën 86.355 lekë. Ndërsa, shpenzimet mujore për konsum, sipas tipologjisë së NJEF-së për vitin 2016, për familjen të përbërë nga 3 (tre) ose më shumë të rritur me fëmijë, janë në shumën 86.552 lekë. Në funksion të përmbushjes së detyrimit për barrën e provës, subjekti ka depozituar: (i) kërkesë drejtuar INSTAT-it, datë 11.5.2020; dhe (ii) përgjigjen e INSTAT-it “kthim përgjigje” me nr. *** prot., datë 13.5.2020.

4.2 Subjekti ka parashtruar se për sa i përket shpenzimeve sipas sistemit *TIMS* që Komisioni ka përcaktuar në vlerën 900.555 lekë, të përlllogaritura në mbështetje të vendimit nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, të KPA-së, sipas përlllogaritjeve të bëra nga ky vendim dhe sipas tabelës që subjekti ka dërguar në pyetësorin nr. 3, rezulton se vlera e shpenzimeve për udhëtimet jashtë Shqipërisë nga subjekti dhe familja e tij është në vlerën 649.262,86 lekë.

4.3 Gjithashtu, subjekti është shprehur edhe mbi të ardhurat e pasqyruara nga Komisioni lidhur me shitjen e automjetit tip “Mercedes Benz A Class”, në shumën 380.000 lekë. Ai ka sqaruar se në vitin 2016 nga shitja e këtij automjeti ka realizuar një të ardhur në shumën 80.000 lekë, për arsye se pjesën tjetër të çmimit të shitjes së automjetit prej 300.000 lekësh e ka arkëtuar që në vitin 2015, pasi për shitjen e këtij automjeti ishte rënë dakord me palën blerëse që pjesa e çmimit prej 300.000 lekësh të paguhej në momentin e marrjes në dorëzim të automjetit, kurse pjesa tjetër prej 80.000 lekësh të paguhej në momentin e lidhjes së kontratës përfundimtare të shitjes. Subjekti ka depozituar deklaratë noteriale nr*** rep., nr. *** kol., datë 14.7.2020, të shtetas H. D., e cila është bashkëshortja e vëllait të bashkëshortes së tij, që ka blerë edhe automjetin tip “Mercedes Benz A Class”, si dhe ka shpjeguar mënyrën e pagesës së bërë. Subjekti ka përforcuar pretendimin e tij, duke shpjeguar se referuar sistemit *TIMS*, pjesë e dosjes elektronike të marrë nga Komisioni, për sa i përket hyrje-daljeve të automjetit tip “Mercedes Benz” me targa ***, rezulton se pas datës 26.4.2015 (që ne kemi blerë automjetin tip “VW Golf Plus” dhe kemi marrë shumën prej 300.000 lekësh), ky automjet nuk është përdorur më prej tij apo pjesëtarët e familjes së tij, por vetëm nga shtetasja H. D. dhe familjarët e të afërmit e saj.

4.4 Subjekti ka pasqyruar rillogaritjet e tij, duke pretenduar se: (i) shpenzimet e jetesës rezultojnë më të ulëta se në fakt i kanë rezultuar Komisionit, bazuar kjo në korrespondencën e mbajtur me INSTAT-in; (ii) shpenzimet e udhëtimeve gjithashtu rezultojnë më të ulëta se përlllogaritjet e Komisionit; si dhe (iii) duhen përfshirë të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Mercedes Benz A Class”, në shumën 300.000 lekë në vitin 2015 dhe në shumën 80.000 lekë në vitin 2016. Mbi këto përlllogaritje subjekti ka pretenduar se në vitin 2016 rezulton në balancë pozitive, në shumën prej 198.161 lekësh.

Në këto kushte, është shprehur subjekti, kursimi *cash* prej rreth 200.000 lekësh, i deklaruar në deklaratën periodike vjetore për vitin 2016 justifikohet plotësisht me të ardhura të ligjshme, duke pasur parasysh mënyrën e sqaruar nga Komisioni për përlllogaritjen e zërit “ndryshim likuiditeti”.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

4.5 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, dokumentacionit të depozituar prej tij, rillogaritjeve të pretenduara nën argumentet e paraqitur, arsyeton si vijon:

4.5.i Pretendimi i subjektit se në zërin e shpenzimeve familjare, përlllogaritjet për një familje me shumë anëtarë duhen kryer bazuar në përgjigjen e marrë prej tij nga INSTAT-i, vlerësohet të mos merret në konsideratë për arsye se: (i) edhe vetë përgjigja e depozituar nga subjekti reflekton vlera të ndryshme në varësi të statistikës së ndjekur, shpenzime për konsum sipas madhësisë së NJEF-së dhe shpenzime për konsum sipas tipologjisë së NJEF-së; (ii) Komisioni për shpenzimet e jetesës bazohet në një shkresë dhe përgjigje të INSTAT-it; (iii) duhet mbajtur në konsideratë fakti se këto shpenzime janë minimumi jetik dhe nuk pasqyrojnë shpenzimet reale të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve të tij; si dhe (iv) këto shpenzime janë përlllogaritur njëjtë për të gjithë subjektet e rivlerësimit nga Komisioni, për periudhën 2003 – 2016, sipas një standardi të krijuar tashmë.

4.5.ii Në lidhje me pretendimin tjetër të subjektit se shpenzimet e udhëtimeve të rezultuara sipas sistemit *TIMS* duhet të jenë në vlerën 649.263 lekë, pasi u analizuan të gjitha provat dhe përgjigjet e subjektit, si dhe u kryen rillogaritjet, shpenzimet rezultuan në vlerën 733.913 lekë.

4.5.iii Në lidhje me pretendimin e subjektit se shuma e të ardhurave prej 380.000 lekësh, e përfituar nga shitja e automjetit tip “Mercedes Benz” me targa *** duhet të përlllogaritet e ndarë në dy pjesë dhe, më konkretisht, shuma prej 300.000 lekësh duhet përfshirë në analizën e vitit 2015 nën argumentin se pavarësisht se shitja e pasurisë është formalizuar në mars të vitit 2016, kjo shumë i është marrë blerësit prej vitit 2015, ndërsa shuma e mbetur prej 80.000 lekësh është marrë me nënshkrimin e kontratës dhe se ai nuk ka udhëtuar më me këtë automjet në vitin 2015, sipas sistemit *TIMS*, në analizë të provave trupi gjykues konstaton se:

- Në deklarimin e subjektit në deklaratën periodike⁴³ vjetore për vitin 2015⁴⁴ nuk cilësohet ndërveprimi me shumën 300.000 lekë.

- Kontrata është nënshkruar në datën 29.3.2016 dhe në të cilësohet se shuma prej 380.000 lekësh është likuiduar tërësisht mes palëve, fakt që lejon mundësinë e pagesës në kohë të ndryshme apo edhe në shuma të ndara, pra, që nënkupton se mund të qëndrojë pretendimi i subjektit lidhur me kryerjen e dy pagesave nga shitësi, përkatësisht në vitin 2015 dhe në vitin 2016. Por, në raport me kontratën e shitjes së automjetit dhe deklaratën noteriale të shtetases/blerësja H. D., ku deklarohet se kjo shumë është dhënë më 26.4.2015, periudhë kur dhe është marrë në zotërim automjeti, do të ishte subjektive të pranohej pretendimi i subjektit për të përlllogaritur këtë shumë në vitin 2015, madje edhe në muajin prill, sikurse pretendohet, për shkak se kjo periudhë rakordon edhe me blerjen e automjetit, objekt i këtij hetimi administrativ.

- Në konkluzion për këtë pretendim, duke analizuar faktet dhe provat në harmoni me njëra-tjetrën, vlerësohet se në raport me deklaratimet e subjektit gjatë hetimit dhe deklaratën noteriale të shtetases H. D., prevalon deklarimi i subjektit, për këtë pasuri, në deklaratën periodike⁴⁵ për vitin 2015, si dhe kontrata e nënshkruar në datën 29.3.2016, akte ku në asnjërin prej tyre nuk cilësohet mënyra e pagesës në dy këste.

✓ Në përfundim nga përlllogaritjet e kryera, duke konsideruar siç u vlerësua më sipër për secilin pretendim, rezultoi se subjekti ndodhet në balancë negative në shumën 195.874 lekë⁴⁶, për të cilën trupi gjykues në raport me vlerësimin tërësor të procesit të kontrollit të pasurisë, në referencë të parashikimeve ligjore të nenit 51 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të parimit të

⁴³ E cila sipas nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 shërben si provë për këtë proces rivlerësimi.

⁴⁴ Shitja e automjetit është deklaruar në deklaratën e vitit 2015 për shkak të dorëzimit të saj në datën 30.3.2016, ku një ditë më parë ishte realizuar kontrata përkatëse.

⁴⁵ Të cilat sipas nenit 32/5 të ligjit nr. 84/2016 mund të shërbejnë si provë në hetimin e administrativ.

⁴⁶ Ndërsa në rezultatet e hetimit ndodhej në një balancë negative prej 362.516 lekësh.

proporcionalitetit dhe objektivitetit, çmon se nuk është e mjaftueshme për aplikimin e ndonjë mase disiplinore në kuptim të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

5. Llogari me gjendje 15.000 lekë, në “Raiffeisen Bank” – pjesa takuese: 100 %

5.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur se deklarimi i subjektit rezulton me një mospërputhje në vlerën 3.000 lekë, në lidhje me përgjigjen e “Raiffeisen Bank”⁴⁷.

5.2 “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 18.10.2019, konfirmon llogari në emër të subjektit me gjendje në datën 30.1.2017, në shumën 11.941,74 lekë.

✓ Trupit gjykues, në analizë të deklarimit të subjektit në raport me përgjigjen e “Raiffeisen Bank”, i rezultuan diferenca në shuma tepër të vogla, të cilat nuk çmohen se marrin vlerë në këtë vendimmarrje.

6. Apartament me sip. 79 m², blerë nga shoqëria “**” sh.p.k., sipas kontratës noteriale nr. *** rep., nr. ***kol., datë 15.12.2000. Vlera: 19.000 USD. Burimi i krijimit: kursime familjare të ardhura nga paga e subjektit si gjyqtar, si dhe nga kursimet e prindërve. Pjesa takuese: 100 %.**

- Shkëmbim apartamenti, sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.5.2004, në natyrë pa kompensime financiare. Pjesa takuese: 100 %.
- Shitje apartamenti banimi me sip. 65 m², sipas kontratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.9.2004, me vlerë 1.000.000 lekë.

Faktet e konstatuara gjatë hetimit administrativ

6.1 Subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003. Gjithashtu, subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004 shkëmbimin e kësaj pasurie, shitjen e saj, si dhe të ardhurat e përfituara.

Gjatë hetimit subjekti ka depozituar⁴⁸:

- kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr.*** kol., datë 15.12.2000, me palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k., dhe palë blerëse Genti Shala etj., apartament me sip. 79 m², Rr. ***, Tiranë. Vlera: 19.000 USD;
- kontratë shkëmbimi datë 20.5.2004, me palë shkëmbyese S. K. dhe Genti Shala, ku shtetasi S. K. ka në pronësi një apartament me sip. 65 m², në Rr. “****”, Tiranë dhe shtetasi Genti Shala ka në pronësi një apartament me sip. 79 m², në Rr. “****”, Tiranë. Këto dy apartamente shkëmbehen me njëri-tjetrin. Shtetasi Genti Shala, përfaqësuar me prokurë të posaçme nr. *** rep., nr. ***kol., datë 24.1.2001, nga bashkëshorti i tezes së tij, shtetasi A.B., bëhet pronar i apartamentit me sip. 65 m², Rr. “****” dhe shtetasi S. K. bëhet pronar i apartamentit me sip. 65 m², Rr. “****”;
- vërtetim hipotekor nr. *** , datë 1.7.2004, për apartament me sip. 65 m², z.k. *** , Rr. “****”, Tiranë në pronësi të shtetasit Genti Shala;
- kontratë shitjeje nr. *** rep, nr. *** kol., datë 29.9.2004, me palë shitëse Genti Shala dhe palë blerëse A. B., për shitjen e apartamentit me sip. 65 m², Rr. “****”, Tiranë, në vlerën 1.000.000 lekë.

⁴⁷ Aneks nr. 7 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁸ Aneks nr. 4/7, në dosjen e ILDKPKI-së.

6.2 Nga korrespondenca e mbajtur me ASHK-në, Drejtoria Vendore Tiranë Veri⁴⁹, konfirmohet se në emër të shtetasit Genti L. Shala figuron e transkriptuar pasuria apartament me sip. 79 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***. Nga dokumentacioni i depozituar nga kjo drejtori konfirmohen të njëjtat dokumente të depozituara edhe nga subjekti (kontrata e blerjes së pasurisë dhe kontrata e shkëmbimit). Nga kartela e pasurisë vërehet se regjistrimi i pasurisë në emër të shoqërisë “****” sh.p.k., daton më 18.6.2011, ndërsa në emër të subjektit Genti Shala është kryer në datën 13.2.2012. Në po të njëjtën datë (13.2.2012) kjo pasuri ka kaluar në emër të shtetasit S. K. (me të cilin është shkëmbyer apartamenti në vitin 2004).

ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tiranë Jug⁵⁰, konfirmon se shtetasi Genti Shala ka kryer transaksion për pasurinë nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, në favor të shtetasit A. B. dhe për këtë ka depozituar vërtetimin hipotekor, kontratën e shitjes dhe kartelën e pasurisë.

6.3 UKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 1.11.2019, konfirmon një kontratë me nr. *** për objektin në Rr. “****”, me status “e pezulluar” për shkak të detyrimeve të palikuiduara deri në datën 17.10.2019.

6.4 Megjithatë sikurse pasqyrohet më sipër, subjekti e ka tjetërsuar këtë pasuri prej vitit 2004 dhe për shkak të konfirmimit të UKT-së, Komisioni e ka pyetur⁵¹ subjektin.

Në përgjigjen⁵² e dhënë, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar se personalisht nuk ka pasur asnjëherë lidhje kontraktuale me UKT-në me qëllim furnizimin me ujë, si dhe kjo e fundit nuk i është drejtuar asnjëherë për të kërkuar shlyerjen e detyrimit. Apartamenti i regjistruar në emrin e tij ku ka banuar familja e tezes, për shkaqet që ka shpjeguar, ndodhet në Rr. “****”, Tiranë, ndërsa informacioni i dhënë nga UKT-ja për Komisionin tregon për një kontratë në Rr. “****”. Distanca mes këtyre adresave, sipas subjektit, është e konsiderueshme. Subjekti ka qartësuar se ndryshojnë numrat e kontratave midis banesës ku ka jetuar teza e tij dhe atij të pasqyruar në informacionin e UKT-së. Po ashtu, subjekti ka sqaruar se informacioni i UKT-së qartëson se kontrata ka të regjistruar nr. frymë 4 persona, ndërkohë që në apartamentin që ka shpjeguar se ka jetuar teza e tij, bashkëshorti dhe i biri, pra kanë qenë 3 persona në total, pasi vajza e tyre ka qenë e martuar dhe ka jetuar në Greqi me familjen e saj dhe nuk ka qenë pjesë e certifikatës familjare të tezes në kohën që kanë jetuar në këtë banesë. Subjekti sqaron se të dhënat e njëjta me identitetin e tij kanë përkuar në mënyrë rastësore. Subjekti ka deklaruar se shtetasi me identitetin e tij, i cili ka debinë ndaj UKT-së sipas kontratës nr. ***, nuk është ai dhe se nga dokumentacioni shoqërues që UKT-ja disponon kontrata e lidhur për shërbimin e ujit në banesën e regjistruar në emrin e tij për banimin e familjes së tezes, mban kodin nr. ***. Subjekti ka depozituar përgjigjen nr. *** prot., datë 8.6.2020, të UKT-së. Kjo e fundit, në informacionin e dhënë, sqaron se pasi ka bërë verifikimet e duhura, ka rezultuar se kontrata që ka paraqitur për Komisionin nuk është e njëjta me kontratën që ka qenë e regjistruar për apartamentin ku ka jetuar familja B. .

Subjekti ka depozituar gjithashtu:

- historikun e faturimit të kontratës;
- informacion për titullarin e kontratës;

⁴⁹ Shkresë nr*** prot., datë 14.11.2019, si dhe dokumentacioni shoqërues.

⁵⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 5.11.2019, si dhe dokumentacioni shoqërues.

⁵¹ Me pyetësin nr. 5, datë 1.6.2020.

⁵² Me e-mail datë 8.6.2020.

- kartelën shoqëruese të praktikës dhe formular i prezantimit të kërkesës ose ankesës, datë 25.3.2016;
- kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.9.2009, me palë shitëse S. K. dhe palë blerëse H. Th.;
- vërtetimin nga dokumentet hipotekore nr***, datë 5.7.2004, ku në fund të këtij dokumenti është shënuar edhe origjina e pronës me të dhënat nr. ***, datë 9.4.2001;
- kopjen faturë tatimore shitjeje, janar të vitit 2008, nga ku rezulton se kontrata nr. *** është e regjistruar në emër të shtetasit S. K.;
- kopjen faturë tatimore shitjeje, prill të vitit 2020, nga ku rezulton se kontrata nr. *** është e regjistruar edhe aktualisht në emër të shtetasit H. Th. .

6.5 Lidhur me kontratën e energjisë elektrike subjekti ka depozituar përgjigjen nr. *** prot., datë 8.6.2020, të dhënë nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (OSHEE) sh.a. Furnizuesi i Shërbimit Universal në informacionin e dhënë deklaroi se pas verifikimeve të bëra nuk rezulton asnjë kontratë në emrin e shtetasit Genti L. Shala për sa i përket qytetit të Tiranës. Nga korrespondenca e mbajtur me FSHU-në⁵³ rezulton se shtetasi A. B. është titullar i kontratës nr. ***, në adresën: Rr. “****”, pasuri kjo që korrespondon pikërisht me pasurinë e përfitur nga kontrata e shkëmbimit dhe ajo e blerjes.

6.6 Komisioni e ka pyetur⁵⁴ subjektin mbi këtë pasuri dhe veprimet e kryera me të. Në përgjigjen e dhënë subjekti, ndër të tjera, ka sqaruar se kjo pasuri nuk ka qenë kurrë e tij por e familjes së tezes (subjekti ka bërë me dije se shtetasi A. B. është burri i tezes), kjo për faktin se familja e tezes ndodhej në një situatë të vështirë financiare përpara huadhënësve, të shkaktuar për shkak të huave të të birit. Subjekti ka deklaruar se madje për të shlyer këto borxhe ata kanë shitur edhe shtëpinë e tyre. Më ekzaktësisht ka deklaruar: *“Në dhjetor të vitit 2000 tezja dhe bashkëshorti i saj kishin gjetur një mundësi për të blerë një apartament në periferi të qytetit të Tiranës, në rrugën ‘***’, me një çmim prej 19.000 USD, pasi në këtë zonë çmimet në atë kohë ishin më të lira sesa në zonat e tjera. Në kushtet kur ata kishin arritur të grumbullonin një pjesë të çmimit, por u mungonin dhe 1.000.000 lekë nga çmimi i apartamentit, tezja dhe bashkëshorti i saj kanë ardhur në shtëpinë time në Shkodër dhe u kanë treguar prindërve të mi situatën në të cilën ndodheshin dhe nevojën që kishin për një hua në këtë vlerë. Prindërit ishin të gatshëm të ndihmonin tezen dhe në kushtet që nuk e kishin të gjithë shumën prej 1.000.000 lekësh, por vetëm gjysmën e saj rreth 500.000 lekë, e kanë ndarë shqetësimin e tyre me motrat e mia, shtetaset T.G. dhe T. Q. . Motrat e mia, së bashku, i kanë dhënë prindërve të mi shumën rreth 500.000 lekë, duke bërë kështu që të plotësohej shuma që i nevojitej tezes sime dhe bashkëshortit të saj. Unë kam shkuar në Tiranë në datën 15.12.2000 dhe jam takuar me tezen dhe bashkëshortin e saj, për t’i dorëzuar shumën e siguruar nga prindërit dhe motrat e mia, gjithsej 1.000.000 lekë. Tezja dhe bashkëshorti i saj, më shprehën dyshimin, frikën dhe hezitimin që kishin për ta blerë banesën në emrin e tyre, për shkak të detyrimeve të pashlyera të të birit, që e detyruan të shiste banesën e tyre të mëparshme. Në këto rrethana, ata më kërkuan që kontratën për apartamentin që kishin vendosur të blinin ta regjistronin në emrin tim, për të qenë ata të qetë, si dhe për të siguruar borxhin e dhënë nga ana e familjarëve të mi... Pas kësaj bisede kemi shkuar tek noteri dhe unë kam nënshkruar kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.12.2000. Këtë kontratë tezja dhe bashkëshorti i saj e kanë depozituar më pas në Hipotekën Tiranë, ku mbi këtë bazë apartamenti është regjistruar formalisht në emrin tim. Ndërsa kjo banesë për arsyet e mësipërme nuk ishte realisht pronë e imja, por faktikisht e tezes*

⁵³ Shkresë nr*** prot., datë 25.6.2020.

⁵⁴ Pyetësori nr. 2, datë 27.3.2020, dhe dokumentacioni shoqërues.

*dhe bashkëshortit të saj, me qëllim që ata të ishin të lirë për të bërë çdo veprim me të. Disa ditë më pas, unë u kam lëshuar një prokurë⁵⁵ të posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.1.2001, nëpërmjet të cilës i kam dhënë bashkëshortit të tezes, shtetasit A. B., çdo të drejtë, përfshirë dhe tjetërsimin, mbi këtë apartament dhe i kam kërkuar që të përpiqeshin që në një kohë sa më të shpejtë dhe të përshtatshme ta kalonin pronësinë edhe formalisht në emër të tyre. Në fund të vitit 2003, në kushtet kur mua më kishte lindur detyrimi ligjor për të deklaruar në mënyrë të saktë pasurinë, i kam kërkuar që të gjenin një zgjidhje për ta kaluar banesën në emrin e tyre. Ata më kanë thënë se po shikonin mundësinë që ta shisnin banesën, pasi ajo u kishte rezultuar me shumë probleme teknike dhe do të blinin një banesë tjetër më të përshtatshme. Në këto kushte, duke qenë 'de facto' pronari i apartamentit ka qenë bashkëshorti i tezes ai që e ka shkëmbyer atë me një apartament tjetër, duke lidhur ai kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.5.2004, ku vazhdon dhe banon pa ndërprerje edhe aktualisht. Ndërkohë, në vitin 2004, pasi kam ardhur në dijeni të faktit se banesa e tezes vazhdonte të figuronte formalisht në emrin tim, edhe pas kontratës së mësipërme të këmbimit, i kam kërkuar bashkëshortit të tezes, shtetasit A. B., që të kryenim veprimet e nevojshme për kalimin e pronësisë në emrin e tij, pasi për shkak të detyrës së gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër më kishte lindur detyrimi ligjor për deklarimin e saktë të pasurisë. Në shtator 2004 apartamenti ka kaluar edhe 'de jure' në pronësi të shtetasit A. B., sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.9.2004, të cilën e kam nënshkruar personalisht. Në këtë kontratë, si çmim është vendosur shuma prej 1.000.000 lekësh, që ishte detyrimi që tezja dhe bashkëshorti i saj kishin ndaj prindërve të mi dhe që në fakt ishte kthyer nga familja e tezes tek prindërit e mi pothuajse plotësisht, deri në fund të vitit 2003.”*

Subjekti⁵⁶ ka depozituar:

- kontratën e shitjes nr. *** rep., nr.*** kol., datë 11.11.1996, ku nënshkruhet shitja e banesës së familjes B., së bashku me aktet e privatizimit të saj në vitin 1994;
- deklaratën nr.***rep., nr. *** kol., datë 6.9.1996, të huadhënësit E. T.;
- deklaratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.6.1996, të shtetasit A. B.;
- deklaratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.9.1996, të shtetasit A. B., në të cilën deklaroi se i ka detyrim shtetasen M. S. një shumë parash dhe si garanci ka lënë pjesën e tij takuese të apartamentit të banimit të regjistruar në emër të familjes së tij;
- deklaratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.11.1996, të huadhënësve B. H. dhe M. S., ku këta të fundit, në të njëjtën ditë kur është shitur apartamenti, japin pëlqimin që kjo pronë të shitej, pasi ishte lënë si garanci nga shtetasi A. B. për të siguruar huan e marrë prej tij;
- shënim transkriptimi në të cilin janë pasqyruar bllokimet që i janë bërë banesës së familjes së tezes Gj.B., në favor të huadhënësve të të birit A. B. .

6.7 Nga dokumentacioni i depozituar provohen marrëdhëniet e huamarrjeve të të afërmit të subjektit, sikurse ky i fundit ka deklaruar. Po ashtu, provohet bllokimi i pasurisë në ZVRPP-në në favor të huadhënësve deri në shitjen e saj. Sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.11.1996, provohet deklarimi i subjektit se të afërmit e tij kanë shitur pasurinë që kanë disponuar. Gjithashtu provohet se shkëmbimi i pasurisë së subjektit është bërë nëpërmjet përfaqësuesit të tij me prokurë, z. A. B. (burri i tezes së subjektit), akt i nënshkruar nga ky i fundit nën këtë cilësi. Pra, në tërësi duket se deklarimet e subjektit për të provuar interesin e blerjes së kësaj pasurie në

⁵⁵ Akt i depozituar po në pyetësorin nr.2, datë 27.3.2020.

⁵⁶ Me e-mail datë 8.6.2020.

favor të të afërmeve të tij për shkaqet dhe arsyet e bëra prezent prej këtyre të fundit, përputhen edhe me dokumentacionin provues të depozituar.

6.8 Gjithashtu, subjektit i është kërkuar⁵⁷ të depozitojë dokumentacion provues lidhur me administrimin e kësaj pasurie që prej kohës së tjetërsimit të saj në favor të blerësve.

Subjekti⁵⁸ ka depozituar:

- vërtetim nr. *** prot., datë 5.6.2020, të lëshuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tiranë Veri;
- vërtetim nr. *** prot., datë 5.6.2020, të lëshuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tiranë Veri;
- deklaratë noteriale nr. ***, datë 8.6.2020, të lëshuar nga bashkëshorti i tezes, shtetasi A. B. dhe deklaratë nr. ***, datë 8.6.2020, të lëshuar nga tezja e tij, Gj. B. .

6.9 Nga verifikimi i vërtetimeve të sipërcituara rezulton se shtetasi A. B. është edhe sot pronari i pasurisë së paluajtshme apartament me sip. 65 m², në z. k. ***, vol ***, f. ***, që është apartamenti i shkëmbyer dhe se shtetasi A. B., deri në periudhën 31.12.2003, nuk ka pasur asnjë pasuri tjetër të regjistruar në emrin e tij.

6.10 Nën të gjithë argumentet më sipër, Komisionit i rezultoi se pavarësisht deklarimit të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*, subjekti nuk e kishte deklaruar blerjen, shkëmbimin, si dhe shitjen e saj, përkatësisht në deklaratat periodike vjetore të viteve 2003 dhe 2004 dhe për këtë fakt i kërkoi subjektit të japë shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

6.11 Subjekti në parashtrimet e tij ka shpjeguar se kjo pasuri, nuk është e deklaruar në deklaratat periodike 2003 dhe 2004, për arsye të cilat ai i ka shpjeguar në përgjigjet e Pyetësorit Nr. 2. Në tërësi në qëndrimin e tij ka ripërsëritur deklarimet e bëra në këtë pyetësor, duke qartësuar marrëdhënien familjare midis tij, familjarëve të tij dhe pronarit legjitim të pasurisë, shtetasit A. B.. Ndër të tjera subjekti ka theksuar marrëdhëniet e veçanta që ai dhe motra e tij kanë pasur me familjen e tezes për shkak të jetës tyre studentore në qytetin e Tiranës duke e quajtur atë si një familje të dytë dhe si mbështetjen kryesore të tyre. Subjekti ka synuar të japë detaje edhe mbi ngritjen e aktivitetit tregtar të djalit të tezes së tij A. B., rreth viteve 1995-1996, mbi huamarrjet e këtij të fundit nga persona të ndryshëm, duke iu lënë disave prej tyre, si garanci, pjesën takuese që kishtë në shtëpinë e tij në bashkëpronësi me familjarët e tij. Gjithashtu ka sqaruar se aktiviteti privat i djalit të tezes ka rezultuar i pasuksesshëm, çka ka sjellë mos shlyerjen në afatin e caktuar të huave të marra dhe se për shkak se është gjendur nën presionin e huadhënësve, u ka kërkuar prindërve të tij të shisnin banesën ku jetonin, në adresën Rruga “****”, P. ***, Shk. ***, Ap. ***, Tiranë, e privatizuar me anë të Kontratës së Shitblerjes Nr. *** Rep., Nr. *** Kol., datë 18.02.1994 dhe e regjistruar në Hipotekën Tiranë në Regjistrin hipotekor Nr. ***, datë 18.02.1994, në bashkëpronësi të shtetasve A.B., Gj. B., A. B. dhe D. B. . Subjekti ka qartësuar se megjithë shitjen e banesës me qëllim shlyerjen e huave, sasia e parave të siguruara nuk mbulonte të gjithë detyrimet e huave të marra nga i biri i tyre dhe në këto rrethana (është shprehur ai) tezja dhe familja e saj, jo vetëm që humbën shtëpinë, por nga ana tjetër, një pjesë e borxheve të djalit të tyre ngelen të pa mbyllura. Në vijim subjekti ka deklaruar veprimet e kryera mbi këtë pasuri si dhe ka referuar edhe një herë të gjithë dokumentacionin mbështetës mbi deklarimet e tij.

⁵⁷ Me pyetësorin nr. 5, datë 1.6.2020.

⁵⁸ Me e-mail datë 8.6.2020.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

6.12 Trupi gjykues, në vlerësim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti për këtë pasuri, si gjatë hetimit administrativ, edhe në parashtrimet e depozituara të të gjithë dokumentacionit të administruar, për të provuar saktësinë dhe vërtetësinë e deklarimeve mbi të në raport me ligjin e zbatueshëm, arsyeton si vijon:

Deklarimi i bërë nga subjekti për këtë pasuri në deklaratën *Vetting* merr një vlerë të rëndësishme në favor të subjektit në raport me faktin se subjekti nuk e kishte deklaruar më parë këtë pasuri dhe më konkretisht nuk kishte deklaruar blerjen e saj në deklaratën për vitin 2003, si dhe shkëmbimin dhe shitjen në vitin 2004.

Kronologjia e dhënë në mënyrë të detajuar nga subjekti lidhur me këtë pasuri, veprimet e ndërmarrja prej tij, duke i lëshuar prokurë shtetasin A. B.(në lidhje të afërt/burrë teze) për tjetërsimin e saj dhe ndërmarrja e të gjithë veprimeve nga ky i fundit, duke u kthyer edhe në blerësin e saj, me gjithë një shkëmbim paraprak të kryer, përjashton subjektin nga shprehja e interesit për këtë pasuri.

Në vijim të këtij konstatimi trupi gjykues ka vlerësuar faktet e tjera të konkluduara gjatë hetimit të thelluar. Më konkretisht: (i) subjekti nuk rezultoi në asnjë rast titullar i kësaj pasurie në kontratën e energjisë elektrike dhe atë të ujit; (ii) i gjithë dokumentacioni i depozituar nga subjekti për të provuar arsyen e blerjes së kësaj pasurie, veprimet e kryera me të, tjetërsimet e saj, si shkëmbimi dhe shitja, disponuesin e të drejtave reale mbi të (familjen e tezes së tij), pra, pasqyrimi i gjithë historikut pronësor është hartuar dhe nënshkruar në kohën kur kanë ndodhur veprimet me këtë pasuri, pra, thënë ndryshe, dokumentacioni është prodhuar dhe ka gjeneruar pasoja në kohë reale.

Trupi gjykues, nga dokumentacioni i administruar jo vetëm konstatoi, por edhe krijoi bindjen nga shpjegimet koherente të subjektit, se fillimisht shtetasi A. B. kishte realizuar shitjen e apartamentit të tij të prejardhur nga privatizimi i banesave shtetërore për shkak të huave që djali i tij (njëkohësisht djali i tezes së subjektit) kishte pasur nga ushtrimi i biznesit, fakt që kishte nxitur nevojën e banimit të tyre. Kjo shitje provohej nga barra hipotekore e pasqyruar në hipotekë në favor të huadhënësve apo thënë ndryshe borxhlinjve. Po ashtu, huat konfirmoheshin nga deklaratimet e huadhënësve në kohë reale. Pra, kjo situatë bën të besueshëm faktin se subjekti për shkak të lidhjes fisnore të afërt është vënë në lëvizje, mbështetur nga prindërit e tij, për të mundësuar jetesën e familjarëve të tij në kushtet e mungesës së një banese. Duke u provuar këto fakte, po aq i besueshëm bëhet edhe argumenti i subjektit se fillimisht ai kishte vënë apartamentin objekt hetimi administrativ në emrin e tij, për një arsye të vetme që të mos bëhej edhe kjo pasuri objekt hipotekimi për të grantuar kthimin e borxheve huadhënësve.

Mosdeklarimin e kësaj pasurie nga subjekti në vitin 2003, trupi gjykues, në vlerësim të këtij hetimi, e sheh si një veprim të ndërvarur nga situata e shpjeguar më sipër, e cila duket objektive, e karakterizuar nga detaje që bëjnë diferencën në këtë çështje. Po ashtu, këtë logjikë e mbështet edhe fakti që pasuria ishte destinuar për të përmbushur një qëllim të caktuar familjar, subjekti duket të mos i ketë kushtuar kujdesin e duhur detyrimit ligjor për të deklaruar në kohë titullarin dhe të drejtat reale mbi të. Në këtë rrjedhë logjike duket se nuk janë deklaruar edhe veprimet e radhës, pra shkëmbimi dhe shitja e saj, për më tepër që këto veprime janë kryer me prokurë dhe jo nga vetë subjekti, duke i dhënë kështu në mënyrë indirekte, përfaqësuesit me prokurë, pozitën e tij pronësore.

6.13 Në përfundim, pavarësisht që nga faktet e dala, ka rezultuar se subjekti nuk e ka poseduar apo gëzuar *de facto* këtë pasuri, nënshkrimi i kontratës së blerjes duhet të ishte deklaruar në deklaratën periodike për vitin 2003. Trupi gjykues çmon se në tërësinë e rrethanave dhe provave të administruara, si dhe të faktit se subjekti ka deklaruar me saktësi dhe vërtetësi këtë pasuri në deklaratën për Veting, sipas kërkesave të ligjit nr.84/2016, mosdeklarimi në vitin 2003, ka vlerën e një pasaktësie. Nga ana tjetër sikurse është theksuar më sipër në pikën 2.14 dhe në pikën 6.14 e në vijim, Komisioni nuk e ka përlllogaritur këtë vlerë në analizë financiare.

Në lidhje me shumën 1.000.000 lekë, përdorur si burim për blerjen e kësaj pasurie

6.14 Komisioni fillimisht konstatoi mospërputhje midis deklarimeve të bëra nga subjekti, lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie në emrin e tij. Më konkretisht, ndërsa në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si burim krijimi për këtë pasuri *kursimet familjare të ardhura nga paga e tij si gjyqtar, si dhe kursimet e prindërve të tij*, gjatë hetimit ka deklaruar si burim *të ardhurat e familjes B. (familja e tezes së subjektit) dhe shumën 1.000.000 lekë të marra hua dhe se shuma e huas që familja B. ka marrë, ka burim 500.000 lekë nga kursimet e prindërve dhe 500.000 lekë nga kursimet e motrave të tij, T. G. dhe T. Q. .*

6.15 Subjekti, pasi është pyetur, ndër të tjera, ka cituar:⁵⁹“... lidhur me burimin e krijimit të deklaruar në deklaratën *Vetting* ‘kursime familjare të ardhura nga paga ime si gjyqtar, si dhe nga kursimet e prindërve të mi’, kam pasur parasysh shumën prej 1.000.000 lekësh që familja ime vuri në dispozicion të familjes së tezes sime, shtetases Gj. B. në formë huaje në vitin 2000, për blerjen e apartamentit në rrugën ‘***’, Tiranë. Gjatë hetimit administrativ kam shpjeguar se një pjesë e kësaj shume, rreth 500.000 lekë, është krijuar nga kursimet e familjes sime deri në vitin 2000, nëpërmjet pagave të mia dhe pensioneve të prindërve, ndërsa pjesa tjetër, prej rreth 500.000 lekësh, iu dhanë prindërve të mi për të ndihmuar familjen e tezes, nga dy vajzat e tyre (motrat e mia) të martuara, shtetaset T. G. dhe T. Q. . Prindërit e mi, me kursimet e familjes sonë, ua kthyen këtë shumë gradualisht motrave të mia dhe, për pasojë, marrëdhënia e huadhënies me familjen e tezes sime Gj. B. u vazhdua vetëm prej prindërve të mi, deri në kthimin e plotë të shumës së dhënë hua prej 1.000.000 lekësh. Deri në momentin kur familja e tezes sime, shtetases Gj. B., ktheu plotësisht huan tek prindërit e mi deri në fund të vitit 2003, prindërit e mi kishin kthyer tek vajzat e tyre, me kursimet e familjes sonë, shumën prej rreth 500.000 lekësh dhe, për këtë arsye, e kam konsideruar shumën prej 1.000.000 lekësh si kursime të familjes sime.”

6.16 Subjekti ka depozituar: (i) deklaratën noteriale nr. ***, datë 6.6.2020, të shtetases T. Q.; dhe (ii) deklaratën noteriale nr. ***, datë 4.6.2020, të shtetaseve A. B. dhe A. G. .

6.17 Komisioni, duke e vlerësuar në tërësi historikun e kësaj pasurie, kreu analizën financiare duke u bazuar në deklarimin e subjektit gjatë hetimit se prindërit e tij i kanë dhënë hua shumën 500.000 lekë familjes së tezes për të investuar në blerjen e apartamentit. Komisioni, për këtë analizë, përfshiu të ardhurat e prindërve të subjektit për periudhën 1991 – 2000. Shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur 70 % e të ardhurave për vitet 1991 – 1996 dhe 5.000 lekë/frymë/muaj për vitet 1997 – 2000. Meqenëse subjekti ka deklaruar se për ndërtimin e shtesës së apartamentit burim ka qenë edhe paga e tij si ndihmësgjyqtar, këto të ardhura janë përfshirë në analizën e mëposhtme për vitet 1995 – 1998 dhe, për pasojë, janë përlllogaritur edhe shpenzimet e jetesës për vitet 1995 – 1998 për tre persona. Për të gjithë periudhën tjetër shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur vetëm për dy persona.

⁵⁹ Me pyetësorin nr. 5, datë 1.6.2020.

6.18 Nga analiza financiare, Komisionit i rezultoi se dukej se prindërit e subjektit me të ardhurat e tyre nga pensioni nuk kishin pasur mundësi financiare në shumën 548.127 lekë për të dhënë huan prej 500.000 lekësh të deklaruar nga subjekti gjatë hetimit administrativ, në favor të blerjes së kësaj pasurie dhe, për pasojë, i kaloi subjektit barrën⁶⁰ e provës për të dhënë argumentet në lidhje me konstatimet e bëra.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

6.19 Subjekti, në parashtrimet e tij, ka shpjeguar se: *“Deklarimi i përafërt në deklaratën Vetting i të ardhurave të mia gjatë kohës së ushtrimit të funksionit të ndihmësgjyqtarit për vitet 1995 - 1998 është bërë në masën 600.000 lekë.*

Në rezultatet e hetimit të KPK-së gabimisht janë pasqyruar të ardhurat e mia vetëm si ndihmësgjyqtar, ndërkohë që nuk janë pasqyruar të ardhurat e mia nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër gjatë periudhës 1998 – 2000, për një shumë prej 936.089 lekësh, sipas dokumentit të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, të cituar në përgjigjen nr. 1 të këtyre shpjegimeve.

*Gjithashtu, janë saktësuar të ardhurat nga paga ime si ndihmësgjyqtar në shumën prej 625.600 lekësh. Këto të ardhura konfirmohen nga vërtetimi për pagën neto dhe bruto, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe nga vërtetimi nr*** prot., datë 13.7.2020, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në të cilin tregohet paga e saktë e ndihmësgjyqtarit në këtë periudhë. Ky akt vërteton pagën e ndihmësgjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, por në kushtet kur dokumentet që vërtetojnë pagën time si ndihmësgjyqtar në Gjykatën e Rrethit Malësi e Madhe, nuk mund të gjenden, pasi kjo gjykatë nuk ekziston aktualisht, po e paraqes si dokument referues.*

Sipas përllogaritjes së bërë, për sa i përket ‘shpenzimeve për jetesë’ gjatë viteve 1991 – 1997, ato duhen analizuar sipas konkluzionit të pranuar edhe në pikën 24.9 të vendimit të arsyetuar nr. 12, datë 17.12.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ku theksohet se: Duke mbajtur në konsideratë të gjitha të ardhurat e subjektit të rivlerësimit, përfshirë edhe periudhat e pretenduara si të pallogaritura, duke përfshirë edhe koston e jetesës, jo më shumë se 30 % të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit deri në muajin janar 1997...

Në shënimin nr. 2, në fund të faqes 18 të këtij vendimi, KPA-ja përcakton se: referenca në nivelin 30 % është mbajtur në konsideratë për këtë vendim, duke qenë se ky ishte standardi i përllogaritjeve të Komisionit.

Shpenzimet e jetesës në vitet 1991 – 1996 kanë qenë ndjeshëm më të ulëta se sa janë përllogaritur në tabelën përkatëse të rezultateve të hetimit të KPK-së, por nuk është e mundur të gjendet një burim zyrtar për të mbështetur këtë qëndrim, pasi diskutohet për një periudhë shumë të largët, për të cilën mungojnë të dhënat statistikore.”

Subjekti ka reflektuar rilloaritjet e tij sipas pretendimeve të sipërcituara dhe njëkohësisht i ka pasqyruar edhe në mënyrë tabelare, duke saktësuar se familja e tij ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e huas në masën 500.000 lekë për familjen e tezes në fund të vitit 2000.

Në funksion të përmbushjes së detyrimit për barrën e provës, subjekti ka depozituar: (i) vërtetim për pagën *neto* dhe *bruto*, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër; dhe (ii) vërtetim nr. *** prot., datë 13.7.2020, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁶⁰ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

6.20 Trupi gjykues, në analizë të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, të dokumentacionit të depozituar, arsyeton si vijon:

Në lidhje me pretendimin e subjektit se duhen rillogaritur në analizën financiare të ardhurat e sakta të përfituara nga punësimi i tij si në pozicionin e ndihmësgjyqtarit dhe në atë të gjyqtarit, në raport me përlogaritjet në rezultatet e hetimit administrativ, trupi gjykues çmon të mos ripërsëritet, pasi është shprehur dhe ka konsideruar këtë pretendim në këtë vendimmarrje, për sa kohë dokumentacioni mbështetës ka qenë në nivel institucional. Ndërsa, lidhur me pretendimin e subjektit për sa i përket shpenzimeve të jetesës, të cilat duhen përlogaritur në një masë më të ulët se ajo e paraqitur nga Komisioni në rezultatet e hetimit, nën dritën e objektivitetit çmon të qëndrojë afër pretendimit të subjektit, për më tepër që bëhet fjalë për një periudhë kohore që nuk kanë ekzistuar të dhëna statistikore të sakta, si dhe për shkak se për atë periudhë, për të njëjtin kërkim, ekzistojnë vendimmarrje të mëparshme të Komisionit, mbi të cilat edhe bazohemi.

6.21 Në këtë këndvështrim, rillogaritjet e kryera kanë konkluduar në balancë pozitive nga ajo e pasqyruar në rezultatet e hetimit administrativ dhe, për pasojë, rezultojnë se prindërit e subjektit kanë pasur të ardhura për të krijuar shumën 500.000 lekë dhënë në formë huaje z. A. B. për arsyet e sipërpërmendura.

Po ashtu, qarkullimi i shumës (dhënie në formë huaje personit të familjes dhe reciprokisht shlyerje) 1.000.000 lekë brenda rrethit familjar deri në vitin 2003, pas kësaj analize gjithëpërfshirëse dhe objektive, rezultojnë mëse i pranueshëm se nuk mund të trajtohet si një e ardhur e përfituar nga të tretë. Deklarimi i kësaj shume si e ardhur nga shitja e pasurisë thjesht dhe vetëm ka sjellë efekte në rikthimin e saj nga z. A. B. te prindërit e subjektit, ndërsa nuk është përlogaritur në asnjë prej analizave financiare të pasurive të deklaruara. Kjo jo vetëm për faktin se vetëm 500 000 lekë kanë qenë të prindërve të subjektit dhe pjesa tjetër e motrave të tij, por gjithashtu edhe për faktin se kjo shumë nuk është deklaruar si gjendje cash në deklaratën periodike të vitit 2004. Komisioni i ka qëndruar deklarimit të subjektit për sa i përket likuiditeteve të kursyera gjatë vitit 2004 dhe në vazhdim kur është investuar në blerjen e apartamentit.

DETYRIME FINANCIARE

7. Detyrimi ndaj “Credins Bank”, për kredinë prej 50.000 euro, të datës 24.10.2012, për të cilën subjekti ka paguar 387 euro/muaj. Gjendja e detyrimit: 75.000 euro deri në datën 24.10.2032. Kësti mujor: rreth 370 euro. Subjekti ka paraqitur⁶¹ pasqyrë kredie të “Credins Bank”, datë 25.1.2017, kredia e disbursuar me datë 24.10.2012, në vlerën 50.000 euro.

ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur se *deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, përgjigjen e “Credins Bank” dhe DPPP-në. Subjekti ka deklaruar gjendje totale të detyrimit së bashku me interesat, gjendja e mbetur e detyrimit është në shumën 44.164 euro (pa përfshirë interesat).*

Komisioni e ka trajtuar këtë kredi në pasurinë nr. 4 të sipërcituar.

Sipas dokumentacionit (*statement*) të dërguar nga “Credins Bank”, rezultojnë se detyrimi i mbetur deri në datën 30.1.2017 është në shumën 44.164,51 euro.

⁶¹ Shihni Aneksin nr. 4/8, në dosjen e ILDKPKI-së.

- ✓ Subjekti, në deklarinimin e tij, nuk paraqet detyrim të mbetur vetëm principalin, por deklaron si detyrim të mbetur edhe interesat. Në të tilla kushte, trupi gjykues nuk ka konstatuar asnjë problematikë.

8. Detyrimi ndaj shoqërisë “**” sh.p.k.,** për shkak të diferencës së papaguar të çmimit të përgjithshëm të pasurisë nr. 2, në vlerën 4.661.400 lekë.

9. Detyrimi ndaj shoqërisë “**” sh.p.k.,** për shkak të blerjes së sipërfaqes prej 20.2 m², në vlerën 1.161.500 lekë, rezultuar e tepërt në apartamentin objekt shitblerje (pasuria nr. 2).

Komisioni i ka trajtuar së bashku këto dy detyrime pasi janë për të njëjtën pasuri. Në lidhje me to ka konstatuar:

- Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013 subjekti deklaron “marrëveshje për blerjen e sipërfaqes prej 20.2 m²”, e cila ka rezultuar brenda apartamentit të blerë përtej sipërfaqes prej 249 m². Çmimi: 400 euro/m². Totali: 1.161.500 lekë. Afati i shlyerjes: data 31.12.2014.

- Në deklaratat periodike vjetore të viteve 2014, 2015 dhe 2016 subjekti deklaron si detyrim i mbetur ndaj shoqërisë “****” sh.p.k.:

- shumën 4.661.400 lekë, për shkak të diferencës së papaguar të çmimit të përgjithshëm; dhe
- shumën 1.161.500 lekë, për shkak të blerjes së sipërfaqes shtesë prej 20.2 m² të rezultuar brenda apartamentit të porositur prej tij.

Komisioni e ka pyetur⁶² subjektin mbi këto deklarime, pasi vlera e paguar prej 33.000 euro në vitin 2017, e konvertuar në lekë, nuk përbënte vlerën 5.822.900 lekë (4.661.400 + 1.161.500). Ndër të tjera, subjekti ka sqaruar se: *“Në lidhje me vlerën e deklaruar në deklaratën periodike për vitin 2017, sqaroj se vlera 4.661.400 (katër milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e katërqind) lekë është vlera e detyrimit total që unë i kam pasur shoqërisë së ndërtimit ‘****’ sh.p.k., ku përfshihet vlera prej 25.000 euro, e cila është kësti i tretë dhe i fundit i pagesës së shtëpisë sipas kontratës fillestare për sipërfaqen 249 m², si dhe vlera e sipërfaqes të rezultuar e tepërt pas marrjes në dorëzim të apartamentit prej 20.2 m², prej 1.161.500 (një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind) lekë. I kam shënuar në dy zëra të ndryshëm të deklaratës këto vlera, duke specifikuar në një zë të gjithë detyrimin që kishim për t’i paguar kompanisë ndërtuese, dhe në zë tjetër vlerën e posaçme për sipërfaqen prej 20.2 m², për shkak se kjo sipërfaqe nuk ka qenë objekt i kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 28.12.2013, por ka rezultuar e tillë vetëm pas marrjes në dorëzim të apartamentit të banimit. ...Pra, shuma prej 33.000 euro përfshin këstin e tretë të apartamentit prej 25.000 euro dhe shumën prej 8.000 euro, që është çmimi i sipërfaqes që ka rezultuar më tepër pas përfundimit të ndërtimit.”*

Pas shpjegimeve të subjektit, por edhe analizës së kryer nga Komisioni për këtë pasuri, rezulton se:

- ✓ Detyrimi total i mbetur⁶³ për apartamentin me sip. 249 m² dhe shtesën me sip. 20.2 m², është në shumën 4.661.400 lekë. Nga ky detyrim shuma prej 1.661.500 lekësh është për shtesën me sip. 20.2 m². Në të tilla kushte, trupi gjykues ka konstatuar se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar.

⁶² Pyetësor nr. 4, datë 28.5.2020.

⁶³ Referuar deklaratës *Vetting*, pasi kjo pasuri është likuiduar në dhjetor të vitit 2017.

Deklarimi i pasurive të bashkëshortes së subjektit, znj. M. Sh. (D.)

10. Pasuri e trashëguar me sip. 239.85 m² me nr. pasurie ***, lagjja “***”, Shkodër, (shtëpi banimi e familjes së origjinës që nga viti 1930). Pjesa takuese: 33.3 %.

10.1 Bashkëshortja e subjektit e deklaron për herë të parë këtë pasuri, me të njëjtin përshkrim si më sipër, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013.

10.2 Për këtë pasuri subjekti ka depozituar⁶⁴: vërtetimin hipotekor nr. ***, datë 4.2.2008, për pasurinë me sip. 239.85 m², 131 m² ndërtesë, me nr. pasurie ***, z. k. ***, lagjja “***”, Shkodër, në bashkëpronësi me shtetasit K. D., V. D. dhe M. D. (Sh.). Origjina e regjistrimit: nr. hipotekor ***, datë 23.3.1999; nr. hipotekor ***, datë 11.6.1955; nr. hipotekor ***, datë 21.12.2007.

10.3 Sipas dokumentacionit⁶⁵ të administruar, konfirmohet se bashkëshortja e subjektit është bashkëpronare në pasurinë e llojit truall, me sip 323 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, nga e cila 131 m² ndërtesë. Konfirmohet se pasuria rrjedh nga trashëgimia ligjore e të ndjerit, babait të bashkëshortes së subjektit, si dhe nga kontrata e shitjes nr. ***, datë 27.12.2007, në shumën 100.000 lekë, midis shtetas A. D. dhe blerësve K. D., V. D. dhe M. D. (Sh.). Edhe kartela e pasurisë identifikon në këtë pasuri të tri bashkëpronarët e sipërpërmendur në pjesë takuese të barabarta.

✓ Trupi gjykues, nga dokumentacioni i administruar, arrin në konkluzion se subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi këtë pasuri.

11. Automjet tip “VW Golf Plus”, vit i prodhimit 2006, me nr. shasie ***, blerë në datën 26.4.2015. Vlera: 600.000 lekë. Burimi i krijimit: shitja e automjetit tip “Mercedes Benz A Class”, sipas kontratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.3.2016, në vlerën 380.000 lekë, si dhe kursime nga paga e bashkëshortes dhe e subjektit. Pjesa takuese: 100 %.

11.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur se *deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e DPSHTRr-së.*

Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ

11.2 Bashkëshortja e subjektit e deklaron për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike të vitit 2015 me përshkrimin “blerje e automjetit tip ‘VW Golf Plus’, viti i prodhimit 2006, me nr. shasie ***, datë 26.4.2015, në vlerën 600.000 lekë”. Pjesa takuese: 100 %.

Për këtë pasuri subjekti ka depozituar⁶⁶: faturë tatimore shitjeje nr. ***, datë 26.4.2015, nga shoqëria “***” sh.p.k., me palë blerëse M. Sh., në vlerën 600.000 lekë, me përshkrimin “VW Golf 5 Plus, me nr. shasie ***”; kontratë shitjeje datë 26.4.2015, mes palëve “***” sh.p.k. me NIPT ***, i përfaqësuar nga administrator E.J. dhe palë blerëse M.Sh. . Të dhënat e automjetit tip “VW Golf 5 Plus”, çmimi 600.000 lekë.

11.3 DPSHTRr-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 24.10.2019, informon se znj. M. N. Sh., ka të regjistruar automjetin me targa ***, duke vendosur në dispozicion të njëjtat dokumente ashtu si edhe subjekti (faturën e blerjes dhe kontratën).

11.4 Komisioni kreu analizën mbi mundësinë financiare për të investuar në këtë pasuri në datën e blerjes së automjetit 26.4.2015. Në analizë nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat nga shitja e

⁶⁴ Aneks nr. 4/9, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶⁵ Shihni Aneks nr.28.

⁶⁶ Aneks 4/10, në dosjen e ILDKPKI-së.

automjetit tip “Mercedes Benz A Class”, sipas kontratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.3.2016, në vlerën 380.000 lekë. Kjo për faktin se automjeti tip “Mercedes Benz A Class” është shitur pas një viti dhe këto të ardhura nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi i kësaj pasurie.

11.5 Nga analiza financiare Komisionit i rezultoi se dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 554.652 lekë për të investuar në blerjen e kësaj pasurie të luajtshme, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare dhe, për pasojë, i kaloi barrën e provës⁶⁷ për të dhënë argumentet e tij.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

11.6 Subjekti, ndër të tjera, në prapësimet e tij ka shpjeguar se lidhur me përlllogaritjet dhe analizat financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve të familjes së tij, që Komisioni ka bërë, i është referuar shumës së përcaktuar nga ILDKPKI-ja, ku vlera e shpenzimeve deri në datën 26.4.2015 është shënuar në masën 523.311 lekë.

Subjekti i përmbahet të njëjtit qëndrim të pasqyruar në pikën nr. 4 të këtij vendimi në lidhje me shpenzimet e jetesës, të cilat sipas tij duhen konsideruar sipas përgjigjes nr*** prot., datë 13.5.2020, ku për katër muajt e parë të vitit 2015 këto shpenzime janë në vlerën 328.640 lekë. Subjekti, gjithashtu, ka deklaruar se realisht shpenzimet e tij në muajt e parë të vitit 2015 kanë qenë më të pakta sesa zakonisht, në funksion të grumbullimit të lekëve të nevojshme për blerjen e automjetit.

Subjekti ka prezantuar rillogaritjet e tij edhe në formë tabelare, ku pasqyron pretendimet në lidhje me shpenzimet e jetesës dhe të udhëtimeve, si dhe për të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit dhe njëkohësisht bazuar në to, ka pretenduar se rezulton në pamundësi financiare në masën 59.982 lekë për të blerë automjetin tip “VW Golf Plus” në vlerën 600.000 lekë.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

11.7 Trupi gjykues, në analizë të konstatimeve të bëra në rezultatet e hetimit administrativ, dokumentacionit të administruar, prapësimeve të subjektit, si dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, me qëllim provueshmërinë e vërtetësisë dhe saktësisë së deklaramit të tij mbi mjaftueshmërinë e të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie, arsyeton si vijon:

Në lidhje me pretendimin e subjektit lidhur me përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës sipas përgjigjes së INSTAT-it, vlerësohet të mbahet i njëjti qëndrim si është arsyetuar në pikën nr. 4.

Edhe me pretendimin tjetër të subjektit lidhur me rillogaritjet e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit, sikurse pretendohet për shumën më të ulët, nga dokumentacioni i administruar, vlerësohet se këto vlera pas rillogaritjes për gjithë vitin 2015 arrijnë në shumën 346.084 lekë.

Ndërsa mbi kërkimin e subjektit për të rillogaritur në analizën financiare të blerjes së automjetit edhe shumën 300.000 lekë nga shitja e automjetit në mars të vitit 2016 në shumën 380.000 lekë, trupi gjykues ka analizuar këtë pretendim më sipër në gjendjen *cash* (pika nr. 4), duke mos e konsideruar këtë shumë sipas kërkimit të subjektit dhe, për pasojë, Njësia e Shërbimit Ligjor, nën arsyet e sipërpërmendura, ka kryer rillogaritjet sipas të cilave subjekti rezulton në balancë negative në shumën 542.263 lekë, nga shumën e konstatuar më parë në rezultatet e hetimit administrativ në shumën 554.652 lekë.

⁶⁷Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

11.7.1 Komisioni kreu gjithashtu edhe analizën financiare vjetore të vitit 2015, nga ku i rezultoi se dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 734.521 lekë për të investuar në blerjen e kësaj pasurie të luajtshme, si dhe për të përballuar gjithë shpenzimet e tjera familjare dhe, për pasojë, iu kalua barra e provës për të argumentuar⁶⁸ të kundërtën.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti ka parashtruar të njëjtat pretendime sikurse për blerjen e automjetit në prill të vitit 2015 dhe, po ashtu, ka paraqitur të njëjtin dokumentacion mbështetës.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, edhe në këtë rast, i ka qëndruar vlerësimeve të bëra mbi secilin pretendim të subjektit, të cilat janë arsyetuar gjerësisht në pikën nr. 4 dhe nr. 11 të këtij vendimi.

Në këtë kontekst, pas rilogaritjeve të kryera mbi shpenzimet, udhëtimet dhe duke mos përfshirë pretendimin për uljen e shpenzimeve të jetesës dhe ndarjen e të ardhurave të përfituara nga shitja e automjetit në mars të vitit 2016, balanca e vitit 2015 nga 734.521 lekë, rezulton në shumën 673.954 lekë. Në këtë shumë përfshihet edhe pamundësia e blerjes së automjetit në këtë vit kalendarik, pasqyruar në pikën nr. 11.7.

Në tërësi, subjekti rezulton në balancë negative në shumën 869.828 lekë, e ndarë në dy vite, përkatësisht 2015 dhe 2016, që proporcionalisht në raport me vlerësimin tërësor të pasurisë, nuk ndikon në vlerësimin tërësor në këtë vendimmarrje.

12. Trupi gjykues, në lidhje me pasurinë automjet tip “Mercedes Benz A Class” (blerë me kontratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.2.2007, me vlerë 600.000 lekë. Burim krijimi: kursime nga paga e subjektit. Pjesa takuese: 50 % dhe gjendjen *cash* rreth 200.000 lekë, në pjesë takuese 50 %), ka arsyetuar dhe ka konkluduar përkatësisht në pikën 3 të kësaj vendimmarrjeje, për të cilën nuk i kanë rezultuar problematika ligjore apo financiare.

13. Llogari me gjendje 15.000 lekë, në “Raiffeisen Bank” – pjesa takuese: 100 %

ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur se *deklarimi i subjektit rezulton me një mospërputhje të vogël në lidhje me përgjigjen e “Raiffeisen Bank”*.

Nga korrespondenca e Komisionit, e mbajtur me “Raiffeisen Bank”, kjo e fundit, me shkresën nr. *** prot., datë 18.10.2019, konfirmon llogari në emër të bashkëshortes së subjektit me gjendje në datën 30.1.2017, në shumën 16.854,04 lekë.

✓ Trupi gjykues ka vërejtur se deklarimi i bashkëshortes së subjektit rezulton me një mospërputhje të vogël me përgjigjen e “Raiffeisen Bank”, veprim ky i rezultuar pa pasoja.

Deklarimi i pasurive të prindërve të subjektit – L. dhe M. Sh.

14. Apartament me sip. 69 m², me nr. pasurie ***, me adresë: ***, p. ***, h. ***, k. ***, Shkodër. I privatizuar në vitin 1992 dhe i regjistruar më 10.10.1996, me vlerë 4.000.000 lekë (sipas rivlerësimit të vitit 2013). Burimi i krijimit: kursime familjare. Privatizuar në vitin 1992 në vlerën 12.000 lekë (shumë e përafërt për shkak se akti nuk gjendet). Pjesa takuese: 33.3 %.

14.1 Shtesë apartamenti e legalizuar me sip. 35.4 m², me nr. pasurie ***, me adresë: ***, p. ***, h. ***, k. ***, Shkodër. Kostoja e ndërtimit: 500.000 lekë. Vlera: 2.000.000 lekë sipas

⁶⁸Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

rivlerësimit të vitit 2013; ndërtuar në vitin 1998. Burimi i krijimit: kursime familjare dhe nga paga e subjektit deklarues. Pjesa takuese: 100 %.

Të dyja pasuritë e mësipërme janë pjesë përbërëse të një apartamenti me sip. totale 104.4 m², ndërtim i vitit 1964.

14.2 Njësi (depo), me sip. 5.7 m², nr. pasurie *, me vendndodhje: ***, p. ***, kati përdhes i pallatit ku ndodhet apartamenti i sipërcituar, Shkodër, i privatizuar në vitin 1992. Vlera e përfshirë brenda çmimit të privatizimit të apartamentit. Vlera: 60.000 lekë, sipas rivlerësimit të vitit 2013. Burimi i krijimit: kursime familjare. Pjesa takuese: 33.3 %.**

Trupi gjykues ka arsyetuar më sipër këto pasuri.

15. Gjendje cash në vlerën 300.000 lekë, përkatësisht 50 % secili

Subjekti i ka deklaruar të ardhurat e prindërve vetëm në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 dhe në vitin 2010 (para fillimit të detyrës). Në asnjë nga deklaratat e tjera periodike nuk ka deklaruar të ardhura, kursime apo likuiditete për prindërit.

Në deklaratën *Vetting* subjekti deklaroi për babain “të ardhura nga pensioni nga viti 1991 deri në fund të vitit 2016, në vlerën 4.800.000 lekë” dhe për nënën “të ardhura nga pensioni nga viti 1991 deri në fund të vitit 2016, në vlerën 3.300.000 lekë”.

15.1 Nga dokumentacioni i depozituar⁶⁹, për periudhën korrik 1991 – 2016, rezultoi shuma prej 4.309.168 lekësh, e ardhur në total për babain dhe për periudhën gusht 1988 – 2016, rezultoi shuma prej 3.006.429 lekësh e ardhur për nënën.

15.2 Komisioni, në gjithë analizën financiare të subjektit, i ka përfshirë të ardhurat e prindërve në ekonominë e përbashkët me të. Kjo jo vetëm për faktin që janë në të njëjtin trung familjar, por edhe sepse subjekti i ka përdorur si burim krijimi të ardhurat e tyre në disa pasuri. Për sa kohë që subjekti nuk i ka deklaruar periodikisht kursimet e prindërve të tij, Komisioni nuk i ka marrë në konsideratë në kryerjen e analizës financiare.

15.3 Për vitin 2016, subjekti ka rezultuar në pamundësi financiare për shumën 362.516 lekë (sipërtrajtuar në deklarinimin e gjendjes *cash*).

Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime, duke u përqendruar në faktin se si kanë arritur prindërit e tij të kursejnë shumën prej 300.000 lekësh.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij, shprehet se: *“Për sa i përket gjendjes cash prej 300.000 lekësh, të deklaruara nga babai im në deklaratën Vetting, sqaroj se kjo shumë, sikurse më është shpjeguar nga babai në kohën e plotësimit të deklaratës, është siguruar prej tij ndër vite nga kursimet e ndonjë pjese të pensioneve të prindërve të mi, të dhuratave modeste financiare të fëmijëve, nipërve, mbesave dhe të afërmeve të tjerë. Kjo shumë është ruajtur dhe administruar prej tij dhe nënës sime, në mënyrë konfidenciale, si një e ardhur e tyre personale, që ata e ruanin me qëllim përballimin e ndonjë sëmundjeje për shkak të moshës së tyre të thyer. Sqaroj se unë asnjëherë nuk i kam pyetur dhe nuk u kam ndërhyrë për mënyrën se si ata i kanë administruar dhe ruajtur këto vlera monetare, pasi i kam konsideruar si diçka konfidenciale të tyre”.*

⁶⁹ Vërtetim nr. *** prot., datë 27.12.2016, nga ISSh-ja, DR Shkodër; vërtetim nr. *** prot., datë 27.12.2016, nga ISSh-ja, DR Shkodër.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues në analizë të shpjegimeve të subjektit, krijon bindjen se pavarësisht balancës negative në vlerë të ulët, në shumën 195.874 lekë, e rezultuar ndaj subjektit për vitin 2016, prindërit e tij me të ardhurat nga pensioni dhe me bashkëjetesën me subjektin e rivlerësimit, ku pjesa më e madhe e shpenzimeve të jetesës është përballuar nga ky i fundit, kanë pasur mundësi të akumulojnë gjendjen cash në shumën 300.000 lekë. Kjo për faktin se, deklarimi i subjektit se, shuma është grumbulluar nga prindërit e tij, ndër vite, merret i mirëqenë, përse kohë një shumë e tillë është e mundur të krijohet tërësisht vit pas viti dhe se nuk u administrua një provë tjetër që të mund të kundërshtojë këtë fakt të deklaruar. Gjithashtu edhe për faktin se prindërit e subjektit pas vitit 1998 nuk kanë investuar në ndonjë pasuri të luajtshme apo të paluajtshme. Po ashtu u provua me dokumentacion ligjor se prindërit e subjektit kanë qenë të punësuar e për pasojë kanë gëzuar të ardhura nga pensioni i pleqërisë.

- ✓ Në të tilla kushte, trupi gjykues nuk konstaton problematika në lidhje me gjendjen *cash* të deklaruar nga prindërit e subjektit.

B. KONTROLI I FIGURËS

1. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikojë nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja⁷⁰, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, raportin për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Genti Shala, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 31.7.2019, të KDZH-së, ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.

2. Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 30.1.2020, ka kërkuar përditësimin e raportit të sipërpërmendur së bashku me deklasifikimin mbi përditësimin e kryer.

3. DSIK-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 2.7.2020, ka dërguar raportin e përditësuar, të deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. *** prot., datë 2.7.2020, të KDZH-së për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit.

Sipas këtij raporti rezulton se:

Nga informacionet e autoriteteve verifikuese në kohështrirje gjatë periudhës së rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Genti Shala, disponohen të dhëna, ku sinjalizohet mbi përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës dhe ndërveprim korruptiv. Pavarësisht këtij konstatimi, ky institucion⁷¹ më tej shprehet se:

Bazuar te të dhënat e përcjella nga autoritetet verifikuese, nuk ndodhemi para ndonjë rrethane apo fakti të qenësishëm që të mund të ngrejë dyshime të arsyeshme për përfshirjen në veprimtari të kundërligjshme të subjektit të rivlerësimit, z. Genti L. Shala. Referuar parashikimeve të bëra në Aneksin “Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve”, neni “DH”, “Kontrolli i figurës”, pika 2, që përcakton si periudhë të vlerësimit për kontrollin e figurës datën 01.01.2012, nisur nga

⁷⁰ Në përgjigje të shkresës nr. *** prot., datë 16.7.2019, të Komisionit.

⁷¹ Referojuni raportit të DSIK-së, deklasifikuar me vendimin e KDZH-së nr. *** prot, datë 02.07.2020

të dhënat e sipërcituara, veprimtaria e dyshuar për veprime korruptive e abuzive me detyrën për subjektin e rivlerësimit i përket një periudhe para këtij afati.

Ky institucion, në përfundim të raportit, është shprehur se: *“Në konfirmim të konstatimit fillestar për përshtatshmërinë në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit Genti L. Shala, gjykojmë që për rastin në fjalë, konkluzioni mbetet në vlerësimin e Komisionit, nën dritën e informacioneve të tjera që mund të dispononi si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ, që po kryhen ndaj subjektit të rivlerësimit”.*

Hetimi i kryer nga Komisioni

Komisioni ka kryer hetim të thelluar lidhur me informacionin e pasqyruar në raportin e DSIK-së.

Informacionet e klasifikuara

Anëtarët e trupit gjykues gjithashtu verifikuan dhe studiuuan së bashku me vëzhguesin ndërkombëtar informacionet e klasifikuara.

Komisioni, mbi kërkesat e tij drejtuar organeve të gjyqësorit, ka administruar disa dosje gjyqësore, trajtuar në referim të kriterit profesional.

Për sa më sipër referuar, subjektit i është kërkuar të japë sqarime mbi raportin e dërguar nga DSIK-ja, për kontrollin e figurës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti, në parashtrimet e tij mbi rezultatet e kriterit të kontrollit të figurës, i është referuar konkluzioneve të arritura nga Komisioni për rastet ku sinjalizohet mbi përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës dhe ndërveprim korruptiv. Subjekti ka deklaruar në parashtrime se asnjëherë nuk ka pasur kontakt me persona të kriminit të organizuar se është treguar korrekt gjatë veprimtarisë së punës së tij gjatë gjithë viteve të karrierës në funksionin e gjyqtarit dhe se ka ushtruar këtë detyrë me përgjegjshmëri.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, nën *indiciet* e raportit të DSIK-së, vlerësoi kryerjen e një hetimi të thelluar mbi provueshmërinë e informacioneve të dhëna, duke analizuar të gjitha çështjet gjyqësore në kontekstin profesional, me qëllim arritjen në konkluzion mbi vlerësimin e saktë dhe objektiv të kriterit të figurës.

Analizimi i çështjeve gjyqësore

Komisioni, mbi kërkesat e tij drejtuar organeve të gjyqësorit, ka administruar⁷² dosjet gjyqësore të trajtuara në vijim:

1. Dosja gjyqësore që i përket të pandehurit A. T., akuzuar për veprën penale “shfrytëzim prostitucioni/trafikim i femrave për prostitucion dhe trafikim narkotikësh” bazuar në nenet 102,114/a, 5-22 të Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. ***, datë 18.9.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

⁷² Me shkresën nr. *** prot., datë 30.6.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, dosjen gjyqësore në ngarkim të të pandehurve A. T.dhe D. B. .

1.1 Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin e sipërpërmendur, ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurve A. T. dhe D.B. për veprën penale të parashikuar nga neni 102 i Kodit Penal dhe dënimin e tyre me 5 vjet burgim.

Rrethanat e çështjes

Në tërësi, në këtë çështje gjyqësore, u vërejt se gjykata ishte vënë në lëvizje nga Prokuroria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila kishte dërguar për gjykim të pandehurit A.T. dhe D. B., të akuzuar për kryerjen e veprave penale “shfrytëzim prostitucioni me dhunë dhe në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 114/a i Kodit Penal dhe “marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura”, parashikuar nga neni 102 i Kodit Penal. Kallëzimi ishte kryer nga dy shtetas (motra me njëra-tjetrën), të cilat kanë denoncuar se janë mashtruar nga të pandehurit me qëllim dërgimin jashtë shtetit për prostitucion. Në vendimmarrje arsyetohet mbi ndryshim të deklarimeve të këtyre shtetasve nga ato të dhëna në organin e prokurorisë me shpjegimet e bëra në seancë gjyqësore. Gjykata, në vendimmarrjen e saj i është referuar: (i) deklarimeve të dy shtetasve në organin e prokurorisë përpara oficerit të policisë gjyqësore, pra, në kohën kur është bërë kallëzimi, duke e quajtur të pabesueshëm deklarinimin e kallëzueseve në seancë gjyqësore se të pandehurit i kishin të afërm në lidhje gjaku, duke marrë në konsideratë; (ii) deklarinimet e OPGj-së para gjykatës; si dhe (iii) deklarinimet e vëllait (i cili është dënuar me gjykim të shkurtuar, duke pranuar gjendjen në të cilën ndodheshin provat, si dhe duke pohuar kallëzimin e motrave të tij) të të dëmtuarave përpara OPGj-së, i cili ka pranuar se ka qëlluar me armë në oborrin e shtëpisë së tij, pasi ka parë të pandehurin A. T. .

Gjykata, në vendimmarrje, ka arsyetuar se është provuar kryerja e veprës penale të shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 115/a, 25 të Kodit Penal.

Për sa i përket akuzës së kryerjes së marrëdhënieve seksuale me dhunë me të rritura, gjykata ka vlerësuar se çështja duhet të pushohet, pasi të dëmtuarat kanë hequr dorë nga ankimi i bërë.

Në këtë çështje penale organi i prokurorisë ka kërkuar në diskutimet përfundimtare në bashkim të dënimeve, dënimin e të pandehurve me 5 vjet burgim.

Gjykata e Apelit Shkodër, mbi ankimin e ushtruar nga të pandehurit A.T. dhe D. B. për të ndryshuar vendimin pasi nuk kanë qenë dakord dhe apelin kundërshtues të organit të prokurorisë për të lënë në fuqi vendimin gjyqësor të shkallës së parë, e përbërë nga trupa gjyqësore në përbërje të së cilës ka qenë në cilësinë e kryesuesit subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 21.12.2005, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor dhe pushimin e çështjes në ngarkim të këtyre të pandehurve.

Gjykata e Apelit, në arsyetimin e saj, ka cituar se:

- thëniet e dëshmitarëve gjatë hetimit paraprak nuk përbëjnë provë për faktet që pohohen në to;
- besueshmëria e dëshmitarëve sipas arsyetimit të gjykatës përcaktohet duke konsideruar thëniet e tyre në raport me të dhënat që kanë dalë edhe nga shtetasit e tjerë të pyetur, përkatësisht A. Gj. (OPGj) dhe Y. Z., i cili ka shoqëruar dy shtetaset në Tiranë, si dhe duke konsideruar edhe praktikën e pajisjes me pasaportë të të dëmtuarës F. S.;
- ka një boshllëk mes veprimeve të të pandehurve dhe qëllimit final që të pandehurit kishin sipas akuzës;

- vepra penale, për të cilën është ngritur akuza, kryhet jashtë territorit të Shqipërisë dhe të pandehurit i lidh me territorin e një vendi tjetër vetëm fakti se të dëmtuarën e ka shoqëruar i pandehuri në komisariatit e policisë për t'u pajisur me pasaportë;
- veprimet e të pandehurve janë ndërprerë me largimin e të dëmtuarave ende pa shkuar në territorin e një vendi tjetër, pra, pa filluar vepra penale për të cilën akuzoheshin;
- në rastin më të keq, të pandehurit ishin në fazën e përgatitjes dhe nuk mbajnë përgjegjësinë penale për veprimet e kryera.

1.2 Ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit ka ushtruar rekurs organi i prokurorisë. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 495, datë 25.5.2007, ka vendosur “mospranimin e rekursit me arsyetimin se ky i fundit nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432⁷³ të Kodit të Procedurës Penale”.

1.3 Sikurse vërehet, procesi gjyqësor ka ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit dhe vendimi i Gjykatës së Apelit, ku subjekti i rivlerësimit është pjesë përbërëse e trupit gjykues është lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë.

1.4 Trupi gjykues, në analizë të fakteve dhe provave të administruara për këtë çështje gjyqësore, duke mbajtur në vëmendje ecurinë e procesit gjyqësor, ezaurimin e ushtrimit të ankimit si një e drejtë thelbësore në procesin gjyqësor, vendimmarrjen e shkallëve më të larta të organit gjyqësor, nuk konstatoi ndonjë problematikë që të mund të ndikojë në raport me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit dhe, për pasojë, as edhe me objektin e vlerësimit të kontrollit të figurës⁷⁴.

2. Vendimet e Gjykatës së Apelit⁷⁵ Shkodër nr. ***⁷⁶, datë 18.4.2006 (për miratimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër “arrest me burg”); nr. ***⁷⁷, datë 17.11.2006 (për ndryshimin e vendimit të shkallës së parë nga *arrest me burg* në *arrest në shtëpi* dhe lirim të pandehurit); nr. ***⁷⁸ (me të cilin është vendosur *lënia në fuqi e vendimit të shkallës së parë Shkodër*, ku ishte vendosur deklarimi i pafajshëm i të pandehurit akuzuar për veprën penale *shpërdorim detyre*), datë 19.2.2008 dhe nr. ***⁷⁹, datë 1.7.2009, të cilat i përkasin specifikisht dosjeve gjyqësore në ngarkim të të pandehurit D. K., dyshuar për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga nenin 248 i Kodit Penal.

2.1 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me shkresën nr. ***, datë 6.7.2020, ka vënë në dispozicion disa dosje gjyqësore të shkallës së parë në ngarkim të shtetasve të sipërpërmendur, dy prej të cilëve i përkasin vendimeve të Gjykatës së Apelit Shkodër, përkatësisht vendimit nr. ***, datë 18.7.2006 dhe nr. ***, datë 19.2.2008.

2.2 Në të dy vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykatës së Apelit Shkodër nuk identifikohet si pjesë përbërëse e trupit gjykues subjekti i rivlerësimit.

⁷³ Neni 432/Rekursi kundër vendimeve të Gjykatës së Apelit (ndryshuar me ligjet nr. 8813, datë 13.6.2002 dhe nr. 35/2017, datë 30.3.2017) 1. Rekursi në Gjykatën e Lartë kundër vendimeve të Gjykatës së Apelit mund të bëhet për këto shkaqe: (a) për mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material ose procedural, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; (b) për mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; (c) kur vendimi i ankimit vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

⁷⁴ Për shkak të informacionit të dhënë nga DSIK-ja në raportin e saj.

⁷⁵ Dërguar në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 30.6.2020.

⁷⁶ Me objekt/vleftësim ndalimi dhe caktim masë sigurimi.

⁷⁷ Me objekt zëvendësimi i masës së sigurimit nga arrest në burg me arrest në shtëpi.

⁷⁸ Vendimi i gjykimit të themelit të çështjes.

⁷⁹ Vendim për mospranimin e ankimit të bërë nga i pandehuri D. K. ndaj vendimit penal nr. ***, datë 27.3.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, pasi i pandehuri K. ka hequr dorë nga ankimi i bërë duke depozituar në Apel deklaratën përkatëse.

2.3 Po ashtu, edhe sa i përket dy vendimeve të tjera të Apelit Shkodër, megjithëse nga verifikimi i vendimeve nuk identifikohet subjekti i rivlerësimit si pjesë përbërëse e trupave gjyqësore, rezulton se çështjet janë lënë në fuqi, si në çështjen e masës së sigurimit arrest me burg dhe në atë të themelit, ndërsa në çështjen e zëvendësimit të masës së arrestit, vendimmarrja e shkallës së parë ka qenë më e rëndë krahasuar me zëvendësimin e saj në apel, me arrest shtëpie, ndërsa në rastin e gjykimit që i përket vitit 2009, subjekti i rivlerësimit nuk ka ushtruar detyrën e gjyqtarit, por të anëtarit të KQZ-së.

2.4 Për sa më sipër, nuk reflektohen çështje të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit dhe, për pasojë, nuk marrin vlerë në këtë vendimmarrje.

3. Dosja që i përket vendimit nr. ***, datë 7.1.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, me të pandehur G. M., akuzuar për veprën penale “mbajtje pa leje të armëve luftarake” dhe “kanosje”, parashikuar nga nenet 278/4 e 84 të Kodit Penal.

3.1 Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me vendimin nr. ***, datë 7.1.2015, ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit G. M. për veprën penale të sipërcituar dhe dënimin e tij në aplikim edhe të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale me 5 vite burgim.

3.2 Gjykata e Apelit, me kryesues subjektin e rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 3.4.2015, ka vendosur *lënien në fuqi të vendimit të sipërpërmendur, duke aplikuar edhe nenin 59 të Kodit Penal dhe urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të vendimit për pjesën e pavuajtur të dënimit me burgim me afat prove për 18 muaj, duke mbajtur kontakte me Shërbimin e Provës.*

3.3 Gjykata e Apelit është vënë në lëvizje nga ushtrimi i ankimit të të pandehurit, i cili ka kërkuar prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes ose në mënyrë alternative ndryshimin e vendimit, duke e pezulluar dënimin për një afat prove.

3.4 Për këtë çështje, në Apelin kundërshtues, organi i prokurorisë ka cilësuar faktin se i pandehuri paraqet rrezikshmëri të lartë dhe se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe nuk duhet aplikuar neni 59 i Kodit Penal, i cili parashikon rrezikshmërinë e pakët të autorit dhe të rrethanave.

3.5 Ndër të tjera, Gjykata e Apelit ka çmuar në alternativën e dënimit faktin se i pandehuri: (i) nuk ka qenë i dënuar më parë; (ii) ka pësuar një frakturë për shkak të së cilës i është nënshtruar një ndërhyrjeje kirurgjikale dhe duhet t'i nënshtrohet procesit të fizioterapisë dhe një trajtimi të specializuar, rrethana që së bashku me përfshirjen rastësore të të pandehurit për herë të parë në një aktivitet kriminal, zbusin rrezikshmërinë shoqërore të veprës dhe atë të autorit dhe, për pasojë, ka arsyetuar gjykata, ka vend për të aplikuar pezullimin e vendimit të dënimit me burgim.

Vendimi i Apelit është rekursuar nga organi i prokurorisë.

3.6 Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 6.10.2016, ka vendosur *mospranimin e rekursit, pasi nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i Kodit të Procedurës Penale.*

3.7 Ndër të tjera, në mendimin ligjor të Gjykatës së Lartë thuhet: “... në materialet e gjykimeve rezultojnë të jenë respektuar parimet bazë të gjykimit penal dhe nuk konstatohen shkelje që kanë të bëjnë me pavlefshmëri të procesit penal apo të akteve të rrjedhura prej tij dhe se aktualisht i pandehuri e ka përfunduar kohën e provës.”

3.8 Sikurse vërehet, procesi gjyqësor ka ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit dhe vendimi i Gjykatës së Apelit, ku subjekti i rivlerësimit është pjesë përbërëse e trupit gjykues është lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë.

3.9 Në kushte të tilla, për sa kohë çështja e gjykuar nga subjekti i rivlerësimit është shqyrtuar edhe nga organi më i lartë gjyqësor, i cili gjithashtu ka arsyetuar se *janë respektuar parimet bazë të gjykimit penal dhe nuk janë konstatuar shkelje që kanë të bëjnë me pavlefshmëri të procesit penal.*

3.10 Trupi gjykues vëren se konstatimet e mësipërme për secilën çështje gjyqësore të trajtuar, pasqyrojnë ligjshmërinë e vendimeve të marra, nuk konstatohet ndonjë mangësi e natyrës procedurale që mund të ndikojë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit dhe për pasojë as edhe në kontrollin e figurës, sikurse do të arsyetohet më tej.

3.11 Komisioni, pas hetimeve të kryera dhe analizimit të dosjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, ka konstatuar se raporti i DSIK-së, për subjektin e rivlerësimit, nuk gjendej i mbështetur në të dhëna të sakta, të cilat dukej se nuk përkonin si me të dhënat e viteve lidhur me çështjen që referohej ashtu edhe me referimin në përmbajtje të raportit se *“Bazuar në parashikimet e bëra në Aneksin “Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve”, neni “DH”, “kontrolli i figurës”, pika 2 që përcakton si periudhë të vlerësimit për kontrollin e figurës datën 01.01.2012, nisur nga të dhënat e sipërcituara, veprimtaria e dyshuar për veprime korruptive e abuzive me detyrën për subjektin e rivlerësimit i përket një periudhe para këtij afati ».* Në këtë drejtim, trupi gjykues çmon se ky referim është i gabuar, pasi nuk është i bazuar në rregullimet ligjore për këtë kriter, neni “DH” i Aneksit të Kushtetutës dhe parashikimet ligjore të Kreut V, të ligjit nr .84/2016. Lidhur me këtë çështje, trupi gjykues vlerëson se neni DH i Aneksit të Kushtetutës, në pikën 2 përcakton se subjektet e rivlerësimit plotësojnë dhe i dorëzojnë Komisionit një deklaratë të detajuar për figurën e tyre që mbulon periudhën nga data 1 janar 2012 deri në ditën e deklaramit, sipas ligjit. Deklarata mund të përdoret si provë vetëm në këtë proces dhe në asnjë rast gjatë një procesi penal. Ndërsa ligji nr. 84/2016, në nenin 34 të tij parashikon se kontrolli i figurës bëhet sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Ky i fundit, periudhën *“nga data 1 janar 2012 e deri në ditën e deklaramit”* e lidh vetëm me plotësimin e deklaratës së figurës prej subjektit të rivlerësimit. Ligji nr. 84/2016, i cili detajon procedurën e kontrollit të figurës, të kryer nga DSIK-ja dhe Komisioni, në asnjë rast nuk e kufizon kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit vetëm për periudhën nga 1 janari 2012 e deri në ditën e deklaramit të subjektit. Bazuar në pikat 4 dhe 6 të nenin 38, të ligjit nr. 84/2016, kontrolli për figurën bazohet në dy komponentë komplementarë me njëri-tjetrin, në elementin përmbajtësor të këtij kontrolli, i cili është konstatimi i ekzistencës së kontaktit të papërshtatshëm, si dhe në elementin formal që është konstatimi i plotësisë dhe besueshmërisë së deklaramit. Mjaftueshmëria dhe vërtetësia e deklaramit kontrollohen për periudhën e deklaramit në Kushtetutë, ndërsa për sa i përket aspektit përmbajtësor të kontrollit të figurës, afati i tij mund të shtrihet edhe përpara datës 1 janar 2012.

Nën këtë arsyetim ligjor, trupi gjykues në konsideratë të fakteve se a) subjekti ka plotësuar me vërtetësi deklaratën e figurës, pasi në asnjë rrethanë nuk janë konstatuar elemente në kuptim të kriterëve që kërkon neni 38 lidhur me konstatime për ekzistencën e ndonjë kontakti të papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, sipas standardeve që kërkon kontrolli i këtij kriteri, b) nga hetimi i Komisionit, dyshimet e ngritura sipas pikës 8, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, mbi verifikimin e të dhënave për sinjalizime mbi përfshirjen e subjektit në

veprimtari të kundërligjshme shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës dhe ndërveprim korruptiv, nuk u provuan,

-arrin në konkluzionin se nuk ka rrethana që të ngarkohet me përgjegjësi subjekti dhe për rrjedhojë të aplikohet ndonjë masë penalizuese ndaj tij, brenda përcaktimeve ligjore të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues arrin në këtë konkluzion edhe për sa kohë nga hetimi i tij, nuk evidentoi ndonjë indicje, apo fakt tjetër që mund të mbështeste indicjet/dyshimet dhe si rrjedhojë e këtij vlerësimi, arrin në përfundimin se, subjekti i rivlerësimit z. Genti Shala ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti⁸⁰ është përgatitur nga Inspektorati i Këshillit të Lartë Gjyqësor si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ky raport i ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: formularit të vetëdeklarimit, të tri⁸¹ dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; pesë dosje⁸² gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së dhe po ashtu edhe analiza⁸³ e gjetjeve është bazuar në këto tri komponentë, duke rezultuar ndër të tjera, si vijon:

⁸⁰ Nr. *** prot., datë 5.11.2019, i KLGj-së.

⁸¹ Dokumenti nr. 1 – vendimi penal nr. ***, datë 4.12.2013, i Gjykatës së Apelit Tiranë, që i përket kërkuese prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i pandehur A. K., akuzuar për kryerjen e veprës penale “vrasje nga pakujdesia”; Dokumenti nr. 2 – vendimi penal nr. ***, datë 13.10.2015, i Gjykatës Apelit Tiranë, që i përket kërkuese prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kundër të pandehurit E. Xh., akuzuar për kryerjen e veprës penale “marrëdhënie homoseksuale me të mitur”; dokumenti nr. 3 – vendimi penal nr. ***, datë 7.12.2015, i Gjykatës së Apelit Tiranë, që i përket kërkuetit R. I., me objekt kundërshtim i vendimit të pushimit të procedimit penal.

⁸² Dosja *** – çështja penale nr. *** regjistri, datë 15.5.2015 regjistrimi, që i përket kërkuese prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, i pandehur A.M., akuzuar për “vjedhje të energjisë elektrike” e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 25.3.2016; dosja *** – çështja penale nr. *** regjistri, datë 16.9.2013 regjistrimi, që i përket kërkuese prokuroria e Rrethit Gjyqësor Dibër, i pandehur I. O., akuzuar për “dhunë në familje” e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 7.2.2014; dosja *** – çështja penale nr.***regjistri, datë 15.5.2015 regjistrimi, që i përket kërkuetit Prokuroria Rrethit Gjyqësor Tiranë, të pandehurit M. B.dhe E.M., akuzuar për kryerjen e veprës penale “vjedhje”, e kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë, e përfunduar me vendimin nr.***, datë 2.3.2016; dosja***– çështja penale nr. *** regjistri, datë 3.9.2013 regjistrimi, që i përket kërkuetit Prokuroria Rrethit Gjyqësor Tiranë, i pandehur N.L., akuzuar për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 20.12.2013; dosja *** – çështja penale nr. *** regjistri, datë 3.12.2014 regjistrimi, që i përket kërkuetit Prokuroria Rrethit Gjyqësor Tiranë, të pandehurit E. M., me objekt shuarje të masës së sigurimit personal,e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 3.12.2014.

⁸³ Konstatimet janë më të reduktuara krahasimisht me ato të pasqyruara në raportin e KLGj-së. Për më shumë detaje referojuni këtij të fundit.

- Në lidhje me njohuritë ligjore si një kriter matës i rëndësishëm i aftësisë profesionale, subjekti i rivlerësimit ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Natyra e çështjeve që subjekti ka shqyrtuar ka qenë e ndryshme dhe përfshin njohuri të së drejtës procedurale penale për veprën penale të vrasjes nga pakujdesia, njohuri për të drejtën procedurale penale për veprën penale “marrëdhënie homoseksuale me të mitur”, njohuri të së drejtës procedurale penale për veprën penale “vjedhje”, për veprën penale “dhunë në familje”, për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, si dhe për shuarjen e masës së sigurimit personal. Kur është rasti, në funksion të zbatimit të ligjit, subjekti përdor referenca nga Këshilli i Evropës, rekomandimi nr. R (99) 22, i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare në lidhje me mbipopullimin e burgjeve, sipas të cilit, burgimi duhet të zbatohet si masë vetëm “kur çdo masë apo sanksion tjetër do të ishin të papërshtatshme për rëndësinë e veprës (shihni dosjen ***), ku është aplikuar neni 59 i Kodit Penal.

- Në lidhje me arsyetimin ligjor, subjekti i rivlerësimit, z. Genti Shala, ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij, janë të qarta dhe të kuptueshme. Ai respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor karakteret e gjuhës shqipe në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme, e mirëorganizuar dhe e standardizuar. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Në dispozitivin e vendimit, në të gjitha rastet e vëzhguara është konstatuar se nuk tregohet e drejta e ankimit për palët. Dispozitivi hartohet me tekst të qartë dhe të plotë, duke treguar sipas rastit të gjitha disponimet që shoqërojnë vendimin e fajësisë apo deri te ndryshimet e vendimeve të shkallës së parë.

- Lidhur me etikën në punë, angazhimin ndaj vlerave profesionale, integritetin dhe paanësinë, raporti nuk ka evidentuar problematika.

- Gjithashtu, raporti ka parashtruar dhe vlerësuar edhe mbi kriterin matës të aftësive personale dhe angazhimin profesional, duke moskonstatuar problematika.

- Sa i përket të dhënave nga burimet arkivore, raporti ka prezantuar të dhënat e dosjes personale të subjektit. Në to referohet se gjyqtari Genti Shala ka marrë titullin “jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 29.6.1994 dhe pas studimeve, në datën 29.7.1998, është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, më pas është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Apelit Shkodër në datën 11.6.2004. Më tej është liruar nga detyra e gjyqtarit pasi është zgjedhur anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe në vijim është dekretuar nga Presidenti i Republikës në Gjykatën e Apelit Tiranë me datë 19.5.2010, ku kryen funksionin e gjyqtarit edhe aktualisht. Nuk evidentohen mospërputhje me të dhënat e deklaruara nga subjekti në formularin e vetëdeklarimit.

- Lidhur me ankesat e paraqitura në adresë të subjektit, raporti është shprehur se sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Genti Shala janë paraqitur 5 ankesa (2 në vitin 2014 dhe 3 në vitin 2015) në Inspektoratin e KLD-së 4 ankesa (2 të vitit 2014 dhe 2 të vitit 2015) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar ndër të cilat 1 me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor, 1 me arsyetimin se është jashtë kompetencave të KLD-së dhe 2 me arsyetimin se janë ankesa të përsëritura më parë.

- Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Genti Shala përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Në lidhje me tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit të llojit vendim gjyqësor, të cilat i përkasin periudhës 2013 – 2016 (2 vendime penale themeli dhe 1 vendim penal administrativ) ka rezultuar, si vijon:

Dokumenti nr***– vendimi penal nr. ***, datë 4.12.2013, i Gjykatës së Apelit Tiranë, që i përket kërkuese Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i pandehur A. K., akuzuar për kryerjen e veprës penale “vrasje nga pakujdesia”.

Subjekti i vlerësimit është relator në këtë çështje. Seanca është zhvilluar në datën 4.12.2013 dhe vendimi është shpallur po në këtë datë. Në përfundim, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur *lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 22.6.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë* me këtë ndryshim *mosaplikimin e nenit 59 të Kodit Penal dhe revokimin e urdhrin për pezullimin e ekzekutimit të vendimit për pjesën e pavuajtur të dënimit për të pandehurin A. K. .* Në vendim paraqitet në mënyrë të plotë disponimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për deklarimin fajtor të të pandehurit dhe në bazë të nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale, pezullimin e ekzekutimit të dënimit për pjesën e pavuajtur prej 10 muaj e 7 ditë me kusht që gjatë kësaj periudhe kohe i pandehuri të mos kryejë një vepër tjetër penale. Vendimi paraqitet me strukturë të qartë, ku analiza është strukturuar me paragrafe të ndara sipas argumenteve të përdorura. Përgjithësisht janë respektuar rregullat e drejtshkrimit dhe janë përdorur të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë janë të thjeshta.

Dokumenti nr. ***– vendimi penal nr. ***, datë 13.10.2015, i Gjykatës së Apelit Tiranë, që i përket kërkuese prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kundër të pandehurit E. Xh., akuzuar për kryerjen e veprës penale “marrëdhënie homoseksuale me të mitur”.

Subjekti i vlerësimit është relator në këtë çështje. Seanca është zhvilluar në datën 26.10.2016 dhe vendimi është shpallur po në këtë datë. Çështja është regjistruar në datën 13.10.2015 dhe ka përfunduar në datën 26.10.2016, pra pas 1 viti e 13 ditëve, jashtë afatit standard 9 muaj të gjyqimit të përcaktuar nga germa “g”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit. Në përfundim, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur *lënien në të vendimit nr. 2929, datë 8.9.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

Dokumenti nr. *** – vendimi penal nr. ***, datë 7.12.2015, i Gjykatës së Apelit Tiranë, që i përket kërkuese R.I., me objekt kundërshtim i vendimit të pushimit të procedimit penal.

Subjekti i vlerësimit, z. Genti Shala, është relator në këtë çështje. Seanca është zhvilluar në datën 7.12.2015 dhe vendimi është shpallur po në këtë datë.

Në përfundim, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur *lënien në të vendimit nr. ***, datë 18.9.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

Përshkrimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short

Dosja ***⁸⁴ – çështja penale nr. *** regjistri, datë 15.5.2015 regjistrimi, që i përket, kërkuese Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, i pandehur A.M., akuzuar për “vjedhje të energjisë elektrike” e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 25.3.2016.

⁸⁴ Ky vendim nuk është ankimuar.

Çështja është regjistruar në gjykatë më 15.5.2015 dhe me shortin e datës 20.05.2015, i është caktuar gjyqtarit Genti Shala. Sipas aktit fletëthirrje të ndodhur në dosje, drejtuar palëve në proces, rezultoi se në datën 15.2.2016, gjyqtari vuri në lëvizje çështjen dhe planifikoi seancën e parë në datën 4.3.2016, ora 11:20. Çështja gjyqësore është zhvilluar në tri seanca gjyqësore. Gjykata në përfundim të gjykimit ka vendosur *lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 21.4.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*. Dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar janë depozituar në sekretari në datën 10.4.2015 – pas 5 ditëve nga shpallja, brenda afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykimi i çështjes ka zgjatur gjithsej 10 muaj, në intervalin kohor 20.05.2016-25.03.2016 nga data e shortit. Kjo kohëzgjatje është jashtë afatit standard 6-mujor të përcaktuar nga germa “g”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit, është caktuar dhe janë zhvilluar tri seanca gjyqësore, prej të cilave 2 joproduktive dhe 1 produktive, ku janë kryer veprimet procedurale për zgjidhjen e çështjes dhe në përfundim të seancës është disponuar me vendim që ka përfunduar shqyrtimin e çështjes.

Dosja^{85***} – çështja penale nr. *** regjistri, datë 16.9.2013 regjistrimi, që i përket kërkuesit Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Dibër, i pandehur I.O., akuzuar “dhunë në familje”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 7.2.2014.

Çështja është regjistruar në gjykatë më 16.9.2013 dhe me shortin e datës 16.9.2013, ajo i është caktuar gjyqtarit Genti Shala. Sipas aktit fletëthirrje të ndodhur në dosje, drejtuar palëve në proces, rezultoi se në datën 19.12.2013, gjyqtari vuri në lëvizje çështjen dhe planifikoi seancën e parë në datën 24.1.2014, ora 12:20. Çështja është zhvilluar në dy seanca gjyqësore në përfundim të të cilave është vendosur *lënia në fuqi e vendimit nr. ***, datë 22.7.2013, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër*. Dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar janë depozituar në sekretari në datën 13.2.2014 – pas 5 ditëve nga shpallja, brenda afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Dosja⁸⁶ *** – çështja penale nr. ***regjistri, datë 15.5.2015 regjistrimi, që i përket kërkuesit Prokuroria Rrethit Gjyqësor Tiranë, të pandehurit M. B. dhe E. M., akuzuar për kryerjen e veprës penale “vjedhje”, e kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 2.3.2016.

Çështja është regjistruar në gjykatë më 15.5.2015 dhe me shortin e datës 20.5.2015 i është caktuar gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, Genti Shala. Sipas aktit fletëthirrje të ndodhur në dosje drejtuar avokatit E.D. dhe palëve ndërgjyqëse, rezultoi se në datën 15.2.2016, gjyqtari vuri në lëvizje çështjen dhe planifikoi seancën e parë në datën 2.3.2016, ora 11:00. Çështja është zhvilluar në një seancë gjyqësore në përfundim të së cilës është vendosur *lënia në fuqi të vendimit nr. ***, datë 22.4.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*. Dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar janë depozituar në sekretari në datën 15.3.2016 – pas 12 ditëve nga shpallja, jashtë afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale. Gjykimi i çështjes ka zgjatur gjithsej 9 muaj e 12 ditë, në intervalin kohor 20.5.2015 – 2.3.2016 nga data e shortit. Kjo kohëzgjatje është jashtë afatit standard 6-mujor të përcaktuar nga germa “g”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit⁸⁷.

⁸⁵ Ky vendim nuk është ankimuar.

⁸⁶ Ky vendim nuk është ankimuar.

⁸⁷ Sistemi i Vlerësimit përmbledh vendimin nr. ***, datë 14.4.2010, të ish-KLD-së “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”, së bashku me Aneksin I “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

Dosja *** – çështja penale nr. ***regjistri, datë 3.9.2013 regjistrimi, që i përket kërkuesit Prokuroria Rrethit Gjyqësor Tiranë, i pandehur N. L., akuzuar për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 20.12.2013.

Çështja është regjistruar në gjykatë më 3.9.2013. Me shortin e datës 4.9.2013, ajo i është caktuar gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, Genti Shala. Sipas aktit fletëthirrje të ndodhur në dosje drejtuar avokates dhe palëve ndërgjyqëse, rezultoi se në datën 14.11.2013, gjyqtari vuri në lëvizje çështjen dhe planifikoi seancën e parë në datën 6.12.2013, ora 12:20. Çështja është gjykuar në dy seanca gjyqësore në përfundim të të cilave është vendosur *lënie në fuqi e vendimit nr. ***, datë 28.6.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

Dosja *** – çështja penale nr. *** regjistri, datë 3.12.2014 regjistrimi, që i përket kërkuesit Prokuroria Rrethit Gjyqësor Tiranë, të pandehurit E. M., me objekt shuarje të masës së sigurimit personal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 3.12.2014.

Çështja është regjistruar në gjykatë më 3.12.2014 dhe i është caktuar gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, Genti Shala. Seanca e parë gjyqësore është caktuar më 3.12.2014, ora 12:10. Çështja gjyqësore është zhvilluar në një seancë të vetme, në të cilën është vendosur deklarimi i shuarjes së masës së sigurimit personal “arrest në burg”, për kërkuesin me vendim nr. ***, datë 4.9.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe urdhërimi i lirimit të menjëhershëm të kërkuesit nga dhomat e paraburgimit, nëse nuk mbahet për ndonjë vepër tjetër penale. Vendimmarrja është bazuar në nenin 261/1/c të Kodit të Procedurës Penale, ku ndër të tjera thuhet se masa e sigurimit shuhet, përveç të tjerave, kur kohëzgjatja e paraburgimit të vuajtur është më e madhe se masa e dënimit të caktuar. Rezulton se në rastin në gjykim, kohëzgjatja e paraburgimit për kërkuesin E. M. është më e madhe se masa e dënimit caktuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, për këtë shkak, masa e sigurimit ndaj kërkuesit është shuar.

C/1. Rivlerësimi profesional

Komisioni, pasi u njoh dhe analizoi të gjithë dokumentacionin e depozituar nga KLGj-ja mbi të cilin edhe është hartuar raporti i vlerësimit profesional për këtë subjekt, ka konstatuar si vijon:

1. Në dokumentin nr. ***, vendimi penal nr. ***, datë 13.10.2015 është dhënë pas 1 viti e 13 ditë, jashtë afatit standard 9 muaj të gjykimit të përcaktuar nga germa “g”, e pikës 5 të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.
2. Në pesë dosjet e shortuara, dosja gjyqësore e renditur me nr. 3⁸⁸, së bashku me vendimin e arsyetuar është depozituar në sekretari pas 12 ditëve nga shpallja, jashtë afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale dhe gjykimi i çështjes ka zgjatur gjithsej 9 muaj e 12 ditë, në intervalin kohor 20.5.2015 - 2.3.2016 nga data e shortit. Kjo kohëzgjatje është jashtë afatit standard 6-mujor të përcaktuar nga germa “g”, pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit⁸⁹.
3. Sa i përket aftësisë për të administruar dosjet, ka rezultuar se në pesë dosjet e verifikuara mangësitë janë të njëjta: nuk ka akt formal të gjyqtarit relator për kalimin e çështjeve në seancë

⁸⁸ Çështja penale nr. *** regjistri, datë 15.5.2015 regjistrimi, që i përket kërkuesit Prokuroria Rrethit Gjyqësor Tiranë, të pandehurit M. B. dhe E. M., akuzuar për kryerjen e veprës penale “vjedhje”, e kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 2.3.2016.

⁸⁹ Sistemi i Vlerësimit përmbledh vendimin nr. ***, datë 14.4.2010, të ish-KLD-së “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”, së bashku me Aneksin e “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

gjqësore, nuk ka relacion me shkrim nga relatori i çështjes, në fashikull nuk përfshihet kopje e listës së shpalljes së seancave gjyqësore për të dokumentuar datën e njoftimit.

Mbi këto konstatime, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti, në parashtrimet e tij, ka shpjeguar se deri përpara datës 21.2.2018, që nga mbërritja e dosjes në Gjykatën e Apelit Tiranë, shortimi i çështjes dhe caktimi i seancës së parë, përbënte një proces i cili menaxhohej nga kryesia dhe sekretaria e Gjykatës së Apelit Tiranë.

Pas Urdhrit të Brendshëm nr. *** prot., datë 21.2.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë, është urdhëruar që nga data 1.4.2018 çështjet penale që do të dalin për gjykim do të listohen në stendat e gjykatës nga relatori i çështjes.

Në praktikën e Gjykatës së Apelit Tiranë shpallja e datave të çështjeve në gjykim bëhet në stendën e gjykatës.

Për çështjet penale, njoftimi i palëve ndërgjyqëse bëhet me fletëthirrje dhe në format e parashikuara në mënyrë shteruese nga Kodi i Procedurës Penale. Akti i njoftimit, përveç të tjerave, përmban edhe datën e njoftimit.

Subjekti ka depozituar Urdhrin e Brendshëm nr. *** prot., datë 21.2.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizë të: (i) shpjegimeve të subjektit; (ii) aktit urdhërues, i cili ka normuar mënyrën e menaxhimit të çështjeve⁹⁰ nga relatorët e tyre dhe jo më nga kryesia dhe sekretaria e gjykatës; (iii) faktit se çështjet gjyqësore rezultojnë të paankimuar, çka nënkupton gjykim të drejtë, respektim të të drejtave të palëve ose viktimave dhe ligjshmëri të vendimmarrjeve; (iv) vlerësimit pozitiv që i është bërë nga raporti, por edhe nga rivlerësimi, kriterit matës të aftësive profesionale, por dhe kriterëve të tjera, çmon se:

- ✓ Subjekti, në tërësi, ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme, duke u vlerësuar kështu pozitivisht për veprimtarinë etike dhe profesionale në përmbushje të kërkesave të ligjeve nr. 84/2016 dhe nr. 96/2016.

Në lidhje me 14 denoncimet e paraqitura në Komision për subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar, si vijon:

Në Komision janë depozituar 14 denoncime, prej të cilëve ka rezultuar se dy prej denoncuesve kanë depozituar nga 2 denoncime (siç identifikohet dhe analizohet më poshtë) për të njëjtën çështje dhe subjekt rivlerësimi, me të njëjtin objekt ankimi.

1. Denoncim⁹¹ i shtetas D. G.

Denoncuesja ankohet ndaj vendimit gjyqësor nr***, datë 5.11.2014, të trupit gjykues ku subjekti i rivlerësimit është me cilësinë e njërit prej anëtarëve, duke pretenduar se në vendimmarrjen e dhënë nuk është ushtruar kontrolli i duhur i ligjshmërisë së veprimeve hetimore të kryera nga

⁹⁰ Pas kohës në të cilën janë shqyrtuar çështjet gjyqësore mbi të cilat është vlerësuar subjekti në raportin përkatës.

⁹¹ Nr. *** prot., datë 26.12.2017.

prokurori në procedimin penal nr. ***, pushuar më 30.1.2014. Denoncuesja ka depozituar vendimet gjyqësore si dhe procedimin penal.

Nga aktet rezulton se organi i prokurorisë dhe ai gjyqësor janë vënë në lëvizje nga shtetasi B. Z. dhe se nuk konfirmohet se cili ka qenë tagri i denoncueses në këtë çështje. Sipas dokumentacionit të administruar rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 3.4.2014, ka rrëzuar kërkesën e kallëzuesit B. Z. për prishje të vendimit të pushimit të procedimit penal, sipas të cilit akuzohej stafi mjekësor për mjekim të pakujdesshëm ndaj vëllait të tij, me pasojë vdekjen. Gjykata e Apelit, me vendimin nr. ***, datë 5.12.2014, ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë. Denoncuesja pretendon se kjo vendimmarrje nuk është e drejtë pasi organi i akuzës nuk ka kryer hetimet e duhura dhe se ai duhet ti vijojë ato. Denoncuesja nuk ka qartësuar nëse ka rekursuar vendimin gjyqësor. Komisioni vlerëson se nuk ka kompetencë të shprehet mbi vendimet e dhëna nga gjykatat, të cilat vlerësohen nga një gjykatë më e lartë, nëpërmjet mjetit ligjor të ankimit.

2. Denoncim⁹² i shtetasit V.Ç.

Komisioni, pasi administroi këtë denoncim, vëren se denoncuesi ankohet për trupin gjykues, ku sipas tij bën pjesë edhe subjekti i rivlerësimit, duke sqaruar se gjatë gjykimit është vendosur në disfavorin e tij. Ai denoncon faktin se në shqyrtim nuk janë administruar provat e ndodhura në një tjetër dosje gjyqësore, të cilat qartësonin pronësinë e tij të blerë nga shteti me procedura të rregullta. Denoncuesi, në mbështetje të ankimit, nuk ka depozituar dokumentacion dhe as të dhëna referuese lidhur me vendimet e gjykatës së apelit dhe, për rrjedhojë, ky denoncim duket se nuk është i qartë dhe bëhet i pamundur për t'u trajtuar nga Komisioni.

3. Denoncim⁹³ i shtetasit F.K.

3.1 Denoncuesi, në ankimin e tij, pretendon për shkelje të rëndë të etikës profesionale nga subjekti i rivlerësimit e kryer me dashje, me qëllim përfitimi, duke dhënë një vendim të padrejtë, pa marrë në konsideratë provat dhe faktet e ndodhura në fashikullin gjyqësor. Denoncuesi, në ankim, i referohet vendimit nr. ***, datë 21.9.2011, të subjektit të rivlerësimit. Ai ka depozituar vendimin gjyqësor të sipërcituar.

Sipas vendimit gjyqësor, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë në cilësinë e kryesuesit të procesit gjyqësor me të pandehur shtetasin B. K., i akuzuar nga denoncuesi (vëllai i tij) për veprën penale “shpërdorim të kompetencave” për të cilën gjykata e rrethit gjyqësor kishte vendosur deklarin e tij të pafajshëm dhe, po ashtu, vendimi i gjykatës së apelit e ka lënë atë në fuqi, duke e fokusuar kryesisht arsyetimin të referimi i ligjit të posaçëm për shoqëritë tregtare, ndërsa organi i prokurorisë kishte kërkuar deklarin fajtor dhe dënimin e të pandehurit me shumën 1.000.000 lekë. Denoncuesi nuk ka qartësuar nëse ka rekursuar vendimin gjyqësor.

3.2 Subjektit i është kërkuar të japë shpjegime për të qartësuar pretendimet e denoncuesit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

3.3 Subjekti, në parashtrimet e tij, ka shpjeguar se Kolegji Penal që ka shqyrtuar çështjen penale në ngarkim të të pandehurit B. K., akuzuar se ka kryer veprën penale “shpërdorim i kompetencave”, parashikuar nga neni 164 i Kodit Penal, ka çmuar se ligji material penal ka sanksionuar si të dënueshme shkeljen e kompetencave për qëllime përfitimi. Duke mospërcaktuar

⁹² Nr. *** prot., datë 13.12.2017.

⁹³ Nr. *** prot., datë 18.1.2018.

kompetencat në mënyrë shteruese, ligjvënësi ka shprehur vullnetin e tij për të analizuar këto kompetenca, duke referuar ligjin e posaçëm që i përcakton ato.

3.4 Nga shqyrtimi gjyqësor nuk na ka rezultuar ndonjë kompetencë, e shkelur me qëllime përfitimi nga i pandehuri B. K. në kuptim të nenit 154 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

3.5 Organi i prokurorisë e ka rekursuar vendimin objekt denoncimi dhe mbi këtë bazë Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 10.1.2013, ka vendosur *mospranimin e rekursit të paraqitur nga prokurori i Prokurorisë së Apelit Tiranë kundër vendimit nr. ***, datë 21.9.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë.*

3.6 Subjekti, në mbështetje të shpjegimeve të tij, ka bashkëngjitur vendimin nr. ***, datë 10.1.2013, të Gjykatës së Lartë.

3.7 Trupi gjykues, duke vlerësuar shpjegimet e subjektit në dritën e pretendimeve të denoncuesit, ka konstatuar se mbi ligjshmërinë e vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit, denoncuesi ka ushtruar të drejtën e ankimit dhe se për këtë çështje është shprehur një gjykatë më e lartë. Në këto kushte konkludohet se subjekti ka qartësuar pozitën e tij në lidhje me vendimmarrjen dhe ligjshmërinë e saj të provuar nga Gjykata e Lartë. Nën këtë argument nuk evidentohen problematika që ndikojnë në vlerësimin profesional të tij.

4. Denoncim⁹⁴ i shtetases D. Xh.

4.1 Denoncuesja, pasi parashtron në tërësi ankimin e saj për moskryerje të hetimeve të plota nga organi i prokurorisë lidhur me aksidentin automobilistik të ndodhur me pasojë vdekjen e bashkëshortit të saj, rendit disa subjekte rivlerësimi që i etiketon si shkelës të ligjit në vendimmarrjet e tyre, të korruptuar dhe të paafte profesionalisht. Ndër ta, denoncuesja ankohet edhe ndaj subjektit të rivlerësimit, objekt i këtij hetimi administrativ.

Denoncuesja ka depozituar akte të organit të akuzës, vendime gjyqësore, ankime të ushtruara prej saj, si dhe një CD.

Komisionit, nga aktet e depozituara, i rezultoi se procedimi penal nr. *** në ngarkim të shtetasit Y.A., akuzuar për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, është pushuar.

Ndaj këtij vendimi bashkëshortja e viktimës, denoncuesja, si palë e dëmtuar i është drejtuar gjyqësorit me ankim.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.***, datë 9.9.2016, ka vendosur shfuqizimin e vendimit “Pushim të procedimit penal” si dhe vazhdimin e hetimeve, duke lënë edhe detyra përkatëse për organin e akuzës dhe ndër detyrat e lëna ka cituar: (i) “... se hetimet duhet të vazhdojnë duke i lënë organit të prokurorisë si detyrë, gjetjen e pamjeve filmike, për të verifikuar nëse ka pasur ose jo kamera të subjekteve private në vendngjarje dhe nëse ka pasur është me vlerë përcaktuese këqyrja dhe marrja e tyre për përcaktimin se cili mjet ka kaluar kur semafori ishte me ngjyrë të kuqe; dhe (ii) në pamundësi të sqarimit të kësaj rrethane, organi i prokurorisë duhet të argumentojë shkaqet pse ky fakt nuk mund të provohet. Detyra të lëna, për vetë faktin (thuhet në arsyetimin e vendimit gjyqësor) se organi i prokurorisë e ka përcaktuar si fakt të domosdoshëm sqarimin e gjendjes së semaforit në momentin e hyrjes së mjeteve në kryqëzimin ku ka ndodhur aksidenti.

⁹⁴ Nr. *** prot., datë 30.4.2018.

4.2 Ndaj këtij vendimi është ankuar organi i akuzës dhe Gjykata e Apelit (me shumicë votash), ku subjekti i rivlerësimit është në cilësinë e njerit prej dy anëtarëve të shumicës, të trupit gjykues, me vendimin nr***, datë 10.7.2017, ka vendosur prishjen e vendimit të shkallës së parë dhe pushimin e çështjes, ku ndër të tjerë argumentohet se *hetimet nga organi i prokurorisë janë kryer të plota për sa kohë nga akt ekspertimet ka rezultuar se ka pasur shkelje të rregullave të qarkullimit nga drejtuesi i mjetit (viktima) dhe se kërkimi i pamjeve filmike nga subjektet private në zonë për një aksident të ndodhur shumë kohë më parë, nuk do të influenconte në përfundimin e arritur nga prokuroria, por do të zvarritte çështjen, etj.*

4.3 Për sa më sipër, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime në lidhje me pretendimet e denoncuesit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

4.4 Subjekti, në parashtrimet e tij, ka shpjeguar se: “... gjatë hetimit të çështjes ka rezultuar që organi i Prokurorisë ka kryer dy akt ekspertime auto-teknik, të cilët kanë përcaktuar si shkakun determinant teknik në ndodhjen e aksidentit shkeljet nga ana e drejtuesit të mjetit rrugor dyrratak që drejtohej nga viktima. Ndërsa një akt ekspertim tjetër auto-teknik, i kryer gjithashtu gjatë hetimit ka konkluduar se shkakun determinant teknik i aksidentit nuk mund të përcaktohet. Sa më sipër, ka rezultuar në mënyrë të sinkronizuar se veprimet e personit në hetim nuk kanë qenë shkakun determinant i aksidentit. Lidhur me veprimet hetimore të përcaktuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, referuar praktikës, kam çmuar se pamjet filmike të regjistruara nga kamerat e subjekteve private nuk mund të gjenden pasi ka kaluar një periudhë rreth 21 muaj (nga data e aksidentit 18.10.2015, deri në gjykimin në apel datë 10.7.2017). Gjithashtu është vlerësuar se kalimi me semaforin e duhur apo atë të gabuar, përbën një element, i cili duhet t’i jetë nënshtruar ekspertimit auto-teknik në aktet e administruara gjatë hetimit. Në bindjen time veprimet hetimore të përcaktuara në shkallë të parë, përveçse ishin të pamundura, nuk mund ta ndryshonin përfundimin e konsoliduar se veprimet e personit nën hetim nuk kanë përbërë shkakun determinant të aksidentit. Mungesa e kësaj rrethane e përjashton personin nën hetim nga përgjegjësia penale. Përfundimisht i kam konsideruar shteruese veprimet e kryera gjatë hetimit dhe të pamundura veprimet hetimore të përcaktuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të kohës së gjatë të kaluar që nga ndodhja e aksidentit. Përveç bindjes sime të brendshme profesionale, deklaroj se nuk ka ndikuar asnjë rrethanë tjetër e jashtme në vendimmarrjen objekt denoncimi”.

4.5 Trupi gjykues, në trajtimin e kësaj çështjeje gjyqësore, në konsideratë të legjislacionit të fushës sa i përket përpunimit të drejtë e të ligjshëm të mbrojtjes së të dhënave personale që në këtë rast përkon me të dhënat që kanë mbajtur dhe administruar kamerat ose ndryshe sistemet e video-survejmimit, kohës së ruajtjes⁹⁵ së të dhënave, si dhe pa synuar që të zëvendësojë apo çënojë logjikën e arsytimit të subjektit në këto parashtrime dhe as në vendimarrje lidhur me këtë çështje, çmon se:

4.6 Nisur nga faktet se çështja e trajtuar gjyqësisht ka qenë delikate dhe se me gjithë hetimin dhe kërkimin e organit të prokurorisë, gjykata e shkallës së parë ka ndarë mendim ndryshe për të vijuar edhe me dy veprime të tjera hetimore, si dhe për faktin që në vendim shumica ka argumentuar se: “... hetimet nga organi i prokurorisë janë kryer të plota për sa kohë nga aktet e ekspertimit ka rezultuar se ka pasur shkelje të rregullave të qarkullimit nga drejtuesi i mjetit (viktima) dhe se kërkimi i pamjeve filmike nga subjektet private në zonë për një aksident të ndodhur shumë kohë

⁹⁵ Referuar ligjit nr.9887/2008, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr.3, datë 05.03.2010, i ndryshuar, të Komisionierit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave personale.

më parë, nuk do të influenconte në përfundimin e arritur nga prokuroria, por do të zvarritte çështjen, etj...”, trupi gjykues çmon se ky arsyetim, në koherencë me detyrat e lëna nga shkalla e parë e gjyqësorit, duket se nuk përkon me aktet e administruara në dosje, të cilat vlerësohen se do t’i shërbenin zbardhjes së kësaj çështjeje.

Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se ka rrethana që edhe në proporcionalitet me pretendimet e denoncueses, organi i specializuar, brenda kompetencave që i njeh dhe jep ligji, të konkludojë nëse ka shkaqe për verifikime të mëtejshme.

5. Denoncim⁹⁶ i shtetasit F. dhe Sh. A.

5.1 Denoncuesit ankohen ndaj vendimit nr***, datë 17.2.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili ka lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 3.4.2015. Në tërësi, ata kanë prezantuar faktin se nga mjekimi i pakujdesshëm i dy mjekëve në ndërhyrjen kirurgjikale të bërë ndaj djalit të tyre, ky i fundit ka humbur jetën. Denoncuesit i janë drejtuar organit të akuzës dhe, më tej, çështja gjyqësore ka vijuar gjykimin në gjykatën e rrethit gjyqësor dhe në gjykatën e apelit, nën akuzën e mjekimit të pakujdesshëm në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 96/1 dhe 25 i Kodit Penal. Denoncuesit kanë depozituar vendimet gjyqësore, vendimet e organit të akuzës, si dhe akte të tjera.

5.2 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi konkluzionet e prokurorit të çështjes, i cili ka kërkuar deklarinimin fajtor të dy mjekëve dhe dënimin e tyre me nga 3 vjet burgim secili, ka vendosur deklarinimin fajtor të shtetasit K. K. dhe dënimin e tij me gjobë në shumën 600.000 lekë, si dhe deklarinimin e pafajshëm të të pandehurit tjetër, G. F. . Gjykata e Apelit, mbi ankimin e prokurorit, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë, duke marrë parasysh, ndër të tjera, rrezikshmërinë e veprës penale, shkallën e fajit të autorit të saj, si dhe rrethana lehtësuese dhe rënduese lidhur me masën e dënimit të pandehurit të deklaruar fajtor.

5.3 Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime duke u përqendruar kryesisht te kërkimet e organit të akuzës në ankimin e parashtruar.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

5.4 Subjekti, në parashtrimet e tij, ka shpjeguar se: “... akuzat e ngritura ndaj mjekëve irlandezë, kishte një rrethanë të cilën Kolegji Penal i kryesuar nga unë, e çmoi si një kontradiktë që e karakterizonte vetë akuzën. Organi i Prokurorisë i kishte akuzuar të dy mjekët irlandezë se ata kishin kryer, në bashkëpunim veprën penale ‘mjekim i pakujdesshëm’. Unë jam i bindur se personi që akuzohet se ka kryer një veprë penale, që për nga ana subjektive kryhet nga pakujdesia apo vetëbesimi i tepruar, nuk mund të akuzohet se këtë veprë e ka kryer në bashkëpunim. Mungesa e dashjes është element i mjaftueshëm që të rrëzojë pretendimin e organit të akuzës se vepra është kryer në bashkëpunim në kuptim të nenit 25 të Kodit Penal.

Mungesa e ‘bashkëpunimit’ i vë të pandehurit në kushtet e kryerjes së veprës në mënyrë individuale. Nga rrethanat e çështjes na rezultoi se në veprimet apo mosveprimet e njërit prej mjekëve irlandezë, nga njëra anë dhe pasojës tragjike nga ana tjetër nuk rezultonte lidhja shkak-pasojë dhe në këto kushte Kolegji Penal çmoi se fakti objekt akuzë nuk përbën veprë penale. Ndërsa për mjekun e deklaruar fajtor, Kolegji Penal e caktoi llojin e dënimit duke konsideruar, përveç rrethanës së sipërcituar, faktin se ai ishte një mjek i huaj që kishte ardhur vullnetarisht në vendin tonë, i organizuar në kuadër të një iniciative humanitare, si dhe pasi çmoi të ulë shkallën e tij të fajit, në kuptim të lidhjes së mosveprimit të tij dhe pasojës së ardhur. Përfundimisht çmuam

⁹⁶ Nr. *** prot., datë 25.4.2018.

se Organi i Prokurorisë kishte një qasje në kundërshtim me ligjin penal, e cila e kishte vënë edhe në pozitat e kërkimit të një dënimi më të rëndë sesa kushtëzonin rrethanat e çështjes. Subjekti, gjithashtu, ka parashtruar se është përpjekur maksimalisht për të gjykuar me objektivitet, sipas bindjes së tij të brendshme, pa u ndikuar nga asnjë rrethanë e jashtme, e çfarëdo natyre qoftë”.

5.5 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, vlerëson pozicionin e mbajtur prej tij, se, në gjykimin profesional përveç shpjegimit ligjor të bërë lidhur me vendimarrjen, ka arsyetuar edhe bazuar në bindjen e brendshme. Ligjshmëria e vendimmarrjes, kryesisht ezaurohet nëpërmjet mjetit ligjor, ushtrimit të së drejtës ankimore, në gjykatat e shkallëve më të larta. Në këtë kuptim, nuk konstatohen problematika që ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit.

6. Denoncim⁹⁷ i shtetasit F.Y.

6.1 Komisioni, pasi administroi këtë denoncim, vëren se denoncuesi ankohet për zvarritje të procesit gjyqësor në Gjykatën e Apelit Tiranë. Denoncuesi ka sqaruar se përpara Gjykatës së Apelit po shqyrtohet çështja penale me të pandehur shtetasit me iniciale K dhe A. Ç., akuzuar për veprën penale të mashtrimit më shumë se një herë dhe me pasoja të rënda, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal. Ai bën me dije se çështja fillimisht i ka takuar dy gjyqtarëve të tjerë, të cilët kanë dhënë dorëheqje dhe, më tej, ka mësuar se do të gjykohej nga subjekti i rivlerësimit. Denoncuesi informon se prej datës 3.10.2018 (dhe deri në depozitim të denoncimit) nuk është zhvilluar asnjë seancë gjyqësore. Në tërësi ankohet se nga zvarritja e procesit gjyqësor i shkaktohen pasoja të pariparueshme pasi të pandehurit vijnë tjetërsimin e pronave, duke u bërë kështu i pamundur ekzekutimi në favor të tij, i huas së marrë në një shumë tepër të konsiderueshme.

6.2 Për sa më sipër, subjektit i është kërkuar të paraqesë shpjegime lidhur me statusin aktual të çështjes objekt gjykimi, si dhe të depozitojë dokumentacion mbështetës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

6.3 Subjekti, në parashtrimet e tij, ka sqaruar se në datën 1.11.2018 është miratuar kërkesa e tij për dorëheqje nga gjykimi i çështjes penale nr. *** Akti, që i përket të pandehurve K. dhe A.Ç., akuzuar se kanë kryer veprën penale parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal. Subjekti ka qartësuar se trupi gjykues i kryesuar prej tij, ka administruar në datën 29.10.2018 një memo të drejtuar nga denoncuesi F.Y.dhe në këto kushte ka deklaruar (së bashku me gjyqtarin Sh.M.), për shkak të objektivitetit në gjykim, dorëheqjen nga gjykimi i kësaj çështjeje. Siç rezulton nga procesverbali i seancës gjyqësore datë 17.10.2018, në këtë datë është zhvilluar seanca e caktuar në datën 3.10.2018. Në këtë seancë shqyrtimi gjyqësor nuk mund të vazhdonte për shkak se nuk ishin paraqitur anëtarët e tjerë të trupit gjykues, si dhe përfaqësuesi i Organit të Prokurorisë. Në seancën e datës 17.10.2018 është caktuar që seanca e radhës të zhvillohet në datën 29.10.2018 kur unë kam deklaruar dorëheqjen. Gjykimi i kësaj çështjeje në apel ka zgjatur për një kohë relativisht të gjatë, por për shkaqe objektive. Gjykata e Apelit Tiranë e ka riçelur shqyrtimin gjyqësor dhe ka administruar aktekspertime, të cilat i ka çmuar të rëndësishme për shqyrtimin e kësaj çështjeje. Gjithashtu, gjatë gjyimit të kësaj çështjeje kanë rezultuar rrethana objektive që kanë kushtëzuar pamundësinë e anëtarëve të trupit gjykues për gjykimin e saj. Subjekti ka depozituar procesverbalin e seancës datë 17.10.2018, kërkesën për heqje dorë nga gjykimi i çështjes penale datë 29.10.2018 dhe vendimin nr*** prot., datë 1.11.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Subjekti ka parashtruar se nuk ka pasur asnjëherë qëllim zvarritjen e gjyimit të çështjeve dhe se është

⁹⁷ Nr. *** prot., datë 29.10.2018.

përpjekur maksimalisht për të gjykuar me objektivitet, sipas bindjes së tij të brendshme, pa u ndikuar nga asnjë rrethanë e jashtme, e çfarëdo natyre qoftë.

6.4 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar, e gjen të drejtë arsyetimin e tij se ka kërkuar dorëheqjen e argumentuar, për sa kohë kjo është një e drejtë legjitime e tij. Po ashtu, trupi gjykues e gjen me vend edhe sqarimin tjetër të subjektit se mosprezenca e plotë e trupit gjykues në datën 17.10.2018, ka bërë që njohja me këtë dorëheqje të adresohet në seancën gjyqësore të radhës. Në këto kushte, i gjithë kontestimi i denoncuesit për zvarritje të procesit në këtë gjykim i përket harkut kohor për më shumë se tri javë, çka lë të nënkuptohet se veprimet e subjektit kanë qenë të argumentuara dhe nuk kanë synuar zvarritje të procesit, por që padyshim kanë marrë kohën e tyre për t'u ligjësuar. Në këtë kontekst nuk konstatohen problematika që mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit.

7. Denoncim⁹⁸ i shtetasve T . M.dhe E.M.

Denoncuesit (vëllezër mes tyre) ankohen se ndaj tyre është dhënë vendim i padrejtë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbini, ku janë dënuar përkatësisht me 29 dhe 22 vjet burgim. Gjithashtu, ata kanë të njëjtin pretendim edhe për Gjykatën e Apelit, e cila ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë. Denoncuesit, në mbështetje të ankimit, nuk kanë depozituar dokumentacion dhe as të dhëna referuese lidhur me vendimet e Gjykatës së Apelit, si dhe nuk sqarojnë mbi ushtrimin e rekursit ndaj vendimit gjyqësor. Për rrjedhojë, ky denoncim jo vetëm duket se nuk është i qartë, por Komisioni vlerëson se nuk ka kompetencë të shprehet mbi vendimet e dhëna nga gjykatat, të cilat vlerësohen nga një gjykatë më e lartë, nëpërmjet mjetit ligjor të ankimit.

8. Denoncim⁹⁹ i shtetasit E. H.

8.1 Denoncuesi ankohet ndaj dy vendimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e kryesuesit të trupës gjyqësore, përkatësisht ndaj vendimeve nr*** dhe nr. ***, ku njëri i përket themelit të çështjes dhe tjetri interpretimit të tij. Denoncuesi pretendon se me pa të drejtë nuk është thirrur nga gjykata si palë ndërgjyqëse, duke u cenuar në pronësinë e tij pas ligjërimit të vendimmarrjes nga gjykata. Ai ka depozituar dy vendimet gjyqësore dhe një ankesë drejtuar trupit gjykues të kryesuar nga subjekti i rivlerësimit. Denoncuesi pretendon se interpretimi i vendimit të themelit ka shkaktuar mbivendosje pronësie, pasi në të njëjtën kohë të njëjtat palë përfshirë edhe denoncuesin ishin në proces civil për të njëjtën pronë me të njëjtin objekt gjykimi “privatizim oborri në përdorim”. Nga arsyetimi i vendimit nr. *** vërehet se vendimi i themelit nuk është ankimuar.

8.2 Për sa më sipër, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime lidhur me pretendimet e denoncuesit, duke u përqendruar kryesisht te vendimi i interpretimit të themelit dhe fakti nëse ndaj tij është ushtruar ankim, si dhe duke i lënë në vlerësime edhe depozitimin e dokumentacionit mbështetës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

8.3 Subjekti, në parashtrimet e tij, ka shpjeguar se: “... vendimi nr. *** është marrë pasi trupi gjykues e kryesuar prej meje e ka zhvilluar procesin me të njëjtën ndërgjyqësi, me të cilën çështja është gjykuar në shkallë të parë. Nuk na ka rezultuar asnjë rrethanë që të çonte në thirrjen e shtetasit E.H. si palë ndërgjyqëse në këtë proces. Vendimi nr. *** nuk është rekursuar në Gjykatën

⁹⁸ Nr. *** prot., datë 26.11.2018.

⁹⁹ Nr. *** prot., datë 4.2.2019, nr. *** prot., datë 9.2.2019.

*e Lartë, por kjo e fundit në vendimin nr. ***, të vitit 2014, ka rrëzuar kërkesën e drejtorisë nr. 3 të Punëtorëve të Qytetit Studenti për rishikimin e vendimit të sipërcituar. Në themel të këtij kërkimi, Gjykata e Lartë ka konstatuar pretendimin e shtetasve E.H. dhe K. R. se këta 'janë bashkëpronarë të banesës që shfrytëzon oborrin objekt të mosmarrëveshjes dhe, në këto kushte, e drejta e privatizimit të këtij oborri nuk i takon vetëm B. K., por edhe subjekteve të tjera'. Lidhur me këtë pretendim Gjykata e Lartë ka administruar aktin mbështetës të pretendimeve të shtetasit E.H., e cila është paraqitur si provë e re. Në të njëjtin vendim Gjykata e Lartë ka çmuar se 'provat e reja të paraqitura nga kërkuesit edhe pse nuk i janë nënshtruar hetimit dhe debatit gjyqësor të mëparshëm, nuk mund të konsiderohen esenciale për çështjen objekt gjykimi dhe nuk mund ta ndryshojnë fatin e saj. Në analizë të provës së re ..., faktet e reja që pretendohen nuk mbështesin pretendimet e kërkuesit të ngritura në gjykimin e mëparshëm dhe shkakun ligjor të tyre'. Vendimi i sipërcituar i Gjykatës së Lartë, në mënyrë indirekte ka konsideruar ndërgjyqësinë e çështjes objekt denoncimi, si të rregullt, në përputhje me ligjin procedural civil dhe ka konstatuar se nuk janë cenuar në mënyrë të kundërligjshme interesat e shtetasit E. H.*

*Vendimi i interpretimit të vendimit në thelb nuk ka ndryshuar asnjë element të vendimit, përveçse ka përcaktuar pjesë të tij skicën e sipërfaqes, që do të privatizohet sipas dispozitivit të vendimit të themelit. Vendimi i interpretimit është bërë pjesë integrale e vendimit të themelit, dhe në momentin e rishikimit në Gjykatën e Lartë është përfshirë edhe ai në përfundimet e kësaj gjykate". Subjekti ka depozituar vendimin nr. ***, të vitit 2014, të Gjykatës së Lartë.*

8.4 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti dhe vendimit gjyqësor të depozituar, konstaton se subjekti ka qartësuar ligjërish ecurinë e procesit gjyqësor. Subjekti ka qartësuar se ndaj vendimit të themelit është ushtruar kërkesa për rishikim¹⁰⁰ vendimi. Është e natyrshme që nëse çështja është trajtuar gjyqësisht nëpërmjet rishikimit, vënia në lëvizje e gjykatës është bërë vetëm për shkaqe, rrethana dhe prova të reja të padisponuara dhe, për rrjedhojë, të padepozituara nga palët ndërgjyqëse përgjatë gjithë procesit gjyqësor. Në vijim të këtij parashikimi ligjor dhe faktit se nga gjykata nuk është pranuar as edhe rishikimi i vendimit, megjithëse në të pretendohet të jenë depozituar prova të reja pikërisht nga denoncuesi dhe, po ashtu, gjykata ka pasur të administruar edhe vendimin e interpretimit të themelit, atëherë ligjërish dhe logjikisht pretendimet e denoncuesit i janë nënshtruar procesit gjyqësor në të gjitha shkallët e gjykimin dhe problematikat e pretenduara nuk mund t'i adresohen tashmë subjektit të rivlerësimit. Vendimmarrja mbi rishikimin e vendimit, për sa kohë nuk është pranuar, drejtpërdrejtë pasqyron edhe pranueshmërinë e ndërgjyqësisë si të drejtë prej nisjes së procesit në shkallë të parë e në vijim, çka nënkupton se nuk qëndron edhe pretendimi tjetër i denoncuesit për mospërfshirje në cilësinë e palës ndërgjyqëse në proces. Pra, ezaurimi shterues i rrugës gjyqësore flet qartë edhe për vendimmarrjen e subjektit dhe pretendimet e denoncuesit. Po ashtu, subjekti ka qartësuar edhe në lidhje me interpretimin që i është bërë vendimit të themelit të çështjes, për t'i bashkëngjitur pasurisë objekt gjykimi, skicën planimetrike, pra, aktin që në mënyrë integrale do të duhej të bënte të mundur ekzekutimin e plotë të tij. Në kushte të tilla, trupi gjykues nuk konstaton problematika që ndikojnë në vlerësimin e kriterit profesional ndaj subjektit të rivlerësimit.

¹⁰⁰ Neni 494 i Kodit të Procedurës Civile parashikon institutin e rishikimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në të, ndër të tjera thuhet "Kërkesa për rishikim është akti me të cilin kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë, kur: a) zbulohen rrethana të reja apo prova të reja me shpresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të dihehin nga pala gjatë shqyrtimit të saj....".

9. Denoncim¹⁰¹ i shtetasit L. D.

Denoncuesi, në parashtrimet e tij ankohet për njëanshmëri të treguar nga trupi gjykues në vendimin e dhënë, ku bën pjesë edhe subjekti i rivlerësimit si një ndër anëtarët e saj. Ndër të tjera, ai parashtron se kjo gjykatë ka ndryshuar me pa të drejtë vendimin e shkallës së parë Bulqizë, sipas të cilit ishte vendosur prishja e vendimit të mosfillimit të procedimit penal nga organi i prokurorisë lidhur me kallëzimin e bërë për falsifikim të një kontrate privatizimi dhe kryerjen e hetimeve të tjera. Denoncuesi ka depozituar vendimin e vitit 2003, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Bulqizë, për *mosfillimin e procedimit penal* të inciuar nga shtetasi Sh. D., vendimin nr. ***, datë 19.6.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, si dhe vendimin nr. ***, datë 12.9.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Sipas vendimit të Gjykatës së Apelit vërehet se ndryshimi i vendimit është fokusuar në moslegjitimitetin e denoncuesit në ankimin e tij ndaj vendimit të organit të prokurorisë. Nën këtë argument, gjykata ka cituar se nuk është ndalur në pretendimet e organit të prokurorisë apo të ankuesit, për kryerjen e hetimeve të tjera të procedimit penal. Denoncuesi nuk ka qartësuar nëse ka rekursuar vendimin gjyqësor. Komisioni vlerëson se nuk ka kompetencë të shprehet mbi vendimet e dhëna nga gjykatat, të cilat vlerësohen nga një gjykatë më e lartë, nëpërmjet mjetit ligjor të ankimit.

10. Denoncim¹⁰² i shtetasit S. M.

Denoncuesi ankohet ndaj vendimit nr. ***, të dhënë nga Gjykata e Apelit, ku subjekti i rivlerësimit ka pasur cilësinë e kryesuesit. Denoncuesi ankohet se me pa të drejtë është prishur vendimi i shkallës së parë, dhënë në favor të tij. Ai sqaron se në procesin civil ka qenë në cilësinë e palës së paditur, me paditëse shtetasen T. S. (mbesa e tij), me të cilën ka pasur një kontratë huaje dhe për shkak të mospagimit të huas ka qenë në procese të vazhdueshme gjyqësore, përmbarrimore, si dhe në organin e prokurorisë. Ankuesi ka depozituar vendimin gjyqësor të lëshimit të urdhrit të ekzekutimit të vitit 1998, vendimin gjyqësor të Gjykatës së Apelit Tiranë, vendimin e pushimit të procedimit penal nr. ***, si dhe ankesa të nënshkruara prej tij. Sipas vendimit të Gjykatës së Apelit, në çështjen gjyqësore me objekt “kundërshtim i veprimeve përmbarrimore, pavlefshmëri e titullit ekzekutiv etj.”, është vendosur lënia në fuqi e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor nr. *** sa i përket vijimit të veprimeve përmbarrimore, ndërsa është ndryshuar pjesa e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv, duke u deklaruar e pavlefshme vetëm pjesa sa i përket detyrimit për interesat kontraktore. Denoncuesi nuk sqaron nëse ka ushtruar ankim ndaj vendimit gjyqësor. Komisioni vlerëson se nuk ka kompetencë të shprehet mbi vendimet e dhëna nga gjykatat, të cilat vlerësohen nga një gjykatë më e lartë, nëpërmjet mjetit ligjor të ankimit. Në tërësi, në analizë të akteve, trupit gjykues nuk i kanë rezultuar problematika lidhur me gjykimin e kësaj çështje.

11. Denoncim¹⁰³ i shtetasës E. C.

11.1 Denoncuesja ankohet për zvarritje në gjykimin e saj në Gjykatën e Apelit, ndaj një vendimi të shkallës së parë të cilin e ka ankimuar. Ajo sqaron se pas dy njoftimeve të bëra nga gjykata dhe moszhvillimit të seancave gjyqësore ka mësuar se gjyqtari i çështjes, subjekti i rivlerësimit ka hequr dorë prej gjykimit dhe se ende është në padijeni të ecurisë së procesit gjyqësor. Denoncuesja pretendon se gjyqtari dorëheqjen mund ta kishte dhënë prej fillimit të procesit për të mos pasur zvarritje të procesit.

¹⁰¹ Nr. ***, datë 21.3.2019.

¹⁰² Nr. *** prot., datë 13.8.2019 dhe nr. ***prot., datë 21.8.2019.

¹⁰³ Nr. ***prot., datë 23.10.2019.

11.2 Për sa më sipër, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime lidhur me pretendimet e denoncuesit, duke u përqendruar te dorëheqja e dhënë lidhur me gjykimin e kësaj çështjeje, si dhe të depozitohet dokumentacion mbështetës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

11.3 Subjekti i rivlerësimit shprehet se: *“Në çështjen e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 6.6.2018, kam qenë në përbërje të trupit gjykues, që ka gjykuar kërkesën e kërkuases E. C. me objekt kundërshtimin e vendimit datë 27.9.2016, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë ‘për mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin penal nr. ***, të vitit 2016’.*

*Këtë rrethanë e kam konsideruar si pengesë ligjore për gjykimin e kërkesës së kërkuases E. C. me objekt kundërshtimin e vendimit datë 27.9.2016, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë ‘për mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin penal nr. ***, të vitit 2018’, për shkak se objekti i kallëzimit dhe hetimit ishte i njëjti. Dorëheqja ime (si dhe dy anëtarëve të tjerë të trupit gjykues) është bërë në seancën e datës 25.6.2018 sapo e kam konstatuar një fakt të tillë dhe është miratuar nga kryetari i gjykatës në datën 27.6.2018. Nga sistemi informatik i menaxhimit të çështjeve gjyqësore rezulton se data e dorëzimit dhe fillimi i gjykimit të çështjes së mësipërme është 30.5.2018. E kam deklaruar dorëheqjen nga gjykimi i çështjes sapo jam vënë në dijeni të pengesës ligjore të gjykimit të saj dhe çmuj se nuk jam bërë shkak i zvarritjes së gjykimit, i cili ka përfunduar në datën 12.9.2018”.*

Subjekti ka depozituar: procesverbal të seancës gjyqësore datë 25.6.2018; kërkesë për heqje dorë nga gjykimi i çështjes penale datë 25.6.2018; vendimin nr*** prot., datë 27.6.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë, print nga sistemi informatik i menaxhimit të çështjeve gjyqësore. Gjithashtu, subjekti ka parashtruar në tërësi në shpjegimet e tij se nuk ka pasur asnjëherë qëllim për zvarritjen e gjykimit të çështjeve.

11.4 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionit të depozituar, konstaton se sqarimet janë të plota, të bazuara ligjërisht, për sa kohë argumentohet dhe provohet se subjekti kishte gjykuar¹⁰⁴ më parë çështje me të njëjtën kërkuese (në këtë rast fjala është për denoncuesen) dhe që kishte lidhje me të njëjtin objekt gjykimi si më parë. Sqarimet e subjektit janë të sakta dhe provohen me kërkesën për dorëheqje, depozituar prej tij titullarit të gjykatës, nën argumentin e mësipërm dhe njëkohësisht edhe nga miratimi i këtij të fundit për të njëjtin argument sikurse kishte parashtruar subjekti në kërkesë. Ligji parashikon se dorëheqja mund të depozitohet në çdo fazë të gjykimit, me të rënë në dijeni të faktit se gjendet në situatën gjyqësore për të cilën është shprehur më parë. Në të tilla kushte nuk konstatohen parregullsi apo problematika që ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit.

12. Denoncim¹⁰⁵ i shtetasit H. N.

Denoncuesi ankohet ndaj vendimit nr. ***, datë 5.12.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë, në të cilin subjekti i rivlerësimit ka qenë me cilësinë e kryesuesit. Ndër të tjera, ankuesi pretendon se vendimi i dhënë ndaj djalit të tij për revokimin e pezullimit të dënimit të dhënë në vitin 2011 është i padrejtë, i njëanshëm, pasi kishin kërkuar rivendosje në afat dhe se vendimi i Gjykatës së Apelit duhet t'i referohej pranimit të rivendosjes dhe jo themelit të çështjes. Denoncuesi ka depozituar vendimet

¹⁰⁴ Neni 72 i Kodit të Procedurës Civile, ndër të tjera, ka parashikuar shprehimisht: *“Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur: 4. ka dhënë këshilla ose ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim apo ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit, është pyetur si dëshmitar, si ekspert ose si përfaqësues i njëres apo tjetrës palë.”*

¹⁰⁵ Nr. *** prot., datë 21.11.2019.

gjqësore, si dhe shkresat e organit të prokurorisë. Në tërësi, nga aktet ka rezultuar se djali i denoncuesit, shtetasi Fatri Noka është dënuar për vjedhje me dhunë në vitin 2011, duke iu pezulluar dënimi i dhënë për ta vuajtur atë me një nga dënimet alternative, konkretisht për të mbajtur kontakte me shërbimin e provës. Nga aktet ka rezultuar se në periudha të ndryshme nuk ka zbatuar këtë alternativë dënimi dhe, për pasojë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor mbi kërkesën e organit të prokurorisë me vendimin nr. *** Akti, të vitit 2015, ka vendosur revokimin e vendimmarrjes, vendim ndaj të cilit i dënuari ka kërkuar rivendosje në afat. Pas pranimit të kësaj të fundit, Gjykata e Apelit pas shqyrtimit të vendimit të shkallës së parë në të cilin ishte vendosur revokimi i dënimit alternativ, ka vendosur lënien e tij në fuqi.

✓ Komisionit, në analizë të pretendimeve të ankuesit dhe akteve gjyqësore të depozituara, nuk i kanë rezultuar problematika.

Vlerësimi i çështjes në tërësi nga trupi gjykues i Komisionit

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, në raportin dhe në rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, çmon se:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, çmon se subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e tij nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.
- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, për sa është arsyetuar lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Genti Shala ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues çmon se dërgimi për inspektim i njëjës prej dosjeve të gjykuara nga subjekti, arsyetuar në pikën 4.6, është e pamjaftueshme¹⁰⁶ për të arritur në vlerësimin e tij sipas shkronjës “b” të nenit 44 të ligjit nr.84/2016. Në këto kushte, referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, pas propozimit të relatores, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë” duke arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE:

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikave 1 dhe 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

¹⁰⁶ Nenin E, pika 1, të Aneksit të Kushtetutës, i cili përcakton se: “Vlerësimi i aftësive profesionale ka për qëllim identifikimin e atyre subjekteve që nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale, që mund të korrigjohen përmes edukimit”; - Nenin 59 të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit: “Vlerësimi i aftësive profesionale parashikon arritjen e një niveli minimal kualifikues”; - Vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, ku në pikën 54 përcaktohet se: “...në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjytimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shih edhe opinionin CDL -AD (2016)036 të Komisionit të Venecias);

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimi, z. Genti Shala, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.
2. Transferimin e çështjes gjyqësore që i përket vendimit nr. ***, datë 10.7.2017, të Gjykatës së Apelit Tiranë, në organin kompetent, për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, bazuar në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimi, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 4.8.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI
Kryesues

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Firdes SHULI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta